(3) Komisioni jep mendim për ceshtjet që kane të bejne me dosjet e parashtruara për miratim të aditiveve për ushqimin për kafshe në pajtim me kete ligj.

(4) Me kerkese të Drejtorise për Veterinari, Komisioni perpilon mendime edhe për ceshtje tjera, që kane të bejne me sigurine e ushqimit për kafshe.

(5) Mendimet e Komisionit jane të kapshme për publikun.

(6) Komisioni perbehet prej pese anetareve nga të cilet dy anetare nga Drejtoria për Veterinari dhe tre nga radhet e personave të shquar profesionale dhe shkencore pas konkursit të realizuar publik, me mandat prej tre vitesh dhe me mundesi për rizegdhje.

(7) Në punen e Komisionit mund të marrin pjese edhe persona tjere profesionale dhe shkencore, të zgjedhur në baze të kompetences së tyre profesionale dhe shkencore për ceshtje të caktuara specifike, shkencore ose teknike.

(8) Aktvendimi për formimin e Komisionit për siguri të ushqimit për kafshe shpallet në "Gazeten Zyrtare të Republikes së Maqedonise" dhe në ueb faqen e Drejtorise së Veterinarise.

(9) Anetaret e Komisionit nuk guxojne të kene interes financiar ose interesa tjera të cilat mund të ndikojne në pavaresine dhe paanshmerine e tyre. Anetaret e Komisionit dhe personat tjere profesionale dhe shkencore të përfshirë në punen e Komisionit nenshkruajne deklarate për mbrojtjen e informatave të klasifikuara dhe për mosekzistimin e konfliktit të interesave.

(10) Anetareve të Komisionit nga radhet e personave të shquar shkencore dhe profesionale u takon kompensim në lartesi të shpenzimeve reale për punet e Komisionit, që e percakton ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave.

(11) Shpenzimet për punen e Komisionit jane në llogari të Ministrise së Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave.

(12) Ministri i Bujqesise i percakton menyren e zgjedhjes dhe kualifikimet e nevojshme të anetareve të Komisionit për Sigurine e Ushqimit për Kafshe, si dhe menyren e punes së Komisionit për Sigurine e Ushqimit për Kafshe.

#### Neni 19 Laboratori Referent Nacional

(1) Cakimi i laboratoreve për kryerjen e analizes së mostrave të marra të ushqimit për kafshe gjate kryerjes së kontrolleve zyrtare, si dhe caktimi i Laboratorit Referent Nacional behet në pajtim me Ligjin për shendetesi veterinar.

(2) Laboratori Referent Nacional nga paragrafi (1) i ketij neni për kryerjen e analizave laboratorike të ushqimit për kafshe, krahas kushteve të percaktuara me Ligjin për shendetesine veterinarë dhe rregullave të miratuara në baze të ketij ligji, duhet të vleresohet dhe akreditohet në pajtim me Standardet evropiane relevante, si:

- EN ISO/IEC 17025 për "Kushtet e pergjithshme për kompetence të laboratoreve për testim dhe kalibrim",

- EN 45002 për "Kriteret e pergjithshme për vleresimin e laboratoreve në të cilet realizohet testimi" dhe

- EN 45003 për "Sistemi për akreditimin e laboratoreve në të cilet kryhet kalibrimi dhe testimi-Kushtet e pergjithshme për pune dhe njohje".

(3) Kur në Republikën e Maqedonise nuk funksionojne laboratorët nga paragrafi (1) i ketij neni, ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave mund t'ua ndaje obligimet e ketyre laboratoreve, laboratoreve të kualifikuara perkatese që funksionojne në një prej vendeve anetare të Unionit Evropian.

### Kreu IV

#### GJENDJE TË JASHTEZAKONSHME

#### Pjesa I

#### SISTEMI PËR NJOFTIM TË SHPEJTE, MASAT URGJENTE DHE MENAXHIMI ME KRIZA

#### Neni 20 Sistemi për njoftim të shpejte

(1) Sistemi për njoftim të shpejte për rrezik të drejtperdrejte ose të terthorte për shendetin e kafsheve dhe të njerzve, që rrjedh nga ushqimi për kafshe themelohet si rrjet informativ. Në të jane të përfshirë të gjitha organet kompetente për sigurine e ushqimit për kafshe.

(2) Sistemi për njoftim të shpejte për ushqim për kafshe është pjesë e sistemit për njoftim të shpejte për ushqim.

(3) Për menyrën e organizimit dhe punës të Sistemit për njoftim të shpejte për ushqimin për kafshe zbatohen dispozitat nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit.

## Pjesa II

### GJENDJE TË JASHTEZAKONSHME

#### Neni 21

#### Llojet e masave urgjente

(1) Kur Drejtoria për Veterinari konstaton se ushqimi për kafshe me origjinë nga vendi ose nga importi, mund të paraqesë rrezik serioz për shendetin e njerezve, shendetin e kafsheve ose mjedisin jetesor dhe se ai rrezik nuk mund të menjahohet në menyrë të kenaqshme, drejtori i Drejtorisë për Veterinari mund të urdherojë, varesisht nga pesha e situatës, zbatim të një ose më shumë masave nga paragrafet (3) dhe (4) të këtij neni.

(2) Personat e autorizuar për kryerjen e kontrolleve zyrtare janë të detyruar që në kuader të kompetencave të tyre ta informojnë Drejtorinë për Veterinari për paraqitjen e rrezikut.

(3) Nese ushqimi për kafshe është me origjinë vendore, zbatohen masat në vijim:

- ndalimi i perkohshëm për leshim në qarkullim ose përdorim të ushqimit për kafshe për të cilin behet fjale, kohezgjatja e të cilit percaktohet varesisht nga lloji i rrezikut,

- percaktimi i kerkesave të vecanta për ushqimin për kafshe për të cilin behet fjale, dhe

- masa tjera perkatase me llojin e rrezikut.

(4) Nese ushqimi është me origjinë nga importi, zbatohen masat në vijim:

- ndalimi i perkohshëm për import të ushqimit për kafshe nga vendet ose nga pjesë të vendeve eksportuese ose nga vendet transitore,

- percaktimi i masave të vecanta për ushqimin për kafshe nga vendet ose pjesë të vendeve importuese, ose nga vendet transitore dhe

- masa tjera të perkohshme perkatase.

(5) Masat nga paragrafet (3) dhe (4) të këtij neni zbatohen deri në menjanimin e dyshimit, perkatesisht menjanimin e rrezikut për shendetin e njerezve, shendetin e kafsheve ose të mjedisit jetesor.

(6) Kur në baze të analizës së rrezikut do të konstatohet serioziteti i rrezikut nga paragrafi (1) i këtij neni, drejtori i Drejtorisë për Veterinari do të urdherojë mase të perhershme për ndalimin e leshimit në qarkullim të ushqimit që paraqet rrezik serioz.

## Pjesa III

### MENAXHIMI ME KRIZA

#### Neni 22

#### Plani për menaxhim me krize

(1) Drejtoria për Veterinari në bashkëpunim me organet kompetente për sigurinë e ushqimit për kafshe, përpilon plan për menaxhim me krize në sferën e sigurisë së ushqimit për kafshe.

(2) Plani për menaxhim me krize në sferën e sigurisë së ushqimit për kafshe është pjesë e Planit të përgjithshëm për menaxhim me kriza, i përpiluar në pajtim me rregullat për sigurinë e ushqimit.

## Kreu V

### HIGJIENA E USHQIMIT PËR KAFSHE

#### Pjesa I

#### OBLIGIMET E PERGJITHSHME DHE TË VECANTA TË OPERATOREVE ME USHQIM PËR KAFSHE

##### Neni 23

#### Obligimet e përgjithshme

(1) Operatorët me ushqim për kafshe doemos duhet të sigurojnë se të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit dhe distributimit të ushqimit për kafshe që janë nën kontrollin e tyre, i plotesojnë kerkesat e percaktuara me kete ligj dhe rregullat tjera për sigurinë e ushqimit.

(2) Gjate ushqimit të kafsheve që shfrytezohen për prodhimin e ushqimit për ushqimin e njerezve, fermerët doemos duhet të marrin masa dhe të vendosin procedura për zvogelimin e rrezikut nga kontaminimi biologjik, kimik ose fizik i ushqimit për kafshe, kafsheve, si dhe produktet me origjinë shtazore në nivelin më të ulët të mundshëm.

##### Neni 24

#### Obligimet e vecanta

(1) Operatorët me ushqim për kafshe, që kryejnë prodhimtari primare dhe veprimtari percjellese siç janë transporti, magazinimi dhe manipulimi i produkteve primare në vendet e prodhimit; operacionet transportuese për dërgimin e produkteve primare nga vendi i prodhimit tek objekti; perzierje të ushqimit për kafshe për nevoja të vecanta të fermave të tyre pa përdorimin e aditiveve ose premikseve të aditiveve me përjashtim të aditiveve për silazh; doemos duhet t'i plotesojnë kushtet e përgjithshme higjienike, si dhe kushtet perkatase varesisht nga lloji i produktit, që janë të percaktuara me kete ligj.

(2) Operatorët me ushqim për kafshe, që kryejnë cilendo fazë të prodhimit, përpunimit dhe distributimit të ushqimit pas fazës në të cilën zbatohen dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni, doemos duhet t'i plotesojnë kushtet e vecanta higjienike varesisht nga lloji i produktit, që janë të percaktuara me kete ligj dhe me rregullat e miratuara në baze të këtij ligji.

(3) Operatorët me ushqim për kafshe doemos duhet:

- të posedojnë pajisje perkatase dhe lokale për kryerjen e aktivitetit,

- t'i përbushin kriteret e vecanta mikrobiologjike,

- të marrin masa dhe të zbatojnë procedura të cilat janë të nevojshme për arritjen e qellimeve të këtij ligji dhe

- të mbajnë evidence për masat e marra dhe procedurat.

(4) Fermerët të cilet rrisin kafshe produktet e të cilave shfrytezohen për ushqimin e njerezve duhet të sigurojnë përputhshmeri me kerkesat për praktike të mire për ushqimin e kafsheve lidhur me kullotjen e bagetisë, kerkesat për objektet për rritjen e kafsheve dhe pajisjen për ushqimin e kafsheve, menyrën e të ushqyerit, magazinimin, distributimin, kerkesat për ushqim dhe ujë për kafshe, si dhe lidhur me personelin në aspekt të sigurisë së ushqimit për kafshe.

(5) Operatorët me ushqim për kafshe dhe fermerët mund t'i kullojnë bagetinë dhe ta shfrytezojnë ushqimin për kafshe nga objektet dhe operatorët që janë të regjistruar dhe/ose të lejuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në baze të këtij ligji.

(6) Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave i percakton kerkesat higjienike të përgjithshme dhe të vecanta për ushqimin për kafshe lidhur me kerkesat higjienike për prodhimtari primare, udhezimet për praktike të mire prodhuese gjate prodhimtarisë primare, kerkesat e përgjithshme dhe të vecanta për operatorët me ushqim për

kafshe në cilendo faze të prodhimit, perpunimit dhe distribuimit të ushqimit lidhur me objektet dhe pajisjen, menyren e mbajtjes së evidences për masat e marra dhe procedurat, kriteret e vecanta mikrobiologjike dhe masat dhe procedurat që janë të nevojshme për arritjen e qellimeve të këtij ligji.

(7) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujërave i percakton kerkesat higjienike të pergjithshme dhe të vecanta për praktikata e mira të ushqimit të kafsheve në lidhje me kullotjen e bagetive, kerkesat për objektet për rritjen e kafsheve dhe pajisjet për ushqimin e kafsheve, menyren e të ushyerit, magazinimin dhe distribumin e ushqimit për kafshe.

#### Neni 25

### Sistemi i analizës së rrezikut dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP)

(1) Operatorët me ushqim për kafshet, doemos duhet të vendosin, të zbatojnë dhe të mbajnë procedura të dokumentuara të rregullta të vetekontrollit, në pajtim me parimet e HACCP-së.

(2) Parimet nga paragrafi (1) i këtij neni kanë të bëjnë me:

- identifikimin e gjitha rreziqeve të cilat doemos duhet të parandalohen, eliminohen ose të zvogelohen në nivel të pranueshem,

- identifikimin e pikave kritike të kontrollit të hapit ose hapave, ku kontrolli është i domosdoshem për parandalimin ose eliminimin e rrezikut ose zvogelimin e tij në nivel të pranueshem,

- vendosjen e limiteve kritike në pikat kritike të kontrollit të cilat e ndajnë të pranueshmen nga e papranueshmja, për parandalimin, eliminimin ose zvogelimin e rreziqeve të identifikuar,

- vendosjen dhe implementimin e procedurave të efektshme të monitorimit në pikat kritike të kontrollit,

- vendosjen e aktiviteteve korrektive, kur monitorimi tregon se pika kritike e kontrollit nuk është nën kontroll,

- vendosjen e procedurave që të verifikohet se masat e dhena në alinete 1 deri në 5 të këtij paragrafi janë komplete dhe funksionalisht efektive. Procedurat për verifikim zbatohen rregullisht dhe

- vendosjen e procedurave për dokumentacion dhe evidence që janë në perpjësim me natyrën dhe madhësinë e aktiviteteve me ushqimin për kafshe që të deshmohet zbatimi i aktiviteteve nga alinete prej 1 deri në 6 të këtij paragrafi.

(3) Kur behet modifikimi i produktit, procesit ose i ndonjeres prej fazave të prodhimit, perpunimit, magazinimit dhe distribuimit, operatorët me ushqim për kafshe duhet të kryejnë revizion në procedurat e tyre dhe t'i bëjnë ndryshimet e domosdoshme.

(4) Si pjesë e sistemit të procedurave nga paragrafi (1) i këtij neni, operatorët me ushqim për kafshe mund të shfrytëzojnë udhëzime për praktike të mire bashke me udhëzimet për zbatimin e parimeve të HACCP-së.

(5) Operatorët me ushqim për kafshe janë të obliguar që:

- në Drejtorinë për Veterinari të dorezojnë deshmë për harmonizimin e tyre me dispozitat e këtij neni, në menyren që kerkohet nga organi kompetent dhe

- të sigurojnë se rregullisht azhurnohen dokumentet në të cilat pershkruhen procedurat e vendosura në pajtim me kete nen.

(6) Drejtoria për Veterinari duhet ta kete parasysh natyrën dhe madhësinë e punës me ushqim për kafshe gjate percaktimit të obligimit nga paragrafi (5) alineja 1 e këtij neni.

(7) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujërave me propozim të drejtorit të Drejtorise për Veterinari mund të lejoje shmangie nga zbatimi i dispozites nga paragrafi (1) i këtij neni, vecanerisht te subjektet e vegjel

që merren me ushqim për kafshe ose subjektet që gjenden në zonat në të cilat ekzistojnë kufizime të vecanta gjeografike që t'u lehtesohet realizimi i aktiviteteve lidhur me zbatimin e sistemit të vetekontrollit të zhvilluar në pajtim me parimet e HACCP-së, duke i marre parasysh faktorët e rëndësishëm të rrezikut dhe nese shmangiet e tilla nuk ndikojnë në realizimin e qellimeve të percaktuara me rregullat për sigurine e ushqimit për kafshe.

(8) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujërave i percakton rregullat e detajuara për zbatimin e sistemit të vetekontrollit, të zhvilluar në pajtim me parimet e HACCP-së.

## Pjesa II

### OBLIGIMET E PERGJITHSHME PËR REGJISTRIM DHE LEJIMI I OPERATOREVE ME USHQIM PËR KAFSHE DHE OBJEKTEVE PËR USHQIM PËR KAFSHE

#### Neni 26

### Regjistrimi i operatoreve me ushqim për kafshe dhe objekteve për ushqim për kafshe

(1) Operatorët me ushqim për kafshe janë të detyruar që të bashkëpunojnë me Drejtorinë për Veterinari në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat për siguri të ushqimit për kafshe dhe të shëndetësisë veterinare.

(2) Operatorët me ushqim për kafshe janë të detyruar që:

- ta njoftojnë Drejtorinë për Veterinari për objektet të cilat janë nën kontrollin e tyre, të cilat janë aktive në fazat e prodhimit, perpunimit, magazinimit, transportit ose distribuimit të ushqimit për kafshe dhe

- t'i sigurojë Drejtorisë për Veterinari informata të azhurnuara për objektet që janë nën kontrollin e tij në menyren e shenuar në paragrafin (2) pika (1) të këtij neni, duke përfshirë edhe njoftimin për çdo ndryshim në aktivitetet ose mbylljen e objektit ekzistues të regjistruar ose të lejuar.

(3) Drejtoria për Veterinari mban Regjister të objekteve dhe Regjister të operatoreve me ushqim për kafshe.

(4) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujërave i percakton proceduren për regjistrimin e objekteve dhe të operatoreve me ushqim për kafshe dhe formen dhe permbajtjen dhe menyren e mbajtjes së regjistrave nga paragrafi (3) i këtij neni.

#### Neni 27

### Dhenia e lejes operatoreve me ushqim për kafshe dhe objekteve për ushqim për kafshe

(1) Operatorët me ushqim për kafshe doemos duhet të sigurohen se objektet që janë nën kontrollin e tyre janë të lejuara nga ana e Drejtorise për Veterinari, kur në ato objekte realizohen disa nga aktivitetet në vijim:

- prodhim dhe/ose leshim në qarkullim të aditiveve të ushqimit për kafshe,

- prodhim dhe/ose leshim në qarkullim të proteinave të fituara nga mikroorganizmat nga grupi i baktereve, tharimeve, algave, kerpudhave të ulta dhe ko-produkteve nga prodhimi i aminoacideve me fermentim,

- prodhim dhe/ose leshim në qarkullim të premikseve të cilat janë pergatitur nga aditive të ushqimit për kafshe,

- prodhim për leshim në qarkullim ose prodhim për nevojat e fermave të tyre, perzierje të tagjise me ndihmen e aditiveve ose të premikseve të cilat permbajne aditive të ushqimit për kafshe dhe

- prodhim, perpunim ose distribuim të produkteve të caktuara të cilat shfrytezojen për ushqimin e kafsheve.

(2) Operatori me ushqim për kafshe para fillimit të çfarëdo aktiviteti është i obliguar që të parashtrroje kerkese për dhenien e lejes të objekteve që janë në kompetencen e tij në Drejtorinë për Veterinari.

(3) Para se ta jape lejen nga paragrafi (2) i ketij neni, në afat prej 15 ditesh Drejtoria për Veterinari kryen audit në vendin aty për aty.

(4) Nese Drejtoria për Veterinari në afatin nga paragrafi (3) i ketij neni nuk kryen audit aty për aty, do të konsiderohet se kerkesa për dhenien e lejes operatoreve me ushqim për kafshe dhe të objekteve për ushqim për kafshe është lejuar.

(5) Drejtoria për Veterinari mund të jape leje të perkohshme, nese nga auditi aty për aty konstatohet se objekti i ploteson të gjitha kushtet për infrastrukture dhe pajisje. Drejtoria për Veterinari jep leje të perhershme, nese gjate auditit të ri aty për aty në periudhe prej tre muajsh nga lesimi i lejes së perkohshme, konstaton se objekti i ploteson kerketat higjienike të pergjithshme dhe të vecanta. Nese është bere avancim i dukshem, por objekti akoma nuk i ploteson të gjitha kushtet, Drejtoria për Veterinari mund ta vazhdoje lejen e perkohshme. Leja e perkohshme nuk guxon të zgjase më shume se gjashte muaj.

(6) Drejtoria për Veterinari duhet ta kete në shikim lejen për objektin gjate kryerjes së kontrolleve zyrtare.

(7) Drejtoria për Veterinari nuk kryen vizita aty për aty, në pajtim me procedurat e percaktuara në paragrafet (3), (4) dhe (5) të ketij neni, te operatorit me ushqim për kafshe të cilet funksionojne vetem si tregtare pa i mbajtur produktet në lokalet e tyre. Keta operatore me ushqim për kafshe Drejtorise për Veterinari doemos duhet t'i paraqesin deshmi për atë se ushqimi për kafshe të cilin ata e leshojne në qarkullim është në pajtim me kerketat e percaktuara me kete ligj.

(8) Operoret me ushqim për kafshe kunder aktvendimit të Drejtorise për Veterinari me të cilin refuzohet kerkesa e tij për leje mund të parashtroje ankese te ministri i Bujqesise, Pyltarrise dhe Ekonomise së Ujerave në afat prej tete ditesh nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa e parashtruar kunder aktvendimit nuk e prolongon zbatimin e tij.

(9) Ministri është i obliguar që të vendose për ankesen nga paragrafi (8) i ketij neni, më së voni në afat prej 15 ditesh nga dita e parashtrimit.

(10) Ministri i Bujqesise, Pyltarrise dhe Ekonomise së Ujerave i percakton formen, permbajtjen dhe menyren e parashtrimit të kerkeses nga paragrafi (2) i ketij neni, menyren dhe proceduren e dhenies së lejes objekteve nga paragrafi (1) i ketij neni, si dhe për tipin e produkteve dhe permbajtjen e numrit të lejeve.

#### Neni 28

### **Kushtet për pune të operatoreve me ushqim për kafshe dhe objekteve për ushqim për kafshe**

Operoret me ushqim për kafshe nuk guxojne të punojne, nese nuk jane të regjistruar në pajtim me nenin 26 të ketij ligji, dhe/ose të lejuar në pajtim me nenin 27 të ketij ligji.

#### Neni 29

### **Pezullimi i regjistrimit ose i lejes**

(1) Drejtoria për Veterinari perkohesisht do ta pezulloje regjistrimin dhe/ose lejen e objektit për një aktivitet, për më shume ose për të gjitha aktivitetet, kur është e konstatuar se operatori dhe/ose objekti më nuk i permbushe kushtet për kryerjen e veprimtarise.

(2) Pezullimi nga paragrafi (1) i ketij neni zgjate gjersa operatori dhe/ose objekti perseri nuk i permbushe kushtet për kryerjen e veprimtarise. Në rast kur kushtet për kryerjen e veprimtarise nuk plotesohen në periudhe prej një viti nga kumtimi i aktvendimit për pezullim, Drejtoria për Veterinari do ta heqe regjistrimin dhe/ose lejen.

#### Neni 30

### **Heqja e regjistrimit ose e lejes**

(1) Nese Drejtoria për Veterinari evidenton mangesi serioze ose më shume here e nderpret prodhimin në objekt, ndersa operatori me ushqim për kafshe nuk është në mundesi të siguroje garanci perkatese në aspektin e prodhimit të metutjeshem, Drejtoria për Veterinari fillon procedure për heqjen e regjistrimit të objektit dhe/ose lejes së tij.

(2) Drejtoria për Veterinari ia heq regjistrimin dhe/ose lejen operatorit dhe/ose objektit, për një ose më shume aktivitete që i realizon, në rast kur:

a) operatori me ushqim për kafshe dhe/ose objekti pushon të realizoje një ose më shume nga aktivitetet e tij;

b) është konstatuar se operatori me ushqim për kafshe dhe/ose objekti nuk i permbushe kushtet që kane të bejne me aktivitetet e tij, në periudhe kohore më të gjate se një vit dhe

v) ka identifikuar mangesi serioze ose operatori me ushqim për kafshe më shume here e ka nderprere prodhimin në objekt dhe operatori me ushqim për kafshe akoma nuk është në gjendje të siguroje garanci perkatese në aspekt të prodhimit të metutjeshem.

#### Neni 31

### **Zgjerimi dhe ndryshimet në regjistrimin ose lejen e objektit**

Me kerkese të operatorit me ushqim për kafshe, Drejtoria për Veterinari mund të beje ndryshime në regjistrimin ose lejen e objektit, me aktivitete të cilat jane plotesuese për ato që për here të pare ka qene i regjistruar ose i lejuar, ose që i zevendesojne, në pajtim me procedurat nga nenet 26 dhe 27 të ketij ligji.

#### Neni 32

### **Lista e objekteve dhe operatoreve të regjistruar dhe të lejuar me ushqim me kafshe**

(1) Drejtoria për Veterinari mban lista të objekteve dhe operatoreve të regjistruar dhe të lejuar me ushqim për kafshe me numrin e tyre identifikues të vecante ose numrin e lejes dhe ato jane të kapshme për organet tjera kompetente dhe për publikun në menyren e percaktuar me kete ligj.

(2) Drejtoria për Veterinari e azhurnon evidencen për objektet dhe për operoret me ushqim për kafshe të cilet gjenden në listen nga paragrafi (1) i ketij neni në pajtim me dispozitat e neneve 29, 30 dhe 31 të ketij ligji.

(3) Ministri i Bujqesise, Pyltarrise dhe Ekonomise së Ujerave i percakton formen dhe permbajtjen, menyren e mbajtjes dhe shpalljen e listes së objekteve dhe operoreve të regjistruar dhe të lejuar me ushqim për kafshe.

#### Pjesa III

#### UDHEZIME

#### Neni 33

### **Udhezime për praktika të mira**

(1) Drejtoria për Veterinari e mbeshtete zhvillimin e udhezimeve për praktike të mire në sferen e sigurise së ushqimit për kafshe dhe për zbatimin e parimeve të HACCP-së.

(2) Operoret me ushqim për kafshe i shfrytetojne keto udhezime në baze vullnetare.

(3) Kur udhezimet për praktike të mire jane të zhvilluara, ata futen në perdorim dhe diseminohen nga ana e asociacioneve të operoreve me ushqim për kafshe:

- në konsultim me perfaqesuesit e paleve interesat e të cilave mund të preken, siç jane organet kompetente dhe grupet e konsumatoreve,

- me ç'rast duhet të merren parasysh kodet e praktikës nga Codex Alimentarius dhe

- kur kane të bëjnë me prodhimtarine primare të ushqimit, duke marre parasysh rregullat për prodhimtarine primare.

(4) Drejtoria për Veterinari në nivel vjetor bën vleresimin e udhezimeve me qëllim që të sigurohet se:

- ato janë të zhvilluara në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni,

- përmbajtja e tyre është praktike për sektoret me të cilat kane të bëjnë dhe

- ato janë adekuate si udhezime për harmonizim me obligimet e pergjithshme dhe të vecanta në sektoret dhe/ose për tipin e ushqimit për kafshe me të cilin ato kane të bëjnë.

(5) Drejtoria për Veterinari mban evidence për udhezimet e publikuara për praktike të mire dhe zbatim të parimeve të HACCP-së dhe i publikon në ueb faqen e vet.

#### Neni 34

### Praktike e mire për ushqimin e kafsheve

(1) Drejtoria për Veterinari siguron implementim të praktikës së mire për ushqimin e kafsheve nga aspekti i sigurisë së ushqimit për kafshe në pajtim me këte ligj.

(2) Fermeret janë të obliguar që të aplikojnë praktike të mire për ushqimin e kafsheve në përputhje me nenet 14 paragrafi (2), 23 paragrafi (2) dhe 24 paragrafi (4) të këtij ligji.

#### Kreu VI

### LESHIMI NË QARKULLIM

#### Pjesa I

#### LENDET E PARA PËR USHQIMIN PËR KAFSHE

#### Neni 35

### Leshimi në qarkullim i lendeve të para për ushqim për kafshe

(1) Lendet e para për ushqim për kafshe mund të leshohen në qarkullim vetëm nëse janë me perberje të mire, të vertete dhe të qelluar për shitje dhe i plotësojnë kushtet e percaktuara me këte ligj. Kur leshohen në qarkullim apo shfrytezohen, lendet e para për ushqim për kafshe nuk guxojnë të paraqesin rrezik për shëndetësinë publike, mbrojtjen shëndetësore të kafsheve dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe nuk guxojnë të leshohen në qarkullim në mënyrën me të cilën mund të shkaktohet huti.

(2) Lendet e para për ushqim për kafshe nuk mund të leshohen në qarkullim, nëse nuk janë paraqitur karakteristikat minimale për ato, të cilat doemos duhet të jenë të dukshme, të lexueshme dhe të pashlyeshme dhe për të cilat prodhuesi, paketuesi, importuesi, shitësi ose distributori me seli në Republikën e Maqedonisë janë pergjegjës, janë të shkruara në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik, në dokumentin percjelles ose ku është e pershtatshme në paketimin, në kontejnerin ose në etiketen që është ngjitur. Dokumenti percjelles ose etiketa duhet të përmbajë vecanërisht edhe:

a) fjalet "ushqim për kafshe";

b) emrin e lendes së parë për ushqim për kafshe dhe ku është e pershtatshme, karakteristikat tjera të cilat janë të parapara me këte ligj;

v) sasinë-neto të shprehur në njësi për masë në rast të produkteve të ngurta, si dhe në njësi për masë apo vëllim në rast të produkteve të lengeta;

g) emrin e operatorit me ushqim për kafshe dhe adresën ose vendin e regjistruar të objektit për prodhim, numrin e lejes ku është e nevojshme, numrin referent të serise ose hollesi tjera të cilat shërbejnë si garanci se ushqimi për kafshe është i vijueshem dhe

d) emrin e operatorit me ushqim për kafshe dhe adresën ose vendin e regjistruar të punës të personit i cili është pergjegjës për hollesitë të cilat permenden në këte paragraf, nëse janë të ndryshme nga ato që janë dhene nga prodhuesi, siç është shenuar në pikën g) të këtij paragrafi.

(3) Informate tjeter plotësuese në paketim, kontejner, etiketa dhe dokumente percjelles mund të jepet me kusht që ato informata të jenë në lidhje me parametrat qellimore apo kuantitative, mund të mbeshteten dhe të mos shkaktojnë huti tek konsumatori. Kjo informate duhet të jete e vecuar nga informata e theksuar në paragrafin (2) të këtij neni.

(4) Për sasi të lendeve të para për ushqim për kafshe, më të vogla apo të barabarta me 10 kg, e të dedikuara për shfrytëzuesin perfundimtar, informatat e theksuara në paragrafet (2) dhe (3) të këtij neni mund t'i jepen bleresit në forme të njoftimit perkates në vendin e shitjes.

(5) Nëse seria është e ndare gjate leshimit në qarkullim, karakteristikat e theksuara në paragrafin (2) të këtij neni, bashke me referencën e serise primare, doemos duhet të perseritet në paketimin, kontejnerin ose dokumentin percjelles për çdo pjese të serise.

(6) Kur perberja e ushqimit për kafshe gjate leshimit në qarkullim është e ndryshuar, informatat nga paragrafi (2) i këtij neni doemos duhet të ndryshohen në mënyrë adekuate nën pergjegjesinë e personit i cili i jep karakteristikat e reja.

(7) Lendet e para të ushqimit për kafshe të cilat leshohen në qarkullim doemos duhet të perfshihen në listen e cila perpilohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe mund të leshohen në qarkullim vetëm me emrat të cilat janë shenuar aty dhe me kusht që të përputhen me pershkrimin e dhene dhe janë në përputhje me kerkesat minimale për perberje që përmbahen aty.

(8) Me perjashtim nga paragrafi (7) i këtij neni, leshimi në qarkullim i lendeve të para për ushqim për kafshe, të ndryshme prej atyre nga lista e dhene në paragrafin (7) të këtij neni, është i lejuar me kusht që keto lende të para të leshohen në qarkullim me emer dhe/ose kushte të ndryshme prej atyre të dhena në liste dhe në mënyrë që të mos shkaktoje huti te konsumatori në lidhje me identitetin e vertete të produktit dhe ,

(9) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujërave e percakton listen e lendeve të para për ushqim për kafshe, kushtet për leshimin e tyre në qarkullim, deklarimin dhe karakteristikat të cilat duhet të jepen në dokumentin percjelles ose në paketim.

#### Neni 36

### Lista e lendeve të para, materialeve dhe produkteve, leshimi në qarkullim ose perdorimi i të cilave për ushqimin e kafsheve është i ndaluar

(1) Për mbrojtjen e shëndetit të njerezve, mbrojtjen shëndetësore të kafsheve dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, Drejtoria për Veterinari mund ta ndaloje leshimin në qarkullim dhe perdorimin për ushqimin e kafsheve të lendeve të para të caktuara, materialeve dhe produkteve tjera.

(2) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujërave e percakton listen e lendeve të para, materialeve dhe produkteve tjera, perdorimi dhe leshimi në qarkullim i të cilave është i ndaluar.

#### Pjesa II

#### PERZIERJET E TAGJISE

#### Neni 37

### Leshimi në qarkullim i perzierjeve të tagjise

(1) Perzierjet e tagjise mund të leshohen në qarkullim vetëm nëse janë me perberje adekuate, të pademtuar dhe të pershtatshme për shitje dhe i plotësojnë kushtet e percaktuara me këte ligj. Kur leshohen në qarkullim ose shfrytezohen, perzierjet e tagjise nuk guxojnë të paraqesin rrezik për

shendetesine publike, mbrojtjen shendetesore të kafsheve dhe mjedisin jetesor dhe nuk guxojne të leshohen në qarkullim në menyren me të cilën mund të shkaktohet huti.

(2) Perzierjet e tagjise leshohen në qarkullim vetem në paketime dhe kontejnere të mbyllura, të mbyllur në menyre që gjate hapjes së paketimit ose kontejnerit, paketimi ose kontejneri nuk mund të riperdoret.

(3) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave i percakton kushtet për leshimin në qarkullim të perzierjeve të tagjise.

Neni 38

#### Shenimi i detyrueshem i perzierjeve të tagjise

(1) Perzierjet e tagjise nuk mund të leshohen në qarkullim, nese nuk jane paraqitur karakteristikat minimale për ato, të cilat doemos duhet të jene të dukshme, të lexueshme, të padhlyeshme dhe për të cilat prodhuesi, paketuesi, importuesi, shitesi ose distributori me seli në Republikën e Maqedonise janë pergjegjes, jane të shkruara në gjuhen maqedonase dhe alfabetin cirilik, në paketimin, në kontejnerin ose në etiketen që eshte ngjitur në to, edhe atë vecanerisht:

a) pershkrimi "perzierje e kompletuar e tagjise", "perzierje plotesuese e tagjise", "perzierje minerale e tagjise", "zevendesim i kompletuar i qumeshtit" ose "zevendesim i plotesuar i qumeshtit", siç eshte e pershtatshme;

b) llojet ose kategoria e kafsheve për të cilat dedikohet perzierja e tagjise;

v) udhezimi për perdorim të drejte të ushqimit për kafshe me dedikim;

g) deklarata për perberjen;

d) sasia-neto e shprehur në njesi për mase në rast të produkteve të ngurta, si dhe në njesi për mase ose vëllim në rast të produkteve të lengeta;

gj) afati minimal i magazinimit;

e) numri referent i serise dhe

zh) emri i operatorit me ushqim për kafshe dhe adresa ose vendi i regjistruar të objektit për prodhim, numri i lejes ku eshte e nevojshme, numri referent i serise ose hollesi tjera të cilat sherbejne si garanci se ushqimi për kafshe eshte i vijueshem.

(2) Për sasite e perzierjeve të tagjise, më të vogla ose të barabarta me 1 kg, e të dedikuara për shfrytëzuesin perfundimtar, informatat që jane dhene në paragrafin (1) të ketij neni mund t'i jepen bleserit në forme të njoftimit perkates në vendin e shitjes.

(3) Për perzierjet e tagjise të cilat leshohen në qarkullim në tankere ose mjete tjera të ngjashme transportuese, karakteristikat e dhena në paragrafin (1) të ketij neni mund të jepen në dokumentin i cili e percjelle dergesen.

(4) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave i percakton kushtet më të peraferta për menyren e deklarimit, informatat minimale të cilat jane shenuar në paketimin, kontejnerin, etiketen ose dokumentin percjelles, si dhe menyren e pershkrimin të perzierjeve të tagjise.

Neni 39

#### Shenimi plotesues i perzierjeve të tagjise

(1) Informate tjeter plotesuese në paketimet, kontejneret, etiketat dhe dokumentet percjellese për perzierjet e tagjise mund të jepet me kusht që ato informata të lidhen me parametrat qellimore ose kuantitative, mund të mbeshteten dhe nuk shkaktojne huti tek konsumatori, dhe nese ato:

a) nuk jane të dizajnuara në menyre që e paraqesin pranine ose permbajtjen e perberesve analitike ndryshe nga ato për të cilat eshte siguruar deklarate në perputhje me rregullat për siguri të ushqimit për kafshe;

b) nuk shkakton huti te shfrytëzuesi, vecanerisht me pershkrimin e ushqimit për kafshe për efekte ose veti të cilat nuk i posedon ose me sugjerim se posedon karakteristika të vecanta kur të gjitha ushqimet për kafshe të ngjashme posedojne karakteristika të tilla;

v) nuk guxon të deklaroje se ushqimi për kafshe parandalon, trajton ose sheron semundje dhe

g) doemos duhet të lidhen me parametrat qellimore ose kuantitative që mund të vertetohet.

(2) Informata nga paragrafi (1) i ketij neni doemos duhet të ndahet nga informata për shenimin e detyrueshem të perzierjeve të tagjise.

### Pjesa III

#### USHQIM PËR KAFSHE PËR QELIME TË VECANTA NUTRITIVE

Neni 40

#### Leshimi në qarkullim i ushqimit për kafshe për qellime të vecanta nutritive

(1) Ushqimi për kafshe për qellime të vecanta nutritive mund të leshohet në qarkullim, nese:

a) produkti eshte i pershtatshem për qellimin e tij të vecante nutritiv dhe karakteristikat nutritive esenciale dhe eshte në listen e perpiluar nga Drejtoria për Veterinari;

b) eshte shenuar në menyre perkatese;

v) dedikimi i tij eshte i shenuar në listen e ushqimeve për kafshe me qellime të vecanta nutritive dhe i permbushe dispozitat tjera për llojet e ketille të ushqimit dhe

g) eshte në perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe me rregullat e miratuara në baze të ketij ligji.

(2) Natyra e perberjes së ushqimit për kafshe i cili eshte dedikuar për qellime të vecanta në ushqim doemos duhet të jete adekuate për perdorimin e tij primar.

(3) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave i percakton kushtet e pergjithshme dhe të vecanta për perpilimin e listes së ushqimit për kafshe për qellime të vecanta nutritive në ushqim, si dhe kushtet për leshimin e tyre në qarkullim dhe e publikon listen e ushqimit për kafshe me qellime të vecanta nutritive në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise" dhe në ueb faqen e Drejtorise së Veterinarise.

### Pjesa IV

#### PRODUKTE TË KAKTUARA QË SHFRYTEZOHEN NË USHQIMIN E KAFSHEVE

Neni 41

#### Leshimi në qarkullim i produkteve të caktuara të cilat shfrytëzohen në ushqimin e kafsheve

(1) Produkte të caktuara që shfrytëzohen në ushqimin e kafsheve, duke perfshire edhe bioproteinat, që veprojne si burime të drejtperdrejta ose të terthorta të proteinave dhe të prodhuara me procese të caktuara teknologjike si ushqim për kafshe ose në ushqimin për kafshe, mund të leshohen në qarkullim, nese ato gjenden në Listen e perpiluar nga ana e Drejtorise për Veterinari dhe nese i plotesojne kerkesat e percaktuara me dispozitat e ketij ligji dhe rregullat e miratuara në baze të ketij ligji.

(2) Produktet nga paragrafi (1) i ketij neni mund të perfshihen në Listen për produkte të caktuara për ushqimin e kafsheve, nese:

a) kane vlere nutritive për kafshet;

b) kur shfrytëzohen në perputhje me dedikimin, nuk kane efekt të demshem mbi shendetin e njerezve, mbrojtjen shendetesore të kafsheve ose mjedisin jetesor dhe nuk e demtojne konsumatorin me ndryshimin e disa karakteristikeve të caktuara të produkteve me origjine shtazore dhe

v) mund të kryhet monitorim i tyre në ushqimin për kafshe.

(3) Nese produkti pushon të plotesoje një prej kushteve të shenuara në paragrafin (2) të ketij neni, ai terhiqet nga Lista e produkteve të caktuara për ushqimin e kafsheve.

(4) Drejtoria për Veterinari për qellime eksperimentale ose shkencore mund që të lejoje perjashtim nga dispozitat nga paragrafi (1) i ketij neni, me kusht që të kryhet kontroll zyrtar perkates.

(5) Produkte të caktuara për ushqimin e kafsheve nuk guxojne të leshohen në qarkullim ose të inkuorporohen në ushqimin për kafshe deri sa nuk jane të shenuar në menyre adekuate në paketimin, kontejnerin ose në etiketen.

(6) Me perjashtim nga paragrafi (5) i ketij neni, për produkte të cilat leshohen në qarkullim në gjendje refuze (të shperndare), informata e kerkuar për shenim mund të permbahet në dokumentin percjelles.

(7) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave e percakton Listen e produkteve të cilat shfrytezohehen në ushqimin e kafsheve si burime të drejtperdrejta ose të terthorta të proteinave, kriteret për leshimin e tyre në qarkullim dhe perdorimin, si dhe kushtet në lidhje me proceduren dhe dokumentet që jane të nevojshme të dorezohen për perfshirjen e tyre në Liste, që duhet t'i plotesoje operatoret me ushqim të cilet i prodhojne dhe i leshojne në qarkullim dhe informatat të cilat doemos duhet të jene të pranishme ose në etikete ose në dokumentin percjelles.

(8) Lista e produkteve të cilat shfrytezohehen në ushqimin e kafsheve si burime të drejtperdrejta dhe të terthorta të proteinave publikohet në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise" së paku një here në vit dhe në ueb faqen e Drejtorise së Veterinarise.

#### Pjesa V

### ENZIMET, MIKROORGANIZMAT DHE PERGATTJET E TYRE QË SHFRYTEZOHEHEN NË USHQIMIN E KAFSHEVE

#### Neni 42

#### Dispozita të vecanta për enzimet dhe mikroorganizmat dhe perгатitjet e tyre që shfrytezohehen për ushqimin e kafsheve

(1) Leshimi në qarkullim dhe perdorimi i enzimeve, mikroorganizmave dhe perгатitjeve të tyre në ushqimin e kafsheve eshte i lejuar, vetem nese në baze të informatave të kapshme, prodhimet nuk paraqesin rrezik për shendetesine publike dhe mbrojtjen shendetesore të kafsheve dhe se jane të perfshira në listen e perpiluar nga ana e Drejtorise për Veterinari.

(2) Ndalohet leshimi në qarkullim dhe perdorimi për qellimet e ushqimit të kafsheve të të gjitha formave tjera të enzimeve, mikroorganizmave dhe perгатitjeve të tyre të cilat nuk i plotesoje kerkesat e shenuara në paragrafin (1) të ketij neni, si dhe perdorimi i të gjitha formave tjera të perdorimit për ushqimin e kafsheve të cilat jane të ndryshme nga inkuorporimi i atyre prodhimeve në ushqimin për kafshe.

(3) Nese enzimet, mikroorganizmat dhe perгатitjet e tyre, më nuk i plotesoje kerkesat nga paragrafi (1) i ketij neni, ato terhiqen nga Lista e enzimeve, mikroorganizmave dhe perгатitjeve të tyre.

(4) Enzimet, mikroorganizmat dhe perгатitjet e tyre dhe premikset dhe perzierjet e tagjise në të cilat jane inkuorporuar nuk guxojne të leshohen në qarkullim ose të inkuorporohen në ushqimin për kafshe deri sa nuk shenohen në menyre perkatese.

(5) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave e percakton Listen e enzimeve dhe mikroorganizmave dhe të perгатitjeve të tyre, kriteret për leshimin e tyre në qarkullim dhe perdorimin dhe kushtet në aspekt të procedures dhe dokumentet të cilat jane të nevojshme të dorezohen për perfshirjen e tyre në Liste, permbajtjen dhe formen e Listes së enzimeve dhe mikroorganizmave dhe të

perгатitjeve të tyre, si dhe modelin për shenjen identifikuese, që duhet t'i plotesoje operatoret me ushqim për kafshe të cilet i prodhojne dhe i leshojne në qarkullim dhe karakteristikat të cilat doemos duhet të shenohen dhe menyren e shenimit gjate leshimit të tyre në qarkullim.

(6) Lista e enzimeve dhe mikroorganizmave, si dhe perгатitjet e tyre të cilat perdoren në ushqimin e kafsheve publikohet në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise" së paku një here në vit dhe në ueb faqen e Drejtorise së Veterinarise.

#### Pjesa VI

### AUTORIZIMI, PERDORIMI, MONITORIMI, MATJET E PERKOHSHME DHE SHENIMI I ADITIVEVE PËR USHQIM PËR KAFSHE

#### Neni 43

#### Leshimi në qarkullim i aditiveve për ushqim për kafshe

(1) Aditivet për ushqim për kafshe mund të leshohen në qarkullim, perpunohen dhe perdoren, vetem nese:

- jane të lejuara për leshim në qarkullim,
- jane plotesuar kushtet për perdorim në pajtim me dispozitat e ketij ligji dhe rregullat e miratuara në baze të ketij ligji dhe kushtet e vecanta në lejen për leshimin në qarkullim dhe

- i plotesoje kushtet për shenimin e aditiveve për ushqim për kafshe që jane të percaktuara me kete ligj.

(2) Me perjashtim nga paragrafi (1) i ketij neni, aditivet për ushqim për kafshe mund të leshohen në qarkullim, të perpunohen dhe perdoren, nese jane të lejuara për leshim në qarkullim në vendet anetare të Unionit Evropian.

(3) Personat të cilet kerkojne leje për leshim në qarkullim aditiv të ri për ushqim për kafshe ose për perdorim të ri të aditivit tanime të lejuar për ushqim për kafshe, jane të obliguar të parashtrojne kerkesa në Drejtorine për Veterinari të shoqeruar me dokumentacion percjelles. Personi i cili e parashtron kerkesen ose perfaqesuesi i tij juridik doemos duhet të kete cilesi të personit juridik në territorin e Republikës së Maqedonise.

(4) Drejtoria për Veterinari mban Regjister të aditiveve të lejuar për ushqim për kafshe.

(5) Drejtoria për Veterinari e publikon Regjistrin e aditiveve për ushqim për kafshe që kane leje për leshim në qarkullim së paku dy here në vit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise" dhe në ueb faqen e Drejtorise së Veterinarise.

(6) Me perjashtim nga paragrafi (1) i ketij neni, për eksperimente për qellime shkencore, Drejtoria për Veterinari mund të lejoje perdorimin si aditive, të substancave të cilat nuk posedojne leje për leshim në qarkullim në nivel nacional, me perjashtim të antibiotikeve, me kusht që eksperimentet të kryhen në pajtim me parimet dhe kushtet të cilat jane të percaktuara me kete ligj dhe nese ekziston mbikeqyrje perkatese zyrtare. Kafshet e prekura mund të shfrytezohehen për prodhimin e ushqimit për ushqimin e nje-rezve, vetem nese organet kompetente të administrates shteterore, vertetojne se kjo nuk ka ndikim negativ mbi shendetesine publike, sigurine shendetesore të kafsheve ose mjedisin jetesor.

#### Neni 44

#### Kushtet për lejim të aditiveve të ushqimit për kafshe

(1) Nuk do të jepet leje për leshim në qarkullim të aditivit për ushqim për kafshe deri sa aplikuesi në menyre perkatese dhe të kenaqshme nuk demonstroi se aditivi, kur shfrytezohehet në pajtim me kushtet të cilat jane dhene në shtojce të lejes për leshim në qarkullim, i ploteson kerkesat nga paragrafi (2) i ketij neni dhe ka së paku një prej karakteristikave të theksuara në paragrafin (3) të ketij neni.

(2) Aditiv i ushqimit për kafshe nuk guxon:

a) të kete ndikim negativ mbi shëndetësinë publike, mbrojtjen shëndetësore të kafsheve ose mjedisin jetësor;

b) të prezantohet në menyre e cila do të shkaktoje huti të konsumatorit dhe

v) ta demtojë konsumatorin me zvogelimin e karakteristikave të caktuara të prodhimit me origjinë shtazore ose t'i shkaktojë huti lidhur me karakteristikat e caktuara të atyre prodhimeve.

(3) Aditivi i ushqimit për kafshe doemos duhet:

a) të veproje në menyre të pershtatshme në karakteristikat e ushqimit për kafshe;

b) të veproje në menyre të pershtatshme në karakteristikat e produkteve me origjinë shtazore;

v) të ndikojë në menyre të pershtatshme në ngjyren e peshqve dhe shpezeve ornamentale;

g) t'i plotesoje nevojat nutritive të kafsheve;

d) të veproje në menyre të pershtatshme në mjedisin jetësor nga aspekti i prodhimeve blegtorale;

gj) të ndikojë në menyre të pershtatshme në prodhimet blegtorale, performansat e tyre ose mireqenien, vecanerisht me ndikim në floren gastro-intestinale ose digjestabilitetin e ushqimit për kafshe ose

e) të kete efekt kokcidiostatik ose histomonostatik.

(4) Antibiotiket, përvet atyre antibiotikeve që janë në kategorinë kokcidiostate ose histomonostate nuk do të lejohen si aditive për ushqim për kafshe.

Neni 45

#### Rivleresimi i perbashket

Leja për leshimin në qarkullim të aditiveve për ushqim për kafshe mund të rishqyrtohet në çdo kohe, në suaza të vlerësimeve të perbashketa të të gjithë aditiveve për ushqim për kafshe, në pajtim me kete ligj.

Neni 46

#### Kategorite e aditiveve të ushqimit për kafshe

(1) Aditivet për ushqim për kafshe ndahen në një ose më shumë kategori, varesisht nga funksionet dhe karakteristikat e tij.

(2) Në suaza të kategorive nga paragrafi (1) i ketij neni, aditivet më tutje ndahen në një ose më shumë grupe funksionale, varesisht nga funksioni i tyre kryesor ose funksionet.

(3) Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave i percakton kategoritë dhe grupet funksionale të aditiveve për ushqim për kafshe.

Neni 47

#### Kerkesa për lejim për leshim në qarkullim të aditiveve për ushqim për kafshe

(1) Aplikuesi për lejim për leshim në qarkullim parashtron kerkese për lejim për leshim në qarkullim të aditivit për ushqim për kafshe në Drejtorinë për Veterinari.

(2) Drejtoria për Veterinari, nepermjet Komisionit për Sigurinë e Ushqimit për Kafshe përpilon mendim në periudhë prej gjashtë muajsh nga data e pranimit të kerkësë valide.

(3) Leja për leshim në qarkullim jepet në kohezgjatje prej 10 vitesh dhe mund të rinovohet. Kerkesa për rinovim doemos duhet të dorëzohet në Drejtorinë për Veterinari së paku një vit para datës së skadimit të lejes. Në rast kur leja nuk i është leshuar bartesit të vecante, personi i cili i pari do ta leshojë në qarkullim aditivin, ose çdo pale e interesuar mund të parashtrrojë kerkese në Drejtorinë për Veterinari dhe konsiderohet për aplikues.

(4) Në rast kur autorizimi i leshohet bartesit të vecante, bartesi i autorizimit ose trashëgimtari i tij juridik apo trashëgimtarët mund të parashtrrojë kerkese në Drejtorinë për Veterinari.

(5) Kur kushtet për monitorim janë të dhena në shtojcë të lejes për leshim në qarkullim, bartesi i lejes doemos duhet të sigurohet se monitorimi është kryer edhe në Drejtorinë për Veterinari dhe parashtron raporte në pajtim me kushtet për lejim. Bartesi i lejes për leshim në qarkullim pa prolongim e njofton Drejtorinë për Veterinari për çdo informate të re e cila mund të ndikojë në vlerësimin e siguri-së gjatë përdorimit të aditivit për ushqim për kafshe, vecanerisht ndjeshmerinë e shëndetit të kategorive të vecanta të konsumatoreve. Bartesi i lejes për leshim në qarkullim pa prolongim doemos duhet ta informojë Drejtorinë për Veterinari për çdo ndalim ose kufizim të cilat janë të vendosura nga organi kompetent i vendit të trete në të cilin aditivi leshohet në qarkullim.

(6) Pasi aditivi do të lejohet në pajtim me kete ligj, çdo person i cili e përdor ose e leshon në qarkullim aditivin, ose ushqimin për kafshe ku aditivi është i inkorporuar ose ndonje pale tjetër e interesuar, doemos duhet të sigurohet se respektohen kushtet ose kufizimet të cilat kanë qene të vendosura në aspekt të leshimit në qarkullim të aditivit, përdorimi ose manipulimi me aditivin ose ushqimin për kafshe i cili e përmban aditivin konkret.

(7) Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave e percakton menyren për parashtrimin e kerkësë, si dhe formën dhe përmbajtjen e kerkësë për marrjen ose rinovimin e lejes për leshim në qarkullim të aditiveve për ushqim për kafshe.

Neni 48

#### Ndryshimi, pezullimi dhe terheqja e lejeve për leshim në qarkullim të aditiveve për ushqim për kafshe

(1) Bartesi i lejes për leshim në qarkullim mund të propozojë ndryshim të kushteve nga leja me parashtrimin e kerkësë në Drejtorinë për Veterinari, përcjelle me të dhena të domosdoshme në shtojcë të kerkësë për ndryshim.

(2) Gjatë informates së re ose rezultateve nga kontrollet zyrtare, Drejtoria për Veterinari, mund ta pezullojë lejen për leshim në qarkullim, nese një ose më shumë kushte nuk plotësohen më tutje. Vendimi për pezullimin e lejes për leshim në qarkullim i kumtohet bartesit të lejes pa prolongim bashkë me masat të cilat janë të domosdoshme për rinovimin e lejes, si dhe afati përfundimtar për zbatimin e këtyre masave. Afati përfundimtar nuk guxon të jete më i gjatë se një vit. Leja për leshim në qarkullim rinovohet pas inspektimit të Drejtorisë për Veterinari në vendin e ngjarjes që të verifikohen masat e zbatuara.

(3) Kur mangesite e konstatuara paraqesin rrezik të madh për shëndetësinë publike, mbrojtjen shëndetësore të kafsheve ose mjedisin jetësor, ose kur afati i fundit nga paragrafi (2) i ketij neni ka skaduar pa zbatim të verifikuar të masave korrigjuese nga ana e Drejtorisë për Veterinari, Drejtoria për Veterinari e terheq lejen për leshim në qarkullim dhe e informon bartesin e lejes për shkaqet për vendimin e tille.

(4) Kunder aktvendimit për marrjen e masave nga paragrafet (2) dhe (3) të ketij neni operatorët me ushqim për kafshe kanë të drejtë ankese në pajtim me dispozitat e Ligjit për shëndetësinë veterinarë.

(5) Në rastet e theksuara në paragrafet (1), (2) dhe (3) të ketij neni, Drejtoria për Veterinari e azhuron Regjistrin e aditiveve për ushqim për kafshe, pa prolongim.

Neni 49

#### Lejimi urgjent i aditiveve për ushqim për kafshe

Në rastet kur nevojitet leje urgjente që të sigurohet mbrojtja e mireqenies së kafsheve, Drejtoria për Veterinari mund perkohesisht të lejojë përdorimin e aditivit në periudhë kohore më së shumti pesë vjet.

## Neni 50

**Shenimi dhe paketimi i aditiveve për ushqim për kafshe dhe premikset e tyre**

(1) Aditivet për ushqim për kafshe ose premikset e aditiveve guxojne të leshohen në qarkullim, vetem nese paketimi i tyre ose kontejneri është shenuar nën përgjegjesine e prodhuesit, paketuesit, importuesit, shitesit ose distributorit, me seli në Republikën e Maqedonise dhe permban informata perkatese, të cilat doemos duhet të jene të dukshme, të lexueshme dhe të pashlyeshme, të shkruara në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik.

(2) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave i percakton kushtet më të peraferta për deklarim, si dhe karakteristikat minimale të cilat duhet të shenohen, si dhe menyren e pershkrimit të aditiveve të ushqimit për kafshe.

## Neni 51

**Leshimi në qarkullim i aditiveve për ushqim për kafshe**

Aditivet dhe premikset leshohen në qarkullim vetem në paketime të mbyllura dhe kontejnere, të mbyllura në menyre që gjate hapjes së paketimit ose kontejnerit, paketimi ose kontejneri nuk mund të riperdoren.

## Neni 52

**Kushtet e pergjithshme për përdorim të aditiveve për ushqim për kafshe**

(1) Sasia e aditiveve të cilet ekzistojne në gjendje natyrore në lende të para të caktuara të ushqimit për kafshe llogaritet ashtu që sasia e pergjithshme e elementeve që janë të pranishme në menyre natyrore, nuk e tejkalon nivelin maksimal i cili është i lejuar për leshim në qarkullim.

(2) Perzierja e aditiveve lejohet vetem tek premikset dhe ushqimi për kafshe ku ekziston kompatibilitet fiziko-kimik dhe biologjik ndermjet komponenteve të perzierjes lidhur me efektet e dëshiruara.

(3) Perzierjet plotesuese të tagjise, të ndara ashtu siç është shenuar, nuk guxojne të permbajne nivele të aditiveve që i tejkalojne ata që janë të percaktuar për perzierje të kompletuar të tagjise.

(4) Perzierja e aditiveve të cilet duhet t'i shiten drejtpërdrejt shfrytëzuesit të fundit do të lejohet, nese është në perputhje me kushtet për shfrytëzim të percaktuara në lejen për leshim në qarkullim për çdo aditiv të vecante.

## Neni 53

**Fshehtesia**

(1) Gjate procedures së kerkeses për lejim, aplikuesi duhet të tregoje se cila informate e parashtruar në pajtim me kete ligj dëshiron të trajtohet si e fshehte, me arsytim se zbulimi i saj në menyre të konsiderueshme do ta prishte gjendjen e tij konkurruese, percjellur me arsy të verifikuar për të.

(2) Drejtoria për Veterinari, pas konsultimit me aplikuesin, percakton se cilat prej informatave konsiderohen si të fshehta dhe për kete e informon aplikuesin.

(3) Informatat në vijim nuk konsiderohen si të fshehta:

a) emri dhe perbajtja e aditivit dhe ku është e pershtatshme lloji i prodhimit;

b) karakteristikat fiziko-kimike dhe biologjike të aditivit;

v) konkluzionet nga rezultatet e studimeve për efektet e aditivit mbi shendetesine publike, mbrojtjen shendetesore të kafsheve dhe mjedisin jetesor;

g) konkluzionet nga rezultatet e studimeve për efektet e aditiveve për karakteristikat e prodhimeve me origjine shtazore dhe cilesite e tyre ushqyese dhe

d) metodat për detektim dhe identifikim të aditiveve dhe ku është e aplikueshme kushtet për monitorim dhe rezime të rezultateve nga monitorimi.

(4) Fshehtesia nuk i perfshin informatat të cilat mund të kenë ndikim në shendetesine publike, mbrojtjen shendetesore të kafsheve dhe mjedisin jetesor.

(5) Nese personi që e parashtron kerkesen e terheq atë, Drejtoria për Veterinari e respekton fshehtesine e informatave komerciale dhe industriale, duke perfshire edhe informatat nga hulumtimet dhe zhvillimi.

## Neni 54

**Mbrojtja e të dhenave**

(1) Të dhenat shkencore dhe informatat tjera nga kerkesa nuk mund të shfrytëzohen në dobi të aplikuesit tjetër i cili parashtron kerkese në periudhe prej dhjete vitesh nga data e leshimit të lejes, pervec nese aplikuesi i cili e ka parashtruar kerkesen ka marreveshje me shkrim me aplikuesin i cili paraprakisht ka parashtruar kerkese se mund të shfrytëzohen ato të dhena dhe informata.

(2) Marrja e lejes për aditive për ushqim për lloje të kafsheve më pak të perfaqesuara, për aditive perdorimi i të cileve është i lejuar te llojet tjera, periudha dhjetevjecare e mbrojtjes së të dhenave vazhdohet pas një viti për çdo lloj tjetër plotesues të kafshes për të cilën është dhene leje për vazhdim.

(3) Aplikuesi dhe aplikuesi i meparshem duhet t'i ndermarrin të gjitha hapat e duhur që të arrihet marreveshje për shfrytëzimin e perbashket të informatave, me qellim që të mos perseriten testet toksikologjike të kurrizoreve. Nese, nuk arrihet marreveshje e tille për ndarjen e informates, Drejtoria për Veterinari mund të marre vendim që ta zbuloje informaten e cila është e domosdoshme për ta shmangur perseritjen e testeve toksikologjike të kurrizoreve, me sigurimin e balances së arsyeshme ndermjet interesave të paleve të interesuara.

(4) Pas skadimit të periudhes dhjetevjecare, të dhenat nga të gjitha ose nga një pjese e evaluimeve të cilat janë zbatuar në baze të të dhenave shkencore dhe informatat të cilat janë të permbajtura në kerkese mund të shfrytëzohen nga ana e Drejtorise për Veterinari në dobi të aplikuesit tjetër.

**Pjesa VII****USHQIMI PËR KAFSHE I MEDIKUAR**

## Neni 55

**Kushtet e pergjithshme të cilat zbatohen në ushqimin për kafshe të medikuar**

(1) Ushqimi për kafshe i medikuar mund të prodhohet vetem nga premikse mjekesore veterinare të lejuara në pajtim me rregullat për preparate mjekesore veterinare.

(2) Me perjashtim nga paragrafi (1) i ketij neni, me kusht që të jene të plotesuara kerkesat në pajtim me rregullat për preparate mjekesore veterinare, Drejtoria për Veterinari mund të lejoje që mjeket e mjekesise veterinare në pajtim me rregullat për preparate mjekesore veterinare dhe me përgjegjesi të tyre dhe në recete veterinare, të pershkruajne perpunim të ushqimit për kafshe të medikuar të disa premikseve të lejuara të medikuara, me ç'rast duhet të sigurojne se nuk permban asnje mjet të lejuar terapeutik specifik në forme të premiksit për semundjen e cila duhet të trajtohet, ose për llojin e dhene të kafsheve.

(3) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave e percakton menyren e pershkrimit të perpunimit të ushqimit për kafshe të medikuar në recete veterinare në pajtim me rregullat për preparate mjekesore veterinare.

Neni 56

**Kushtet e vecanta të cilat perdoren për ushqim për kafshe të medikuar**

(1) Ushqimi për kafshe i medikuar nuk guxon të magazinohet, leshohet në qarkullim ose perdoret, pervec nese nuk eshte i prodhuar në pajtim me dispozitat e ketij ligji dhe me rregullat e miratuara në baze të ketij ligji.

(2) Ushqimi për kafshe i medikuar mund të prodhohet vetem, nese:

1) prodhuesi ka lokale të cilat janë lejuar paraprakisht nga ana e Drejtorise për Veterinari, pajisje teknike dhe objekte perkatese dhe adekuate për magazinim dhe kontroll;

2) në objektin për prodhimin e ushqimit për kafshe të medikuar eshte punesuar së paku një person me shkalle të kryer VII/1 pergatitje profesionale-Fakultetin për mjekesi veterinare, si dhe me pervoje pune prej së paku tre vitesh në profesionin perkates me njohuri perkatese dhe kualifikime në teknologjine e prodhimit të ushqimit për kafshe;

3) prodhuesi eshte pergjegjes të siguroje se:

a) perdoret vetem ushqim për kafshe ose kombinimet e tij të cilat janë në perputhje me rregullat për ushqim për kafshe;

b) ushqimi për kafshe i cili perdoret jep perzierje homogjene dhe stabile me premikset e medikuara të lejuara;

v) premiksi i medikuar i lejuar shfrytëzohet gjate procesit të prodhimit në pajtim me kushtet e percaktuara në lejen për leshim në qarkullim, e vecanerisht se:

- nuk ekziston mundesi për kurrfare interakcioni të padeshiruar ndermjet preparateve mjekesore veterinare, aditiveve dhe ushqimit për kafshe,

- ushqimi për kafshe i medikuar ruhet për periudhen e parapare për ruajtje dhe

- ushqimi për kafshe që shfrytëzohet për prodhim të ushqimit për kafshe të medikuar nuk permban antibiotike të njejte ose kokcidiostatike të njejte, si ata që janë perdorur si substance aktive në premiksin e medikuar dhe

g) doza ditore e preparateve mjekesore eshte permbajtur në sasine e ushqimit për kafshe, e cila korrespondon me së paku gjysmen e porcionit ditor të ushqimit për kafshe, ose në rast të pertypesve, korrespondon me së paku gjysmen e nevojave ditore të ushqimit për kafshe plotesues jomineral;

4) lokalit dhe pajisja që shfrytëzohen dhe marrin pjese në procesin e pergjithshem të prodhimit janë në pajtim me rregullat dhe parimet për higjienen gjate prodhimit, ndersa procesi i prodhimit u pergjigjet rregullave për praktike të mire të prodhimit;

5) ushqimi për kafshe i medikuar i prodhuar i nenshtrohet kontrolleve të rregullta-duke perfshire edhe testimet laboratorike perkatese për homogjenitet-nga ana e objekteve prodhuese, nën mbikeqyrjen dhe kontrollet periodike nga Drejtoria për Veterinari, që të sigurohet se ushqimi për kafshe i medikuar eshte në pajtim me kushtet e parapara me kete ligj, vecanerisht në aspekt të homogjenitetit të tij, stabilitetit dhe magazinimit;

6) prodhuesit janë të obliguar të mbajne evidence ditore për llojin dhe sasine e premikseve mjekesore të lejuara dhe ushqimin për kafshe të perdorur dhe ushqimin për kafshe të medikuar të prodhuar, të mbajtur ose të derguar, bashke me emrat dhe adresat e pronareve ose rritesit e kafsheve, emrin dhe adresen e distributorëve të lejuar dhe ku eshte e pershtatshme emrin dhe adresen e mjekut veterinar i cili e ka shkruar ushqimin për kafshe të medikuar. Evidenca, e cila duhet t'u pergjigjet edhe rregullave për preparatet mjekesore veterinare doemos duhet të ruhet së paku tre vjet pas dates së hyrjes së fundit dhe doemos duhet të jete e kapshme në çdo kohe për Drejtorine për Veterinari në rast të kontrolleve dhe

7) premikset dhe ushqimi për kafshe i medikuar magazinohen në lokale adekuate të ndara dhe të siguruara ose kontejnere të mbyllur hermetikisht të cilat janë të dizajnuar në menyre speciale për magazinim të prodhimeve të tilla.

(3) Me perjashtim nga paragrafi (2) i ketij neni, Drejtoria për Veterinari mund t'u lejoje prodhim të ushqimit për kafshe të medikuar fermave në kushtet e dhena në paragrafin (2) të ketij neni.

(4) Varesisht nga kushtet e rregullave për preparatet mjekesore veterinare, Drejtoria për Veterinari mund të lejoje perjashtime nga ky ligj për qellime shkencore, nese sigurohet kontroll zyrtar i vecante dhe perkates.

(5) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave i percakton kushtet e vecanta në aspekt të objekteve, pajisjeve, personelit dhe menyren e punes që duhet ta permbushin operatorët për prodhim të ushqimit për kafshe të medikuar.

Neni 57

**Leshimi në qarkullim i ushqimit për kafshe të medikuar**

(1) Ushqimi për kafshe i medikuar leshohet në qarkullim vetem në paketim ose kontejnere të mbyllur në menyre me të cilen gjate hapjes, mbyllesit ose plomba demtohet dhe ata nuk mund të riperdoren.

(2) Atje ku shfrytëzohen autobote ose kontejnere të ngjashem për transport të ushqimit për kafshe të medikuar të papaketuar, doemos duhet të pastrohen para perdorimit të serishem me qellim që të mbrohen nga kontaminimi apo interaksioni i padeshirueshem i njepasnjeshem.

(3) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave i percakton kushtet e pergjithshme dhe të vecanta për leshimin e ushqimit të medikuar në qarkullim dhe perdorimin e tij.

Neni 58

**Shenimi i ushqimit për kafshe të medikuar**

(1) Ushqimi për kafshe i medikuar nuk guxon të leshohet në qarkullim, nese nuk eshte i shenuar qartesisht dhe nuk eshte në perputhje me kushtet për shenim në pajtim me dispozitat e ketij ligji dhe rregullat e miratuara në baze të ketij ligji, si dhe me dispozitat e ligjit me të cilin rregullohet siguria e ushqimit dhe rregullat e miratuara në baze të atij ligji.

(2) Paketimet ose kontejneret në të cilet eshte paketuar ushqimi për kafshe doemos duhet të jene të shenuara qartesisht me fjalet "Ushqim për kafshe i medikuar".

(3) Me perjashtim nga paragrafi (2) i ketij neni, kur autobotat ose kontejneret e ngjashem perdoren për transport të ushqimit për kafshe të papaketuar, informatat e shenuara në paragrafet (1) dhe (2) të ketij neni duhet të permbahen në dokumentin komercial percjelles.

(4) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave e percakton menyren e shenimit të ushqimit për kafshe të medikuar.

Neni 59

**Furnizimi dhe perdorimi i ushqimit për kafshe të medikuar**

(1) Ushqimi për kafshe i medikuar nuk guxon t'u dergohet fermereve ose rritesve të kafsheve, pervec nese nuk posedojne recete të dhene nga ana e veterinarit, i cili ka licençe për pune.

(2) Recetat për ushqim për kafshe të medikuar duhet të jene me forme perkatese dhe të leshuara në pajtim me rregullat nga paragrafi (6) i ketij neni.

(3) Ushqimi për kafshe i medikuar mund të furnizohet drejtpersedrejt nga fermeret ose rritesit e kafsheve vetem nga ana e prodhuesve ose distributorëve të lejuar.

(4) Kur ushqimi për kafshe i medikuar shfrytëzohet te kafshet prodhimet e të cilave shfrytëzohen në ushqimin e njerezve, fermeret ose rritesit e atyre kafsheve doemos duhet të sigurojne që kafshet e trajtuara nuk janë therur, perkatesisht prodhimet e tyre nuk janë perdorur para perfundi-

mit të periudhes së karences dhe se prodhimet e fituara nga kafshet e trajtuara para perfundimit të periudhes për terheqje menjaherë në menyre të pademshme.

(5) Drejtoria për Veterinari t'i ndermarre të gjitha masat e duhura, vecanerisht nepermjet kryerjes së kontrollit të mostrave të fermave dhe thertoreve, që të sigurohet se ushqimi për kafshe i medikuar shfrytezohe në pajtim me kushtet për perdorim dhe është i harmonizuar me periudhen e karences.

(6) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave i percakton formen dhe permbajtjen e recetes veterinarine për ushqimin për kafshe të medikuar dhe menyren e dhenies së saj.

### Pjesa VIII

#### MASAT MBROJTESE

##### Neni 60

#### Masat mbrojtese

Nese në baze të kontrollit të detajuar për shkak të të dhenave të reja ose vleresimit të ri të të dhenave ekzistuese, Drejtoria për Veterinari percakton se prodhimet nga pjeset I, III, IV, V, VI dhe VII të ketij kreu ose perdorimi i tyre në çfaredo kushtesh paraqet rrezik për shendetesine publike, mbrojtjen shendetesore të kafsheve dhe mjedisin jetesor, edhe pse jane në perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe rregullat e miratuara në baze të ketij ligji, drejtori i Drejtorise për Veterinari me aktvendim do ta ndaloje leshimin e tyre në qarkullim dhe/ose perdorimin.

##### Kreu VI

#### SUBSTANCA TË PADESHIRUARA

##### Neni 61

#### Ndalimi për leshim në qarkullim të substancave të padeshiruara

(1) Prodhimet që jane të dedikuara për ushqimin e kafsheve mund të importohen, leshohen në qarkullim dhe/ose perdoren vetem nese jane me perberje të mire, të vertete dhe të pershtatshem për shitje dhe që kur perdoren në menyren e parapare nuk paraqesin rrezik për shendetin e njerезve, mbrojtjen shendetesore të kafsheve ose mjedisin jetesor, e as nuk kane efekt negativ në prodhimin blegtoral.

(2) Prodhimet e dedikuara për ushqimin e kafsheve konsiderohen se nuk perputhen me paragrafin (1) të ketij neni, nese niveli i substancave të padeshiruara e tejkalon nivelin e lejuar maksimal për substancat e padeshiruara, të percaktuar në Listen e substancave të padeshiruara në ushqimin për kafshe.

(3) Prodhimet për ushqimin e kafsheve që permbajne substanca të padeshiruara mbi nivelin e lejuar maksimal nuk guxojne të perdoren në ushqimin e kafsheve.

(4) Prodhimet që jane të dedikuara për ushqim për kafshe, e që permbajne substanca të padeshiruara që e tejkalojne nivelin e lejuar maksimal, nuk guxojne të perzihen me prodhim të njejte ose prodhim tjetër të dedikuar për ushqim për kafshe, për qellime të rrallimit.

(5) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave e percakton Listen e substancave të padeshiruara në ushqimin për kafshe dhe nivelin e lejuar maksimal.

##### Neni 62

#### Toleranca dhe hulumtimi i substancave të padeshiruara

(1) Substancat e padeshiruara që jane të perfshira në Listen e substancave të padeshiruara nga neni 61 paragrafi (5) i ketij ligji, është e lejuar të tolerohen, vetem në ushqim për kafshe dhe në kushte të percaktuara me rregulle të vecante për sigurine e ushqimit për kafshe.

(2) Që të zvogelohen ose eliminohen burimet e substancave të padeshiruara të prodhimeve të dedikuara për ushqim për kafshe, Drejtoria për Veterinari, në bashkepunim me operoret për ushqim për kafshe, kryen hetim për identifikimin e burimit të substancave të padeshiruara, në rast kur tejkalohe niveli i lejuar maksimal ose në raste kur detektohet tejkalim i nivelit të lejuar maksimal, duke i pasur parasysh nivelet paraprake, dhe merr masa për zvogelimin ose eliminimin e nivelit të substancave të padeshiruara.

(3) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave i percakton menyren e hetimit për identifikimin e burimit dhe shkaqet për tejkalimin e nivelit të lejuar maksimal dhe piken kritike për kryerjen e analizave të tilla.

##### Neni 63

#### Masat e sigurise në rast të të dhenave të reja

(1) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave me propozim të drejtorit të Drejtorise për Veterinari, në raste kur ka baze, të bazuar në informatat e reja ose vleresim të serisem të informatave tanime ekzistuese, me të cilat tregohet se niveli i lejuar maksimal i percaktuar në Listen e substancave të padeshiruara ose se substancat e padeshiruara të cilat nuk jane të shenuara në Liste, paraqesin rrezik për shendetin e njerезve dhe kafsheve dhe mjedisin jetesor, mund të urdheroje zvogelimin e nivelit të lejuar maksimal ekzistues, ta percaktoje nivelin e lejuar maksimal ose ta ndaloje pranine e asaj substance të padeshiruar në prodhimet e dedikuara për ushqim për kafshe.

(2) Urdheri i ministrit nga paragrafi (1) i ketij neni bashke me arsyetimin jane të kapshem për publikun dhe publikohen në mediumet e shkruara publike.

##### Kreu VII

#### USHQIMI PËR KAFSHE I MODIFIKUAR GJENETIKISHT

##### Neni 64

#### Ushqimi për kafshe i modifikuar gjenetikiisht

(1) Në ushqimin për kafshe të modifikuar gjenetikiisht (MGJ) perfshihen:

a) organizmat e modifikuar gjenetikiisht (OMGJ) që shfrytezohe si ushqim për kafshe;

b) ushqimi për kafshe i cili permban ose perbehet nga OMGJ-ja dhe

v) ushqimi për kafshe i prodhuar nga ose i cili permban perberes të prodhuar nga OMGJ-ja.

(2) Ushqim për kafshe (MGJ) duhet:

- të mos kete ndikim të demshem për shendetin e njerезve, mbrojtjen shendetesore të kafsheve ose mjedisin jetesor,

- të mos shkaktoje huti tek konsumatori,

- të mos e demtojne konsumatorin me ndryshimin e karakteristikeve të caktuara të prodhimeve me origjine shtazore dhe

- të mos dallohet aq nga ushqimi për kafshe i cili sipas dedikimit të vet do të duhej të zevendesohet për konsumimin e tij për konsumatorin e fundit në kuptim ushqimor të jete i papershtatshem për kafshet ose njerезit.

(3) Në ushqimin për kafshe MGJ zbatohen dispozitat e ketij ligji, si dhe rregullat e vecanta nga sfera e mbrojtjes së mjedisit jetesor.

##### Neni 65

#### Leshimi në qarkullim i ushqimit për kafshe MGJ

(1) Për leshimin në qarkullim të ushqimit për kafshe MGJ për here të pare në qarkullim në Republikën e Maqedonise subjektet që merren me ushqim doemos duhet të sigurojne harmonizim me dispozitat e ketij ligji, si dhe rregullat nga sfera e mbrojtjes së mjedisit jetesor.

(2) Lejen për leshim në qarkullim të ushqimit të ri për here të pare në qarkullim e leshon ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave dhe ministri i Mjedisit Jetesor dhe Planifikimit Hapesinor, e në pajtim me rregullat që kanë të bëjnë me kushtet dhe procedurat për leshimin e ushqimit të ri MGJ për here të pare në qarkullim në Republikën e Maqedonise, si dhe kerkesat specifike lidhur me shenimin e ushqimit për kafshe MGJ.

(3) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave në pajtim me ministrin e Mjedisit Jetesor dhe Planifikimit Hapesinor i percakton kushtet dhe proceduren për leshimin e lejes për leshim në qarkullim të ushqimit për kafshe MGJ dhe kushtet për qarkullimin dhe perdorim e tij.

Neni 66

#### **Regjistri i lejeve të leshuara për leshim në qarkullim të ushqimit për kafshe MGJ**

(1) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave mban Regjister për lejet e leshuara për leshimin në qarkullim të ushqimit për kafshe MGJ.

(2) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave e percakton formatin dhe permbajtjen dhe menyren e mbajtjes së Regjistrin nga paragrafi (1) i ketij neni.

Neni 67

#### **Menaxhimi me rrezik gjate leshimit në qarkullim të ushqimit për kafshe MGJ**

(1) Nese ekzistojne dilema shkencore rreth ndikimit të demshem të ushqimit për kafshe MGJ mbi mbrojtjen shendetesore, ministri kompetent i bujqesise, pylltarise dhe ekonomise së ujerave në pajtim me ministrin kompetent të mjedisit jetesor dhe planifikimit hapesinor do të urdheroje masa të perkohshme për ndalim për leshimin në qarkullim të tyre në perputhje me parimin e kujdesit.

(2) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave mund të urdheroje edhe masa tjera perkatese, si dhe kushtet dhe menyren e zbatimit të atyre masave.

(3) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave do të urdheroje ndalim të perhershëm për leshimin në qarkullim të ushqimit për kafshe MGJ, nese në baze të vleresimeve shkencore të rrezikut konstatohet demi i tij për shendetin e njerzve dhe mbrojtjen shendetesore të kafsheve.

Neni 68

#### **Ndjekja dhe shenimi i ushqimit për kafshe MGJ**

(1) Në fazen e pare të leshimit në qarkullim të ushqimit për kafshe i cili permban dhe/ose perbehet prej OMGJ-së, duke i perfshire edhe sasite në gjendje refuze (të shperndare), operoret me ushqim të tille për kafshe duhet të sigurojne se i jane dorezuar në forme të shkruar subjektit i cili e pranon atë ushqim për kafshe, informatat në vijim:

- se ushqimi ose ushqimi për kafshe permban dhe/ose perbehet prej OMGJ-së dhe
- shenjen unike të identifikimit në pajtim me rregullen për zbatim.

(2) Ushqimi për kafshe MGJ i cili leshohet në qarkullim doemos duhet që krahas kerkesave të pergjithshme për shenim në pajtim me kete ligj, në deklarate të permbaje edhe të dhena shtese të vecanta, që konsumoret të informohen për të gjitha karakteristikat dhe/ose cilesite e atij ushqimi për kafshe.

(3) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave në pajtim me ministrin e Mjedisit Jetesor dhe Planifikimit Hapesinor i percakton kushtet për leshim në qarkullim të ushqimit për kafshe i cili permban dhe/ose perbehet prej OMGJ-së, duke perfshire edhe sasite në gjendje refuze (të shperndare), si dhe perdorimin e ushqimit për kafshe MGJ dhe kushtet që kanë të bëjnë me ndjekjen, shenimin e ushqimit për kafshe MGJ dhe kerkesat e vecanta për shenim të vecante.

## **Kreu VIII**

### **KONTROLLET ZYRTARE**

#### **Pjesa I**

#### **DISPOZITAT E PERGJITHSHME**

Neni 69

#### **Obligimet e pergjithshme**

(1) Kontrollet zyrtare të ushqimit për kafshe kryhen në:

- a) prodhimtarine primare dhe veprimtarite shoqeruese;
- b) prodhimin dhe perpunimin dhe
- v) shitjen me pakice.

(2) Organizimi dhe kryerja e kontrolleve zyrtare, si dhe obligimet e operoreve me ushqim për kafshe gjate realizimit të tyre kryhet në pajtim me dispozitat për kontrolle zyrtare të ketij ligji dhe rregullat e miratuara në baze të ketij ligji, si dhe dispozitat e ligjit me të cilin rregullohet siguria e ushqimit dhe rregullat e miratuara në baze të atij ligji.

Neni 70

#### **Kriteret operative për organin kompetent**

(1) Drejtoria për Veterinari doemos duhet t'i siguroje zbatimin e kriterëve operative dhe koordinimin ndermjet të gjithë trupave që marrin pjese në kryerjen e kontrolleve zyrtare mbi operoret me ushqimin për kafshe në pajtim me dispozitat e percaktuara në ligjin me të cilin rregullohet siguria e ushqimit.

(2) Operoret me ushqim për kafshe jane të obliguar që të mundesojne cfaredo kontrolli zyrtar i cili kryhet në pajtim me dispozitat e ketij ligji dhe t'u ofrojne ndihme personave zyrtare të Drejtorise për Veterinari për kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 71

#### **Ndarja e detyrave specifike lidhur me kontrollet zyrtare**

Drejtoria për Veterinari mund t'u ndaje detyra të caktuara specifike lidhur me kontrollet zyrtare një apo më shume trupave kontrollues në pajtim me dispozitat nga rregullat për zbatimin e ketij ligji, si dhe dispozitat nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit.

Neni 72

#### **Personat që kryejne kotrolle zyrtare**

(1) Drejtoria për Veterinari siguron se personat e autorizuar për kryerjen e kontrolleve zyrtare i plotesojne kushtet në aspekt të trajnimit dhe kompetences, në pajtim me dispozitat për trajnim dhe kompetence të ligjit me të cilin rregullohet siguria e ushqimit dhe i plotesojne dispozitat nga Ligji për shendetesi veterinarë.

(2) Për veprimin e personave të autorizuar për kontroll zyrtar zbatohen dispozitat e rregullave nga paragrafi (1) i ketij neni dhe të Ligjit për procedure të pergjithshme administrative.

Neni 73

#### **Transperenca dhe fshehtesia**

Drejtoria për Veterinari siguron transparence, si dhe fshehtesi të informatave të cilat sipas natyres së tyre jane të mbrojtura si të fshehta në realizimin e kompetencave të saj, në pajtim me dispozitat për transparence dhe fshehtesi të informatave nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit.

## Neni 74

**Procedurat kontrolluese dhe verifikuese**

Drejtoria për Veterinari kryen kontrolle zyrtare në pajtim me procedurat e percaktuara në ligjin me të cilin rregullohet siguria e ushqimit. Procedurat permbajne informata dhe instruksione për personat e autorizuar për kryerjen e kontrolleve zyrtare.

## Neni 75

**Procesverbale**

(1) Për kontrollet e kryera zyrtare perpilohen procesverbale.

(2) Procesverbalet nga paragrafi (1) i ketij neni permbajne pershkrim të qellimit të kontrolleve zyrtare, metodat e kontrollit që jane zbatuar, rezultatet e kontrolleve zyrtare dhe kur eshte e pershtatshme, aktivitetet të cilat operatori me ushqim për kafshe duhet t'i ndermarre.

(3) Ekzemplar nga procesverbali nga paragrafi (2) i ketij neni, në rast të paperputhshmerise së konstatuar, i parashtrahet operatorit me ushqim për kafshe.

## Neni 76

**Aktivitetet kontrolluese, metodat dhe teknikat**

(1) Kontrollet zyrtare kryhen me shfrytëzimin e metodave dhe teknikave kontrolluese perkatëse, siç jane monitorimi, mbikeqyrja, verifikimi, auditimi, inspektimi, marrja e mostrave dhe analiza.

(2) Gjate realizimit të aktivitetëve kontrolluese zyrtare, metodave dhe teknikave zyrtare kontrolluese mbi ushqimin për kafshe, zbatohen dispozitat nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit.

## Neni 77

**Metodat për marrjen e mostrave dhe analiza**

(1) Metodot për marrjen e mostrave dhe analiza që shfrytëzohen gjate kontrolleve zyrtare doemos duhet të jene në pajtim me dispozitat e ketij ligji dhe rregullat e miratuara në baze të ketij ligji, dispozitat nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit dhe rregullat e miratuara në baze të atij ligji, si dhe me dispozitat nga Ligji për shendetesi veterinare dhe rregullat e miratuara në baze të atij ligji.

(2) Nese nuk ekzsitojne rregulla në pajtim me paragrafin (1) të ketij neni, atehere zbatohen:

a) me rregullat e pranuar nderkombetare ose protokollet, rregullat dhe protokollet të cilat Keshilli Evropian për Standardizim (CEN) i ka pranuar ose për ato të cilat jane të pranuar në legjislacionin e UE-së ose

b) në mungese të rregullave dhe protokolleve nga pika a) e ketij paragrafi, me metoda tjera adekuate për qellimet për të cilat jane dedikuar ose zhvilluar në pajtim me protokollet shkencore.

(3) Në rastet kur metodat e marrjes së mostrave dhe analizat nga paragrafi (1) i ketij neni nuk aplikohen, validiteti i metodave dhe analizave mund të zhvillohet në çdo laborator në pajtim me protokollin e pranuar nderkombetar.

(4) Kur eshte e mundur, metodat e analizës duhet të karakterizohen me kriteret adekuate të cilat jane percaktuar me dispozitat e ketij ligji dhe rregullat e miratuara në baze të ketij ligji, dispozitat nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit dhe rregullat e miratuara në baze të atij ligji, si dhe me dispozitat nga Ligji për shendetesi veterinare dhe rregullat e miratuara në baze të atij ligji.

(5) Operatorët me ushqim për kafshe prodhimet e të cilëve jane objekt i marrjes së mostrave dhe analizës, kanë të drejte për mendim profesional plotësues, me kete rast pa u prejjudikuar obligimi i organit kompetent për marrjen e masave urgjente në rast të rrezikut të papritur.

(6) Drejtoria për Veterinari vecanerisht duhet të siguroje që operatorët me ushqim për kafshe të marrin numer të mjaftueshem të mostrave për mendim profesional plotësues, pervec nese kjo eshte e pamundur në rast të prodhimeve që prishen lehte ose për shkak të sasive shume të vogla të substratit që disponon.

(7) Mostrat doemos duhet të merren, shenohen dhe me to të veprohet në menyren e cila e garanton validitetin e tyre juridik dhe analitik.

(8) Shpenzimet për marrjen e mostrave dhe për kryerjen e analizës nga ky nen i bart Drejtoria për Veterinari, pervec në rastet nga paragrafi (7) i ketij neni dhe nese rezultati nga analiza eshte i pavolitshem.

(9) Mjetet për shpenzimet nga paragrafi (8) i ketij neni sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonise.

**Pjesa II****PARIMET E PERGJITHSHME TË KONTROLLEVE ZYRTARE TË SIGURISE SË USHQIMIT PËR KAFSHE**

## Neni 78

**Kushtet e pergjithshme dhe obligimet e organit kompetent**

(1) Drejtoria për Veterinari kryen kontroll zyrtar në të gjithë zinxhirin e prodhimit, perpunimit dhe distribuimit të ushqimit për kafshe duke perfshire marrjen e mostrave, me qellim që të sigurohet harmonizimi me qellimet e ketij ligji.

(2) Kur Drejtoria për Veterinari do të konstatoje se qarkullimi dhe perdorimi i ushqimit për kafshe paraqet rrezik për shendetin e njerezve, mbrojtjen shendetesore të kafsheve dhe mjedisin jetesor, merr masa perkatëse për menjanimin, eliminimin ose zvogelimin e nivelit të pranueshem të rrezikut.

(3) Me kerkese të personit të autorizuar të Drejtorise për Veterinari, personi i cili eshte i obliguar për prodhimin, perpunimin, distribuimin ose perdorimin e ushqimit për kafshe, eshte i detyruar t'i jape të dhenat dhe informatat e kerkuara dhe të marre masa dhe aktivitete perkatëse për vendosjen e perputhshmerise së ushqimit për kafshe me dispozitat e ketij ligji dhe rregullat e miratuara në baze të ketij ligji, si dhe dispozitat nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit dhe rregullat e miratuara në baze të atij ligji.

## Neni 79

**Procedura për edukim**

(1) Nese gjate kryerjes së mbikeqyrjes zyrtare personi i autorizuar konstaton se eshte kryer parregullsi nga neni 103 paragrafi (1) i ketij ligji, eshte i obliguar që të perpiluje procesverbal në të cilin do ta percaktoje parregullsinë e kryer me sugjerim për menjanimin e parregullsise së percaktuar në afat prej pesembedhete ditësh dhe me dorezim të njekohshem të fteses për realizimin e edukimit të operatorit me ushqim për kafshe i cili eshte pergjigjes për prodhimin, perpunimin, distribuimin ose perdorimin e ushqimit për kafshe ku eshte percaktuar parregullsia gjate kryerjes së kontrollit zyrtar.

(2) Formen dhe permbajtjen e fteses për edukim, si dhe menyren e realizimit të edukimit i percakton ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave.

(3) Edukimin e organizon dhe realizon Drejtoria për Veterinari, në afat jo më të gjate se 8 dite nga dita e kryerjes së mbikeqyrjes zyrtare.

(4) Edukimi mund të realizohet për më shume parregullsi të percaktuara të njejtë ose të njellojta për një ose më shume subjekte.

(5) Nese në terminin e caktuar operatori me ushqim për kafshe për të cilin realizohet edukimi, nuk paraqitet për edukim, do të konsiderohet se edukimi eshte realizuar.

(6) Nese operatori me ushqim për kafshe mbi të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e kryen, do të konsiderohet se është edukuar lidhur me parregullsite e percaktuar.

(7) Nese personi i autorizuar gjate kryerjes së kontrolleve zyrtare konstaton se jane menjanuar parregullsite e konstatuara nga paragrafi (2) i ketij neni, miraton konkluzion me të cilin e nderpret proceduren e mbikeqyrjes zyrtare.

(8) Nese personi i autorizuar gjate kryerjes së kontrollit zyrtar konstaton se nuk jane menjanuar parregullsite e konstatuara nga paragrafi (1) i ketij neni, parashtron kerkese për ngritjen e procedures për kundervajtje para organit për kundervajtje në pajtim me kete ligj.

(9) Drejtoria për Veterinari, mban evidence për edukimin e realizuar në menyren e percaktuar nga ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave.

#### Neni 80 Raporti kuartal

Për kontrollet e kryera zyrtare personat e autorizuar pergatisin pasqyre kuartale e cila publikohet në ueb faqen e Drejtorise për Veterinari.

#### Pjesa III

### KONTROLLET ZYRTARE TË USHQIMIT PËR KAFSHE GJATE IMPORTIT TË USHQIMIT PËR KAFSHE

#### Neni 81 Kontrollet zyrtare të ushqimit për kafshe me origjine shtazore

Krahas kontrolleve që kryhen në pajtim me rregullat për shendetesine veterinarë për kontrollet veterinarë të produkteve në vendkalimet kufitare, Drejtoria për Veterinari do të kryejë kontrolle plotesuese që konsiderohen si të domosdoshme për verifikimin e harmonizimit me kete ligj dhe dispozitat për kontrolle zyrtare të ushqimit për kafshe të importuar dhe të eksportuar nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit.

#### Neni 82 Kontrollet zyrtare të ushqimit për kafshe me origjine joshtazore

Drejtoria për Veterinari kryen kontrolle të rregullta zyrtare të ushqimit për kafshe i cili nuk është me origjine shtazore, i cili importohet në Republikën e Maqedonise, dhe i cili nuk është perfshire me rregullat për produkte që i nenshtrohen detyrimisht kontrollit sanitar-veterinar në kufi. Kontrollet kryhen në baze të planit kontrollues shumevjeçar të perpiluar në pajtim me dispozitat nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit dhe lidhur me rrezikun potencial. Kontrollet duhet t'i mbulojnë të gjitha aspektet e rregullave për sigurine e ushqimit për kafshe dhe të jene në pajtim me dispozitat për llojet e kontrolleve të ushqimit për kafshe nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit.

#### Neni 83 Llojet e kontrolleve të ushqimit për kafshe me origjine joshtazore

(1) Kontrollet zyrtare të ushqimit për kafshe me origjine joshtazore gjate hyrjes në Republikën e Maqedonise perfshijne së paku kontroll të kompletuar të dokumenteve, kontroll të identitetit me zgjedhje të rastesishme, dhe nese është e pershtatshme kontroll fizik i cili mund të perfshije edhe marrjen e mostrave.

(2) Gjate kryerjes së kontrolleve zyrtare të ushqimit për kafshe me origjine joshtazore zbatohen dispozitat për llojet e kontrolleve të ushqimit për kafshe nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit.

#### Neni 84 Vendet për hyrje dhe njoftimi paraprak

Drejtoria për Veterinari për organizimin e kontrolleve zyrtare të ushqimit për kafshe i cili importohet:

- shenon në cilat vende kryhen kontrollet për tipa të vecante të ushqimit për kafshe dhe
- vendos procedure për operatorët me ushqim për kafshe për dorezimin e notifikimit të meparshem për arritjen e tyre dhe karakterin e dergeses.

#### Neni 85 Veprimet në rast të dyshimit

(1) Kur ekziston dyshim për mosperputhje, ose dyshim për identitetin ose destinacionin e vërtete të dergeses, ose mosperputhshmeri ndermjet dergeses dhe certifikates, Drejtoria për Veterinari kryen kontrolle zyrtare me qellim të konfirmimit ose menjanimit të dyshimit.

(2) Drejtoria për Veterinari e vendose dergesen nën mbikeqyrje zyrtare deri në marrjen e rezultateve të kontrolleve zyrtare të theksuara.

#### Neni 86 Aktivitetet pas kontrolleve zyrtare të ushqimit për kafshe të importuar nga vendet e treta

Drejtoria për Veterinari merr masa adekuate, nese gjate kryerjes së kontrolleve zyrtare konstaton se ushqimi për kafshe i importuar nga vendet e treta nuk është në perputhshmeri me dispozitat e rregullave për sigurine e ushqimit dhe/ose konstaton se dergesa është e demshme për shendetin e njerezve dhe mbrojtjen shendetesore të kafsheve ose nuk është i sigurt, dhe pas konsultimit me operatorin me ushqim për kafshe pergjegjes për dergesen, merr dhe urdheron masa në pajtim me dispozitat për aktivitetet e kontrollit zyrtar të ushqimit për kafshe të importuar nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit.

#### Neni 87 Trajtimi i vecante

(1) Trajtimi i vecante i ushqimit për kafshe mund të perfshije:

a) trajtim ose perpunim të ushqimit për kafshe që të harmonizohet me dispozitat e ketij ligji dhe rregullat e miratuara në baze të ketij ligji, si dhe me dispozitat nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit dhe rregullat e miratuara në baze të atij ligji, ose me kerkesat nga vendi në të cilin kthehet ose riorientohet, duke perfshire dhe nese është e pershtatshme dekontaminimin, por me perjashtim të rrallimit dhe

b) perpunim në menyre adekuate për qellime tjera pervec për ushqimin e kafsheve dhe njerezve.

(2) Trajtimi i vecante kryhet në objektet nën kontroll të Drejtorise për Veterinari dhe në pajtim me dispozitat e ketij ligji dhe rregullat e miratuara në baze të ketij ligji.

#### Neni 88 Ridergimi i dergesave

Drejtoria për Veterinari do të lejoje ridergim të dergesave me ushqim për kafshe, në pajtim me dispozitat për ridergimin e dergesave nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit.

#### Neni 89 Shpenzimet

Operatorët me ushqim për kafshe pergjegjes për dergesen ose perfaqesuesit e tyre jane të detyruar t'i shlyejne shpenzimet e Drejtorise për Veterinari për aktivitetet e zbatimit të masave të kontrolleve plotesuese të ushqimit për kafshe i cili importohet në Republikën e Maqedonise.

## Neni 90

**Bashkepunimi me sherbimet doganore**

(1) Për organizimin e kontrolleve zyrtare gjate importit të ushqimit, Drejtoria për Veterinari dhe sherbimet doganore vendosin bashkepunim.

(2) Sherbimet doganore nuk guxojne të lejojne hyrje ose manipulim me ushqim për kafshe pa leje nga Drejtoria për Veterinari.

(3) Kur merren mostrat, Drejtoria për Veterinari doemos duhet t'i informoje sherbimet doganore dhe operatorët me ushqim për kafshe që jane të prekur dhe të shenoje nese ushqimi për kafshe mund ose nuk mund të leshohet në qarkullim para se të merren rezultatet nga analizat, me ç'rast duhet të garantohet vijimesia e dergeses.

(4) Në rast të leshimit në qarkullim, Drejtoria për Veterinari dhe sherbimet doganore bashkepunojne në pajtim me rregullat për punen doganore.

## Neni 91

**Masat për zbatim**

Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerrave më afersisht i percakton:

a) kushtet veterinaro-sanitare të cilat duhet t'i plotesoje ushqimi për kafshe i cili importohet në Republikën e Maqedonise;

b) menyren e kontrollit të ushqimit për kafshe i cili importohet në Republikën e Maqedonise dhe

v) proceduren e ushqimit për kafshe:

- të importuar ose të vendosur në procedure doganore,

- ushqimin për kafshe të porositur prej larg (për shembull nepermjet postes, telefonit ose internetit) dhe të derguar te konsumatori,

- ushqimin për kafshe të dedikuar për kanakare dhe kuaj që jane në pronesi të udhetareve ose ekuipazhit të mjeteve nderkombetare për transport,

- dergesat me origjine nga Republika e Maqedonise që jane të kthyera nga vendi i trete,

- dokumentet që doemos duhet t'i shoqerojne dergesat kur merren mostrat dhe

- formen dhe permbajtjen e certifikatave, kualifikimet e veterinerit zyrtar që e nenshkruan certifikaten dhe parimet dhe proceduren për certifikim.

## Neni 92

**Financimi i kontrolleve zyrtare**

Mjetet për financimin e kontrolleve zyrtare të ushqimit për kafshe sigurohen në pajtim me dispozitat nga Ligji për shendetesi veterinarë.

## Neni 93

**Kompenzime**

(1) Për mbulimin e shpenzimeve për kryerjen e kontrolleve zyrtare paguhet kompensim.

(2) Operatorët me ushqim për kafshe paguajne kompensim për:

a) procedurat për regjistrim ose lejim të objekteve dhe operatorëve me ushqim për kafshe;

b) kryerjen e kontrolleve zyrtare të ushqimit për kafshe dhe

v) kontrollin e importit të ushqimit për kafshe.

(3) Kur do të konstatohet mosharmonizim i cili imponon kryerje të kontrolleve zyrtare që i tejkalojne aktivitetet e zakonshme kontrolluese të Drejtorise për Veterinari, shpenzimet për ato aktivitete plotesuese i bart operatori me ushqim për kafshe pergjegjes për mosharmonizimin e tille ose mund t'i ngarkoje operatorët të cilet jane pronare ose të cilet i ruajne prodhimet në kohen kur kryhen kontrollet zyrtare plotesuese, për shpenzimet që dalin nga kontrollet zyrtare plotesuese. Aktivitetet të cilat i tejkalojne aktivitetet e zakonshme kontrolluese perfshijne marrje dhe analize të mostrave, si dhe kontrolle tjera që jane të nevojshme që të kontrollohet madhesia e problemit, të verifikohet nese jane ndermarre aktivitete korrigjuese ose të zbulohet dhe/ose të konstatohet mosharmonizimi.

(4) Shpenzimet për kontrollet e kryera nuk mund të rifundohen, drejtperdrejt apo terthorazi, pervec nese jane të arketuara në menyre të padrejte.

(5) Operatorët me ushqim për kafshe duhet të pranojne deshmi për pagesen e tyre të shpenzimeve.

(6) Kriteret më të peraferta nga paragrafi (3) i ketij neni për percaktimin e lartesisë së shpenzimeve, si dhe menyren e llogaritjes dhe pageses së tyre i percakton Qeveria e Republikës së Maqedonise.

## Neni 94

**Programe shumevjecare, programe vjetore dhe urdhra vjetore për mbrojtje shendetesore të kafsheve dhe për shendetesi veterinarë publike**

(1) Për zbatimin e masave sanitare-veterinare dhe kryerjen e kontrolleve, ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerrave më së voni deri më 31 dhjetor çdo vit, miraton urdher vjetor për zbatimin e masave sanitare-veterinare dhe kryerjen e kontrolleve të sigurise së ushqimit për kafshe nga aspekti i shendetesise veterinarë publike dhe e cakton periudhen për zbatimin e atyre masave për vitin e ardhshem.

(2) Për zbatimin e masave nga paragrafi (1) i ketij neni, Qeveria e Republikës së Maqedonise miraton program vjetor për shfrytezim të mjeteve për zbatimin e masave sanitare-veterinare dhe kryerjen e kontrolleve të sigurise së ushqimit për kafshe nga aspekti i shendetesise veterinarë publike.

(3) Drejtori i Drejtorise për Veterinari e koordinon zbatimin e urdhrat vjetor dhe programit vjetor nga paragrafet (1) dhe (2) të ketij neni.

(4) Deri më 31 mars të vitit rrjedhes drejtori i Drejtorise për Veterinari i parashton ministrit të Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerrave raport vjetor për punen e kryer lidhur me rezultatet teknike dhe financiare për vitin kalendarik paraprak.

(5) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerrave deri më 30 prill parashton raport vjetor në Qeverine e Republikës së Maqedonise për menyren e shfrytezimit të mjeteve nga programi vjetor nga paragrafi (2) i ketij neni.

## Neni 95

**Masat në rast të mosperputhshmerise**

(1) Kur Drejtoria për Veterinari ose trupat kontrollues konstatojne veprim në kundërshtim me dispozitat e ketij ligji dhe rregullat e miratuara në baze të ketij ligji, si dhe me dispozitat nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit dhe rregullat e miratuara në baze të atij ligji doemos duhet të marrin masa me të cilat do të sigurohet menjanimi i mangesive të konstatuara. Gjate vendosjes se cilat masa do të merren, Drejtoria për Veterinari ose trupat kontrollues i marri parasysh llojin e kundervajtjes dhe veprimet e deriatehershme të operatorëve me ushqim për kafshe në zbatimin e rregullës.

(2) Masat nga paragrafi (1) i ketij neni sipas nevojës perfshijne edhe:

a) vendosjen e procedurave sanitare-veterinare dhe procedurave tjera, të cilat konsiderohen si të nevojshme për sigurimin e rregullshmerise shendetesore të ushqimit për kafshe, ose zbatimin e dispozitave të ketij ligji dhe rregullave të miratuara në baze të ketij ligji, si dhe të dispozitave nga ligji me të cilin rregullohet siguria e ushqimit dhe rregullave të miratuara në baze të atij ligji, ose rregullave të miratuara në baze të Ligjit për mbrojtjen dhe mireqenien e kafsheve;

b) kufizimin ose ndalimin për leshim në qarkullim, importin dhe/ose eksportin e ushqimit për kafshe;

v) monitorimin dhe (sipas nevojës) urdhrin që ushqimi për kafshet të terhiqet, kthehet dhe/ose asgjesohet;

g) lejimin që ushqimi për kafshe të shfrytëzohet për qëllime tjera nga ato për të cilat ka qene së pari i dedikuar;

d) ndalimin e perkohshem për pune ose mbyllje të tere objektit për ushqim për kafshe ose vetem të një pjese të tij në interval kohor perkates;

gj) shfuqizimin e perkohshem apo të perhershëm të le-  
jes për pune të objektit i cili merret me ushqim për kafshe;

e) masat e caktuara me rregull të vecante për dergesat nga importi dhe

zh) masat tjera të cilat Drejtoria për Veterinari i konsideron si të nevojshme.

(3) Sipas nevojës, Drejtoria për Veterinari për vendimin e saj e informon organin kompetent në vendin e origjines.

(4) Të gjitha shpenzimet e bera në lidhje me zbatimin e dispozitave të ketij nenin i bart operatori me ushqim për kafshe pergjegjes.

Neni 96

#### **Plani shumevjecar për kontrolle**

(1) Që të sigurohet kryerje efektive e kontrolleve zyrtare, Drejtoria për Veterinari perpilon dhe miraton plan shumevjecar për kontrolle të ushqimit për kafshe. Plani shumevjecar për kontrolle mund të jete pjese perberese e planeve tjera për kontroll.

(2) Plani shumevjecar për kontroll botohet në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise" dhe në ueb faqen e Drejtorise së Veterinarise.

Neni 97

#### **Raporti**

(1) Drejtori i Drejtorise për Veterinari perpilon raport vjetor për zbatim të planit shumevjecar për kontrollet zyrtare të cilin e dorezon te ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave dhe Komisioni Evropian më së voni deri më 31 mars të vitit rrjedhes.

(2) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave e percakton formen dhe permbajtjen e raportit vjetor për zbatimin e planit shumevjecar për kontrolle zyrtare.

Neni 98

#### **Bashkepunimi i ndersjelle ndermjet trupave kompetente nacionale**

Kur rezultatet nga kontrollet zyrtare të ushqimit për kafshe, qofte në territorin e Republikës së Maqedonise, qofte në territorin e ndonje shteti tjetër, kerkojne marrjen e masave në më shume shtete, Drejtoria për Veterinari bashkepunon me trupat kompetente të shteteve tjera.

Neni 99

#### **Bashkepunimi me organet tjera**

Inspeksionet që nuk jane të perfshira në kuader të organit kompetent jane të obliguar që gjate kryerjes së kontrolleve zyrtare të bashkepunojne me Drejtorine për Veterinari, të marrin pjese në perpilimin e planit nacional shumevjecar për kontroll, të marrin pjese në perpilimin e raportit vjetor për kontrollet zyrtare, si dhe të sigurojne financimin e kontrolleve zyrtare në kuader të kompetencave të tyre.

## **Kreu IX**

### **DISPOZITA NDESHKUESE**

Neni 100

Personi zyrtar i cili me shfrytëzimin e pozites së tij zyrtare ose autorizimit, ose me moskryerjen e detyres së tij zyrtare, nuk do të vendose për ankesen në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të ankeses kunder aktvendimit të Drejtorise së Veterinarise me të cilin refuzohet kerkesa e tij për miratimin e operatorit dhe objektit me ushqim për kafshe, në pajtim me nenin 27 paragrafi (9) të ketij ligji, penalisht do të pergjigjet në pajtim me ligjin.

Neni 101

#### **Kundervajtjet**

(1) Gjobe në shume prej 5 000 eurosh në kundervlere me denare do t'i shqiptohet personit juridik, nese:

1) kryen import ose futje të ushqimit për kafshe në Republikën e Maqedonise në kundershtrim me kushtet e shenuara në nenin 10 paragrafi (2) të ketij ligji;

2) kryen eksport të ushqimit për kafshe nga Republika e Maqedonise në kundershtrim me kushtet e shenuara në nenin 11 të ketij ligji;

3) leshon në qarkullim ose perdor ushqim për kafshe i cili nuk i ploteson kerkesat lidhur me rregullshmerine shendetesore të ushqimit për kafshe, të shenuara në nenin 12 të ketij ligji;

4) ushqimi për kafshe nuk i ploteson rregullat për sigurine e ushqimit për kafshe lidhur me rregullshmerine e ushqimit për kafshe në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) të ketij ligji;

5) gjate kryerjes së cilesdo faze të prodhimit, perpunit dhe distribuimit të ushqimit nuk i plotesojne kushtet higjienike të shenuara në nenin 24 paragrafet (2) dhe (3) të ketij ligji;

6) shfrytëzojne ushqim për kafshe nga objekte dhe operatore me ushqim për kafshe që nuk jane të regjistruar dhe/ose lejuar në pajtim me rregullat për ushqim për kafshe në pajtim me nenin 24 paragrafi (5) të ketij ligji;

7) nuk vendos, implementon dhe mban procedura të rregullta të dokumentuara në pajtim me parimet e HACCP-së, siç eshte theksuar në nenin 25 paragrafet (1), (2), (3) dhe (5) të ketij ligji;

8) objektet që jane nën kontrollin e tyre nuk jane të regjistruara te organi kompetent në pajtim me dispozitat e nenit 26 paragrafet (1) dhe (2) të ketij ligji;

9) objektet që jane nën kontrollin e tyre nuk jane të lejuara nga organi kompetent në pajtim me dispozitat e nenit 27 paragrafet (1) dhe (2) të ketij ligji;

10) leshon në qarkullim lende të para të ushqimit për kafshe të cilat nuk i plotesojne dispozitat e nenit 35 paragrafet (1), (2), (3), (4), (5), (6), (7) dhe (8) të ketij ligji;

11) leshon në qarkullim perzierje të tagjise të cilat nuk i plotesojne dispozitat e nenit 37 paragrafet (1) dhe (2) të ketij ligji;

12) leshon në qarkullim ushqim për kafshe me qellime të vecanta nutritive që nuk i ploteson dispozitat e nenit 40 të ketij ligji;

13) leshon në qarkullim prodhime të caktuara që shfrytëzohen në ushqimin e kafsheve të cilat nuk i plotesojne dispozitat e nenit 41 të ketij ligji;

14) leshon në qarkullim enzime dhe mikroorganizma dhe pergatitje të tyre të cilat shfrytëzohen në ushqimin e kafsheve të cilat nuk i plotesojne dispozitat e nenit 42 paragrafet (1), (2), (3) dhe (4) të ketij ligji;

15) leshon në qarkullim aditive të ushqimit për kafshe që nuk i plotesojne dispozitat e nenit 43 paragrafet (1), (2) dhe (5) të ketij ligji;

16) aditivi të cilin e leshon në qarkullim nuk i permbush kushtet e dhena në nenin 44 paragrafet (2), (3) dhe (4) të ketij ligji;

17) aditivet dhe premikset e tyre të cilët i leshon në qarkullim janë të shenuara ose të paketuara në kundërshtim me dispozitat nga nenet 50 paragrafi (1) dhe 52 të ketij ligji;

Пред поднесување на барање за поведување на прекршочна постапка за прекршоците предвидени со овој закон, Агенцијата води постапка за порамнување согласно со Законот за прекршоците.

### XIX. ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ

#### Член 146

(1) Подзаконските акти предвидени со овој закон ќе се донесат во рок од 18 месеци од денот на неговото влегување во сила.

(2) До донесување на прописите од ставот (1) на овој член ќе продолжат да се применуваат постојните прописи.

(3) До започнување со работа Агенцијата за лекови, работите од надлежност на Агенцијата за лекови утврдени со овој закон ќе ги врши Бирото за лекови.

#### Член 147

(1) Правните лица кои ставаат во промет хемикалии ќе ја усогласат својата работа со одредбите од овој закон во рок од една година од денот на влегувањето во сила на овој закон.

(2) Доколку правните лица кои ставаат во промет хемикалии не ја усогласат својата работа со одредбите од овој закон во рокот утврден во ставот (1) на овој член, им се одзема дозволата за вршење дејност со хемикалии и се бришат од регистрите кои се водат согласно со овој закон.

#### Член 148

Поднесените барања за производство, промет и распределба на смеси по група на отровност до денот на влегувањето во сила на овој закон ќе се решат согласно со прописите кои важеле до денот на влегувањето во сила на овој закон.

#### Член 149

Јавната здравствена установа овластена пред денот на влегувањето во сила на овој закон продолжува да ги врши работите на Национален центар за контрола и информирање за труење од хемикалии.

#### Член 150

До акредитацијата на лабораториите, анализата на мострите од членот 135 на овој закон ќе ја вршат постојните лаборатории.

#### Член 151

Владата на Република Македонија ќе го формира Интерсекторското тело од членот 10 на овој закон во рок од три месеца од денот на влегувањето во сила на овој закон, а ќе започне со работа од 1 јануари 2011 година.

#### Член 152

Започнатите постапки пред денот на влегувањето во сила на овој закон ќе се завршат според одредбите од Законот за хемикалии („Службен весник на Република Македонија“ број 113/2007).

#### Член 153

Со денот на влегувањето во сила на овој закон престанува да важи Законот за хемикалии („Службен весник на Република Македонија“ број 113/2007).

#### Член 154

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

## L I G J PËR KIMIKALE

### I. DISPOZITA TË PERGJITHSHME

#### Neni 1

(1) Me kete ligj rregullohen klasifikimi, paketimi dhe shenimi i kimikaleve, kushtet për prodhimin e kimikaleve, të drejtat dhe obligimet e personave juridike të cilet prodhojne, i leshojne në qarkullim kimikalet apo i perdorin kimikalet, mbajtja e regjistrit të kimikaleve, kufizimi dhe ndalimi i prodhimeve, leshimi në qarkullim dhe perdorimi i kimikaleve, importi dhe eksporti i disa kimikaleve të caktuara, leshimi në qarkullim i prodhimeve biocide dhe detergjenteve, mbikeqyrja, si dhe ceshtje tjera të cilat kane të bejne me kimikalet.

(2) Me kete ligj rregullohen edhe procedura për paraqitjen e substancave të reja dhe vleresimin e substancave ekzistuese, procedura për notifikacion, reklamim, procedurat për njohje të ndersjelle të certifikatave dhe obligimet për informim.

#### Neni 2

Ky ligj bazohet në parimin e kujdesit të prodhuesit, importuesit apo shfrytezuesit të metejme, të cilet kur prodhojne, leshojne në qarkullim ose shfrytezojne kimikale, që ta sigurojne shmangien e efekteve të padeshirueshme mbi shendetin e njerezve dhe mjedisin jetesor.

#### Neni 3

Qellimi i ketij ligji eshte që të sigurohet nivel i larte i mbrojtjes së shendetit të njerezve dhe mjedisit jetesor, duke e perfshire edhe prezantimin e metodave alternative për vleresimin e rreziqeve të cilat dalin nga substancat, si dhe sigurimin e perparimit të konkurrences së inovacionit.

#### Neni 4

Shprehje të caktuar të perdorura në kete ligj e kane kete domethenie:

1. "Kimikal" eshte substanca dhe perzierja;
2. "Substance" eshte elementi kimik ose bashkimi i tyre në gjendje natyrore apo të perfituara nga procesi prodhues, duke perfshire edhe aditive të nevojshem që të ruhet stabiliteti i tyre apo nga papastertite që dalin nga procesi prodhues, me perjashtim të tretesve të cilet mund të ndahen pa ndikuar në stabilitetin e substances apo ndryshimin e perberjes së saj;
3. "Perzierje" eshte perzierja apo tretja e perbere nga dy ose më shume substanca;
4. "Substance siperfaqesore aktive (SSA)" eshte cilado substance organike dhe/ ose perzierje e cila ka veti aktive siperfaqesore dhe e cila mban një ose më shume grupe hidrofobe apo hidrofobe të cilat kane aftesi që ta zvogelojne tensionin siperfaqesor të ujit duke formuar monoshtrere të zgjeruar apo atorbuese në kontakt ujë-ajer, me ç'rast duke formuar emulsion dhe/ose mikroemulzion dhe/ose micel, dhe të atorbobet në kufirin mes ujit dhe siperfaqes së ngurte;
5. "Shfrytezes i metejshem" eshte çdo person fizik ose juridik në territorin e Republikes së Maqedonise, i cili nuk eshte prodhues i substances apo importues i kimikaleve, i cili e shfrytezon substancën, e paperzier ose të perzier për qellime industriale apo profesionale, duke perfshire edhe personin i cili e prodhon perzierjen. Distribuesit dhe konsumesit nuk konsiderohen për shfrytezes të metejme;

6. "Distribues" është çdo person fizik ose juridik në territorin e Republikës së Maqedonisë duke i përfshirë edhe tregtarët me pakicë, të cilët vetëm depozitojnë apo vendosin në qarkullim substanca si të tilla ose në perzierje, për persona të trete;

7. "Furnizues" është çdo person fizik i cili vepron si prodhues, importues, distribues apo shfrytëzues i metejme i cili kimikalet i leshon në qarkullim;

8. "Porosites i prodhimeve" është çdo prodhues apo importues i prodhimit, distributor ose pjesëmarrës tjetër në furnizim që vendos prodhim (artikull) në qarkullim;

9. "Qarkullim" është importi, eksporti, transporti, transiti, depozitimi, shitja dhe/ose përdorimi i kimikaleve, si dhe ndërmjetësimi tregtar i tregut vendas dhe të huaj;

10. "Leshim në qarkullim" është furnizimi apo qasja në kimikale për persona të trete në territorin e Republikës së Maqedonisë, me kompensim ose pa kompensim, me ç'rast edhe importi konsiderohet si leshim në qarkullim;

11. "Prodhim" është prodhimi apo ekstrakti i substancave në gjendje natyrore;

12. "Prodhim (apo artikull)" është lenda e cila gjatë prodhimit merr formë, sipërfaqe ose dizajn të posacem, i cili e përcakton funksionin e saj në shkallën më të lartë të përberjes së tij kimike;

13. "Prodhues" është çdo person juridik i cili e prodhon apo përfiton kimikalin, si dhe çdo person juridik i cili kryen përpunim plotësues, ripaketimin ose e ndryshon emrin e kimikalit në përdorimin e metejshëm;

14. "Personel mjekësor" është çdo mjek i mjekësisë së përgjithshme apo person i cili punon në drejtim të mjekut të regjistruar të mjekësisë së përgjithshme i cili vepron në sferën e kujdesit të pacientëve, përcakton diagnoza apo përshkruan trajtim, i cili obligohet për fshehtësi profesionale;

15. "Propozues" është prodhuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar i cili e propozon vendosjen e biocidit në qarkullim;

16. "Përdorim" është çdo përpunim, formulim, konsumim, magazinim, ruajtje, procedure, mbushje e kontejnereve, bartje nga njëri në kontejnerin tjetër, perzierje, prodhim ose ndonjë përdorim tjetër;

17. "Notifikacion" është njoftimi për dokumentacion me informatat e nevojshme të cilat dërgohen në organin kompetent;

18. "Notifikues" është prodhuesi ose përfaqësuesi tjetër i tij që e leshon kimikalin në qarkullim dhe e dërgon notifikacionin në organin e administratës shtetërore, e cila është kompetente për punët të cilat kanë të bëjnë me kimikale;

19. "Bioshpërberje primare" është ndryshimi strukturor (transformimi) i substancave sipërfaqësore me mikroorganizma me ç'rast humbet aftësia e saj sipërfaqësore aktive për shkak shpërberjes së strukturës së saj;

20. "Bioshpërberje perfundimtare aerobe" është niveli i tillë i bioshpërberjes së substancës përfshirëse aktive e cila me ndihmën e mikroorganizmave në prani të oksigjenit shpërbehet në dioksid karboni, ujë dhe kripera minerale (mineralizim);

21. "Prodhime biocide" janë substanca dhe perzierje të cilat përmbajnë një ose më shumë substanca aktive të përgatitura në formën perfundimtare të cilat i rekomandohen shfrytëzuesit, të dedikuara për shkatërrim, pengim të vepimit apo zvogëlim të rrezikut, për arritjen e efekteve kontrolluese të cilitdo organizem të demshëm nepermjet menyrës kimike ose biologjike;

22. "Detergjent" është substanca apo perzierje e cila përmban sapunë dhe/ose substanca tjera sipërfaqësore aktive të dedikuara për larje dhe pastrim. Në detergjente bien edhe perzierjet ndihmëse për larje (paralarje, shpëlarje dhe/ose zbardhje të rrobave), zbutësit për veshje, perzierjet për pastrime tjera dhe ngjashëm;

23. "Lende për përdorim të përgjithshëm" janë substanca dhe perzierje të cilat vendosen në qarkullim, pa u ditur shfrytëzuesi perfundimtar i tyre, ndërsa mundësia për blerjen ose përdorimin e tyre nuk është e kufizuar as sipas sasisë, as me disa kërkesa të posacme lidhur me shfrytëzuesin perfundimtar;

24. "Praktike e mire laboratorike" është sistemi i kualitetit në procedurat për leshimin e kimikaleve në qarkullim dhe përdorimin e tyre, regjistrimin, paraqitjen apo paralajmerimin gjatë hulumtimit të cilesive të kimikaleve;

25. "Hulumtim dhe zhvillim shkencor" është çdo eksperiment shkencor, analize ose hulumtim kimik i realizuar në kushte të kontrolluara;

26. "Larje" është pastrim i veshjes, enëve dhe sipërfaqeve të ngurta;

27. "Skenar i ekspozimit" është grumbullimi i kushteve dhe masave, duke i përfshirë kushtet në vendin e punës, me të cilat menaxhohet me rrezikun nga kimikalet, e të cilat përshkruajnë se si prodhohet dhe përdoret substanca gjatë jetës edhe si substancë kontrollohet nga ana e prodhuesit apo importuesit, me këte rast duke i dhënë rekomandim shfrytëzuesit të metejme apo importuesit, se si të kontrollohet substanca kur në ndikimin e saj të demshëm janë të nënshtruar njerezit dhe mjedisi jetësor. Rekomandimi mund t'i dedikohet një procesi specifik ose menyre të shfrytëzimit ose disa proceseve ose menyra të shfrytëzimit të substancave;

28. "Hedhurina" janë hedhurinat e kimikaleve të pashfrytëzuara, kimikale të cilave u ka kaluar afati i përdorimit dhe ambalazhi i hedhurinave;

29. "Polimere" janë substanca të përbera nga molekula të cilat e karakterizojnë zinxhirin e një ose më shumë llojeve të njesive monomere. Masat molekulare të këtyre molekulave detyrimisht duhen të jenë me masa të ndryshme molekulare ku dallimet në masat molekulare në menyre primare kanë të bëjnë me dallimet në numrin e njesive të monomereve. Sipas kësaj nocioni njesia monomere është forma reaktante e monomerit në polimer;

30. "Monomer" është substanca e cila mund të vendosë lidhje kovalente me zinxhir të molekulave të tjera të ngjashme ose të ndryshme nën kushte të reagimit të dhene të formojë polimer i cili shfrytëzohet për procesin e dhene;

31. "Paraqites" është prodhuesi ose importuesi i substancave ose prodhuesi ose importuesi i produktit që parastron kërkesë për regjistrimin e substancave;

32. "Nenprodukt" është substanca e cila prodhohet, shfrytëzohet ose përdoret për përpunimin kimik me qëllim që të transformohet në substancë tjetër (në tekstin e metejme: sinteza);

33. "Nenprodukt i paizoluar" është nenprodhimi i cili gjatë sintezës nuk është i larguar qellimisht (përpos për marrjen e ekzemplareve) nga pajisja në të cilën kryhet sinteza. Pajisja përfshin enën të reaksionit, pajisje të saj ndihmëse, si dhe çfaredo lloj pajisje nepermjet të ciles kalon substanca gjatë kohës së rrjedhës së vazhdueshme, si dhe gypat për bartje prej njerës enë në tjetren për hapin e ardhshëm të reaksionit. Në pajisje bien enët në të cilat depozitohet substanca pas prodhimit;

34. "Nenprodukt i izoluar aty për aty" është nenprodukti i cili nuk i plotëson kriteret për nenprodukt të paizoluar dhe prodhimi i të cilit si dhe sinteza e substancës tjetër nga nenprodukti i njëjtë në vendin e njëjtë nga ana e një ose më shumë personave juridike;

35. "Gjysmeprodukt i izoluar i transportuar" është gjysmeprodukti që nuk i plotëson kriteret e gjysmeproduktit të paizoluar që transportohet ose distribuohet në vende tjera dhe

36. "Pjesëmarrës në zinxhirin e furnizimeve" janë të gjithë prodhuesit dhe/ose importuesit dhe/ose shfrytëzuesit e metejme në zinxhirin e furnizimeve.

## Neni 5

Dispozitat e ketij Ligji zbatohen edhe në:

- prodhimin dhe qarkullimin e armeve kimike dhe kimikaleve për perfitimin e armeve kimike, nese me kete Ligj ndryshe nuk eshte e rregulluar,
- prodhimin dhe qarkullimin e prekuzoreve, nese me Ligj tjetër ndryshe nuk eshte e rregulluar dhe
- lendet për përdorim të përgjithshëm.

## Neni 6

(1) Dispozitat e ketij Ligji nuk zbatohen për:

- 1) kimikale radioaktive;
- 2) kimikale të cilat barten nepermjet transitit neper Republikën e Maqedonisë;
- 3) nenprodukte të paizoluara, transport të kimikaleve të rrezikshme;

4) kimikale të cilat vleresohen për hedhurine, në pajtim me dispozitat që e rregullojnë menaxhimin me hedhurina dhe

5) kimikale të cilat janë lende e mbikeqyrjes doganore, të vendosura në depot doganore ose zonat e lira me qëllim të eksportit apo transitit të perseritur, nese kimikalet nuk i nënshtrohen procesit të përpunimit apo riperpunimit.

(2) Dispozitat nga ky Ligj që kanë të bëjnë me regjistrimin/shenimin e kimikaleve në Regjistrin për kimikale dhe substanca të cilat shkaktojnë brengosje, nuk zbatohen për kimikale të cilat në formen perfundimtare leshohen në qarkullim, si:

- 1) produkte biocide;
- 2) mjete për mbrojtjen e bimeve;
- 3) barera dhe mjete ndihmese mjekesore të cilat përdoren për mjekesi humane dhe veterinare;
- 4) produkte kozmetike;
- 5) ushqim, aditive për ushqim dhe arome dhe
- 6) ushqim dhe aditive për ushqim të cilat i konsumojnë kafshet.

(3) Dispozitat e ketij Ligji të cilat kanë të bëjnë me klasifikimin, shenimin dhe paketimin nuk zbatohen për:

1) kimikale të cilat shfrytezohen për hulumtime shkencore dhe zhvillim, të cilat nuk vendosen në qarkullim, por shfrytezohen në kushte të kontrolluara, ku ekspozimi në to eshte i zvogeluar dhe

2) kimikale të cilat vendosen në qarkullim në formen perfundimtare, si:

- barera dhe mjete ndihmese mjekesore të cilat përdoren për mjekesine humane dhe veterinare,
- produkte kozmetike,
- ushqim, aditive për ushqim dhe arome dhe
- ushqim dhe aditive për ushqim të cilat i konsumojnë kafshet.

## Neni 7

Punet administrative dhe profesionale lidhur me kimikale i kryen Agjencia për Barera.

## Neni 8

(1) Agjencia për Barna:

- 1) miraton akte nenligjore për zbatimin e ketij Ligji;
- 2) e publikon listen e substancave të klasifikuara;
- 3) e publikon listen e substancave me rrezik të larte (të cilat shkaktojnë brengosje);
- 4) e publikon listen e ndalimeve dhe kufizimeve për përdorim;
- 5) mban Regjister për kimikale;
- 6) leshon leje për vendosjen e prodhimeve biocide në qarkullim;
- 7) kryen vleresim të dosjeve teknike të prodhimeve biocide;
- 8) realizon procedure për informim paraprak dhe procedure për marrjen e pelqimit në baze të informimit paraprak për importin dhe eksportin e disa kimikaleve të rrezikshme;

9) jep leje për kryerjen e veprimtarise, prodhimeve, qarkullimit dhe përdorimit të kimikaleve;

10) leshon leje për shfrytezimin e substancave siperfaqesore aktive (SSA) në detergjente;

11) përpunon dhe realizon projekte me të cilat përcillet leshimi i kimikaleve në qarkullim dhe shfrytezimi i tyre në menyre që nuk do të shkaktojë ndikim të demshëm në shendetin e njerezve dhe mjedisit jetesor;

12) e publikon listen e substancave aktive në produktin biocid;

13) miraton aktvendime për regjistrimin e produkteve biocide në listen e perkohshme për dergimin e dosjes teknike;

14) leshon leje për vendosjen e prodhimeve biocide në qarkullim;

15) përgatit deklarata vjetore për prodhimin, përpunimin dhe shfrytezimin e kimikaleve nga lista e përcaktuar me dispozitat të cilat e rregullojnë ndalimin e prodhimtarise, depozitimin dhe përdorimin e armes kimike dhe shkakterimin e saj, përgatit deklarate vjetore për prodhimin e substancave diskrete organike dhe i rregullon punet tjera të cilat janë lende e asaj dispozite;

16) u jep informata dhe udhëzime profesionale industriale, njesive të vetadministrimit lokal dhe inspektoreve për realizimin e ketij ligji dhe ligjeve tjera për të cilat eshte kompetente Agjencia e Barerave;

17) bashkepunon me Agjencine Evropiane për Kimikale (ESNA), agjencite e vendeve tjera dhe Sekretariatin e Konventes Nderkombetare, të cilat merren me aspekte tjera të menaxhimit me kimikale;

18) e informon publikun më të gjere për ndikimin e kimikaleve në shendetin e njerezve dhe mjedisit jetesor dhe realizon masa për zvogelimin e rrezikut nga rreziku gjate shfrytezimit të kimikaleve;

19) themelon Zyre për ndihme (helpdesk) e cila u jep keshilla prodhuesve, importuesve, distribuesve, shfrytëzuesve të metejshëm dhe paleve tjera të interesuara për obligimet dhe përgjegjesite e tyre në pajtim me kete Ligj dhe

20) kryen edhe pune të tjera të përcaktuara me Ligj.

(2) Agjencia për Barna listat nga paragrafi 1 të ketij neni, i publikon në ueb faqen e Agjencise për Barna.

(3) Lartesine e mjeteve për realizimin e aktiviteteve nga paragrafi 1 pikat 6, 7, 8, 9, 10, 13 dhe 14 të ketij neni, si dhe kompensimet tjera të përcaktuara me nenet 81, 87 paragrafi (4), 88 paragrafi (4) dhe 94 paragrafi (6) të ketij Ligji, në baze të harxhimeve të shkaktuara reale i përcakton drejtori i Agjencise për Barna.

## Neni 9

(1) Ministri i Shendetesise e autorizon institucionin shendetesor publik i cili i kryen punet e Qendres nacionale për kontroll dhe informim për helmim nga kimikalet (në tekstin e metejme: Qendra nacionale).

(2) Qendra nacionale nga paragrafi (1) i ketij neni grumbullon dhe përpunon të dhena për helmime akute nga kimikalet dhe efektet tjera të padëshirueshme, informon për helmime akute nga kimikalet dhe efektet tjera të padëshirueshme, e mban bazen e të dhenave për helmime akute nga kimikalet dhe efektet tjera të padëshirueshme, e kryen dokumentimin, informimin dhe jep sherbime konsultuesve për helmimet akute nga kimikalet dhe efektet tjera të padëshirueshme, e mban regjistrin e rasteve të fatkeqesive të helmimit nga kimikalet, si dhe merr pjese në formulimin dhe kontrollin e bazes qendrore të antidoteve në Republikën e Maqedonisë.

(3) Furnizuesit e kimikaleve dhe të gjitha institucionet shendetesore të cilat disponojnë me të dhenat për efekte akute dhe/ose të padëshirueshme gjate ekspozimit, si dhe ekspozimit profesional në kimikale dhe/ose efekte të padëshirueshme gjate helmimit me kimikale obligohen që të dergojnë të dhena me kerkese të Qendres Nacionale.

(4) Тë dhenat nga paragrafi (3) i ketij neni permbajne perberje të perzierjeve kimike të vendosura në qarkullim dhe të klasifikuara si të rrezikshme në baze të efekteve të tyre shendetesore dhe fiziko-kimike, duke perفشire edhe identitetin kimik të substancave në perberjet për të cilat është e pranueshme kërkesa për shfrytezimin e emrit alternativ të kimikalit.

(5) Тë dhenat nga paragrafi (3) i ketij neni të cilat dorezohen në Qendren nacionale janë të fshehta dhe mund të shfrytezohehen për:

- plotesimin e kërkesave shendetesore me formulimin e masave preventive dhe kurative, vecanerisht në raste urgjente,

- realizimin e analizës statistikore me qellim që të percaktohet se ku janë të nevojshme masa më të mira për menaxhim me rrezikun dhe

- për punë të tjera të nevojshme për realizimin e detyrave të qendrës nacionale.

(6) Formën, permbajtjen dhe menyren e mbajtjes së regjistrit nga paragrafi (2) i ketij neni i percakton drejtori i Agjencisë për Barna.

#### Neni 10

(1) Për sigurimin e bashkepunimit ndersektorial, për percjelljen e realizimit të ketij Ligji, propozimin e ndryshimeve dhe plotesimeve të Ligjit në baze të rekomandimeve evropiane dhe boterore në menaxhimin me kimikale, dhenien e rekomandimeve dhe drejtimeve për nevojat për perforcimin e kapaciteteve në nivel qendror dhe lokal dhe në industri në pajtim me rekomandimet evropiane dhe nderkombetare dhe bashkepunim me trupat relevante, Qeveria e Republikës së Maqedonisë formon trup ndersektorial për kimikale.

(2) Trupin ndersektorial për kimikale e perbejne 11 anetare prej të cileve nga një perfaqesues nga: Agjencia për Barna, Ministria e Shendetesise, Ministria e Mjedisit Jetesor dhe Planifikimit Hapesinor, Ministria e Puneve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Ekonomise, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Financave - Drejtoria Doganore, Qendra për Menaxhim me Kriza dhe Shoqata e Industrisë Kimike.

(3) Me trupin ndersektorial udheheq perfaqesuesi nga Agjencia për Barna.

(4) Trupi ndersektorial punon në pajtim me rregulloren për punë.

(5) Punet profesionale administrative dhe teknike të trupit ndersektorial i kryen Agjencia për Barna.

## II. KLASIFIKIMI, PAKETIMI DHE SHENIMI I SUBSTANCAVE DHE PERZIERJEVE

#### Neni 11

(1) Prodhuesi, importuesi ose shfrytezuesi i metejme i cili leshon në qarkullim kimikale ose prodhim të caktuar në qarkullim obligohet që t'i klasifikojë, ndersa furnizuesi i kimikaleve t'i shenojë dhe paketojë në pajtim me kete Ligj dhe aktet nenligjore të cilat dalin nga ai.

(2) Eksportuesi obligohet që kimikalet t'i eksportoje, t'i paketoje dhe shenojë në pajtim me kete Ligj dhe aktet nenligjore të cilat dalin nga ai, pervec nese është e nevojshme që kimikalet të paketohehen dhe shenohen në menyre tjetër në pajtim me standardet nderkombetare, me kërkesë të vendit në të cilin eksportohet kimikali.

#### Neni 12

(1) Klasifikimi i kimikaleve do të realizohet në baze të vleresimit të cilesive fizike dhe kimike, cilesive të cilat ndikojnë në shendetin e njerezve dhe mjedisin jetesor, si dhe në baze të kriterëve për klasifikimin e kimikaleve në lloje të caktuara të rrezikut.

(2) Për kimikale të rrezikshme vleresohen kimikalet të cilat mund të klasifikohen së paku në një lloj të rrezikut.

(3) Në kuader të klasave për rrezik, kimikali mund të klasifikohet në baze të rruges së ekspozimit të shendetit të njerezve ose mjedisit jetesor të kimikaleve ose sipas natyres së efektit të kimikalit.

(4) Menyren e klasifikimit dhe shenimit të kimikaleve të rrezikshme i percakton ministri i Shendetesise në pajtim me ministrin e Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerrave dhe ministrin e Mjedisit Jetesor dhe Planifikimit Hapesinor.

#### Neni 13

(1) Klasifikimi i substances kryhet në pajtim me klasifikimin e substances me perberje të njejte kimike nga lista e substancave të klasifikuara.

(2) Nese substanca nuk gjendet në Listen e substancave të klasifikuara ose nuk është në atë Liste të klasifikuar për të gjitha klasat e rrezikut dhe dallimeve në kuader të atyre klasave të rrezikut, klasifikimi i asaj substance do të kryhet në baze të të dhenave ekzistuese të asaj substance, perkatesisht të rezultateve nga hulumtimet e reja të cilesive të saj dhe krahasimin e atyre të dhenave, perkatesisht rezultateve me kriterë të vertetuara për klasifikimin e substancave.

#### Neni 14

Klasifikimi i perzierjes behet nepermjet metodes së vleresimit të rreziqeve të perzierjes në baze të të dhenave për cilesine e substancave të permbajtura në perzierje perkatesisht nepermjet hulumtimit eksperimental të drejtperdrejte të cilesive të asaj perzierje dhe krahasimin e të dhenave të marra perkatesisht rezultateve me kriteret e vertetuara për klasifikimin e substancave.

#### Neni 15

(1) Në procesin e klasifikimit të kimikaleve mund të shfrytezohehen të dhenat nga studimet epidemiologjike, të dhenat statistikore për semundje profesionale, perkatesisht të dhenat për ndikimin e kimikaleve në shendetin e njerezve në rast të ekspozimit të tyre gjate rasteve të fatkeqesive të shkaktuara nga kimikalet dhe të dhenat e marra nga metoda tjera të pranuar nderkombetarisht për caktimin e cilesive të kimikaleve.

(2) Provat për rrezikun kimik të cilat janë marre nga hulumtimet e realizuara te kafshet eksperimentale do të shfrytezohehen për qellimet e klasifikimit, pa marre parasysh mangesine e provave për ndikimin e rrezikut kimik në shendetin e njerezve në studimet dhe hulumtimet e theksuara në paragrafin (1) të ketij neni.

(3) Gjate klasifikimit të kimikalit, cilesite e saj tregohen në atë forme apo gjendje fizike në të cilat kimikali vihet në qarkullim, kurse në raste të posacme në atë forme apo gjendje fizike në të cilat kimikali perdoret.

#### Neni 16

(1) Analizat e reja të kimikaleve të cilat kryhen për shkak të klasifikimit të tyre, nese është e mundur nuk duhet të realizohen mbi kurrizoret.

(2) Të ndaluara janë analizat në primare për klasifikimin e kimikaleve.

#### Neni 17

(1) Analizat e reja të kimikaleve në proceduren e klasifikimit realizohen në pajtim me metodat e percaktuara.

(2) Metodat e analizës së kimikaleve i percakton drejtori i Agjencisë së Barnave.

(3) Analizat toksikologjike dhe eko-toksikologjike zbatohen në laboratore, puna e të cileve është e harmonizuar me parimin e Praktikes së Mire Laboratorike (PML).

(4) Parimet e Praktikes së Mire Laboratorike i percakton drejtori i Agjencisë për Barnat.

## Neni 18

(1) Paketimi i kimikaleve të rrezikshme dhe perzierjeve të caktuara të cilat nuk janë të rrezikshme, por permbajnë së paku një substancë të klasifikuar si e rrezikshme, duhet t'i përgjigjet çilesive, qëllimit dhe menyrës së shfrytëzimit të kimikaleve dhe duhet të jenë të shenuara.

(2) Menyren e shenimit dhe paketimit të kimikaleve të rrezikshme nga paragrafi (1) i këtij neni, e përcakton drejtori i Agjencisë për Barna.

(3) Njoftimi për kimikalet e rrezikshme për prodhimet të cilat vihen në qarkullim në tregun vendor duhet të jetë i përbajtur në etiketen e paketimit, i shkruar në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik.

(4) Kimikalet e rrezikshme duhet të shenohen në menyren në të cilën personat me nevoja të posaçme duhet ta identifikojnë rrezikun.

(5) Paketimi i kimikaleve të rrezikshme duhet të jetë i dizajnuar në menyre që femijet të mos mund ta hapin lehtë.

## Neni 19

Furnizuesi i kimikaleve të rrezikshme dhe perzierjeve e caktuara të cilat nuk janë të rrezikshme, por permbajnë më së paku një substancë të klasifikuar si të rrezikshme, në menyre të obligueshme duhet t'i theksojë çilesitë e rrezikshme të kimikalit gjatë reklamimit, dhe duhet ta reklamojë në menyre në të cilën shfrytëzuesit nuk duhet të hamenden për çilesitë e rrezikshme të kimikalit.

## Neni 20

(1) Furnizuesi obligohet që të mbaje evidence për kimikalet me të dhenat për: identitetin e kimikalit, shpërndarësin, shfrytëzuesin e metutjeshëm dhe sasine e kimikaleve të dërguara, si dhe për gjithëjasitë e shitura të kimikaleve të shfrytëzuesve gjatë një viti kalendarik.

(2) Furnizuesi obligohet që t'i grumbullojë dhe ruajë të gjitha të dhenat për kimikalet të cilat kanë të bëjnë me klasifikimin dhe shenimin, si dhe të dhenat tjera të cilat janë të nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

(3) Evidencën nga paragrafi (1) i këtij neni furnizuesi obligohet që ta ruajë së paku dhjetë vjet pas prodhimit të fundit të kimikaleve, leshimit në qarkullim apo shfrytëzimit të kimikaleve.

(4) Me kërkesë të Agjencisë për Barna, furnizuesi i dërgon të dhenat e nevojshme.

(5) Nëse furnizuesi i leshon punën e vet apo një pjesë të aktivitetëve subjektivit tjetër, obligimi për mbajtjen e evidencës për të dhenat nga paragrafi (1) i këtij neni bartet në atë subjekt, kurse në rast të pushimit të punës të dhenat për pushimin me punë t'i dërgojë në Agjencinë për Barna.

## III. NOTIFIKACIONI I SUBSTANCËVE TË REJA

## Neni 21

(1) Notifikacioni i substancës së re parashtrohet nga notifikuesi.

(2) Procedura për notifikacion mund të jetë e teresishme (e plote) dhe e shkurtuar.

## Neni 22

Notifikuesi obligohet që organit kompetent në vendin në të cilin substanca është prodhuar ose në vendin në të cilin notifikuesi ka seli t'i dorëzojë notifikacion me:

- dosje teknike me të gjitha të dhenat e arritshme relevante për evaluimin e rreziqeve të mundshme që mund të shkaktojnë kimikali në shëndetin e njerëzve dhe mjedisin jetësor dhe që së paku i përmban informatat dhe rezultatet e studimeve të kryera për konstatimin e rrezikut, së bashku me pershkrimin e plote dhe të hollësishëm të analizave të realizuara, metodat që janë zbatuar dhe të dhenat nga literatura në lidhje me analizat e bera dhe metodat e zbatuara,

- dosje teknike me informata të nevojshme për evaluimin e rreziqeve të parashikueshme pavarësisht nëse paraqiten menjëherë ose kanë veprim të prolonguar, që substanca mund të ketë për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin jetësor,

- deklarate në lidhje me ndikimet e padëshuruara të substancës gjatë menyrave të ndryshme të parashikueshme të përdorimit,

- propozim – klasifikimi dhe shenimi,

- propozim – liste të sigurisë,

- marreveshje për perfaqësim dhe

- kërkesë nga notifikuesi që notifikacioni të përjashtohet nga zbatimi i dispozitave të nenit 29 të këtij ligji, për periudhë maksimale prej një viti pas dorëzimit të notifikacionit, nëse atë vecanerisht e kërkon notifikuesi.

## Neni 23

(1) Notifikuesi i cili ka për qëllim të leshojë në qarkullim kimikale në territorin e Republikës së Maqedonisë në sasi më të vogla se 1 000 kilograme në nivel vjetor për prodhues, obligohet që të dorëzojë notifikacion në Agjencinë për Barna, që i përfshin:

- dosjet teknike me të gjitha të dhenat relevante të domosdoshme për evaluimin e rreziqeve të mundshme që kimikali mund të shkaktojë në shëndetin e njerëzve dhe mjedisin jetësor. Dosja përmban informata dhe rezultate minimale nga studimet e realizuara për konstatimin e rrezikut, si dhe pershkrim të teresishëm dhe të hollësishëm të studimeve që janë zbatuar, metodave që janë zbatuar ose të dhëna nga literatura nëse Agjencia për Barna nuk vendos më ndryshe dhe

- të gjitha informatat tjera nga neni 22 alinete 3 deri në 7 të këtij ligji.

(2) Të dhenat që duhet t'i përmbajë dosja teknike dallohen varesisht nga sasitë që leshohen në qarkullim.

(3) Në rast kur notifikuesi ka parashtruar dosje për procedurë të shkurtuar për notifikacion, para se sasitë e leshuara në qarkullim të arrijnë nivel prej 100 kilogramesh në nivel vjetor për prodhues ose para se sasia e përgjithshme e leshuar në qarkullim të arrijë nivelin prej 500 kg/në vit për prodhues, notifikuesi duhet të parashtrorë të dhëna plotësuese për shkak të kompletimit të dosjes teknike.

(4) Në rast kur notifikuesi ka parashtruar dosje për procedurë të shkurtuar për notifikacion, para se sasitë e leshuara në qarkullim të arrijnë 1 000 kilograme në nivel vjetor për prodhues ose para se sasia e përgjithshme e leshuar në qarkullim të arrijë nivel prej 5 tone/në vit për prodhues, notifikuesi duhet të parashtrorë kërkesë për procedurën e teresishme për notifikacion.

## Neni 24

Procedurat për notifikacion dhe analiza nga nenet 22 dhe 23 të këtij ligji, nuk kanë të bëjnë me:

- substancat e theksuara në Listen evropiane të substancave ekzistuese komerciale kimike (në tekstin e metutjeshëm: EINECS),

- aditivët dhe substancat që shfrytëzohen vecanerisht në ushqimin për kafshë,

- substancat që shfrytëzohen vecanerisht në ushqim dhe

- perberesit aktive që shfrytëzohen vecanerisht për barna, por jo edhe nenprodukte.

## Neni 25

(1) Substancat e notifikuara janë ato që i plotësojnë kushtet si në vijim:

- polimere, me përjashtim të atyre që në forme të kombinuar përmbajnë 2% ose më shumë se 2% të çdo substancë që nuk është cekur në listen e EINECS-it,

- substanca në qarkullim në sasi më të vogla se 10 kilograme në nivel vjetor për prodhues nëse prodhuesi i plotëson kriteret që janë përcaktuar me këtë ligj,

- substanca në sasi të kufizuar që nuk i tejkalojne 100 kilograme në nivel vjetor për prodhues dhe janë të dedikuara vecanerisht për hulumtime shkencore dhe zhvillim, në kushte të kontrolluara. Prodhuesit doemos duhet të ruajnë dokumente të shkruara me të dhena për identitetin e substancës, të dhena për shenimin, sasite dhe listen e shfrytëzuesve dhe të njejtat doemos duhet të jenë të arritshme për organin kompetent në vendin ku kryhet qarkullimi me to dhe

- substanca të dedikuara për hulumtim dhe zhvillim procesual të orientuar shkencor me numer të kufizuar të shfrytëzuesve të regjistruar në sasi të kufizuara për qellimet e hulumtimit dhe zhvillimit. Për keto substanca përjashtimi vlen një vit, me ç'rast importuesi ose prodhuesi duhet t'ia dorëzojë organin kompetent të dhenat për identitetin, shenimin, sasite, listen e shfrytëzuesve dhe programin e hulumtimit dhe zhvillimit, me ç'rast duhet të sigurohet që substanca të mos jetë e arritshme për publikun. Periudha njevojecare mund të vazhdohet nese notifikuesi dorëzon të dhena se kjo është e arsyeshme.

(2) Në rast kur nuk është e mundshme që substancat të shenohen në pajtim me nenin 18 të këtij ligji, në etiketen që rezultojnë nga hulumtimet e realizuara doemos duhet të qendrojnë paralajmërimi "KUJDES – substanca nuk është plotësisht e testuar".

#### Neni 26

(1) Kimikalet për të cilat kryhet procedura e teresishme për notifikacion mund të leshohen në qarkullim pas parashtrimit të dokumentacionit të nevojshëm për Agjencinë për Barna nga ana e notifikuesit. Agjencia për Barna, në afat prej 60 ditësh nga dita e parashtrimit të dokumentacionit të nevojshëm, obligohet që ta shqyrtojë dokumentacionin dhe të leshojë leje për leshimin në qarkullim të kimikalit, si dhe ta njoftojë notifikuesin për numrin e ndare.

(2) Nese dokumentacioni i parashtruar nuk është i kompletuar, Agjencia për Barna mundet në forme të shkruara nga notifikuesi të kerkojë plotësimin e tij.

(3) Kimikalet për të cilat kryhet procedura e shkurtuar për notifikacion, mund të leshohen në qarkullim pas parashtrimit të dokumentacionit të nevojshëm për Agjencinë për Barna nga ana e notifikuesit. Agjencia për Barna, obligohet që në afat prej 30 ditësh ta kontrollojë dokumentacionin dhe të leshojë leje për leshimin në qarkullim të kimikalit, si dhe ta njoftojë notifikuesin për numrin e ndare.

(4) Nese dokumentacioni i parashtruar nuk është i mjaftueshëm, organi kompetent në forme të shkruara nga notifikuesi mund të kerkojë plotësimin e tij.

(5) Afati nga paragrafi (1) i këtij neni pushon të rrjedhë nga dita kur Agjencia për Barna do të kerkojë nga parashtruesi të sigurojë dokumente plotësuese, informata ose sqarime për të cilat konsideron se janë të domosdoshme dhe afati vazhdon të rrjedhë nga dita e plotësimit të kërkesës së Agjencisë për Barna.

(6) Kunder aktvendimit për leshim në qarkullim të kimikalit mund të parashtrohet ankese te Komisioni kompetent i shkallës së dytë i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 27

(1) Në rast kur substancat klasifikohen si shumë helmuese, kancerogjene, si toksike për sistemin riproduktiv ose mutagjene, notifikuesi obligohet që t'ia dorëzojë Agjencisë për Barna të dhenat adekuate që kanë të bëjnë me metodat dhe masat e rekomanduara për kujdes gjatë përdorimit, magazinimit, transportit, zjarrit dhe llojeve tjera të rrezikut, vecanerisht reaksioneve kimike me ujë, nese kjo është relevante, informatat që kanë të bëjnë me dyshimin se substanca mund të eksplodojë kur është në forme të pluhurit, si dhe masat për ndihme urgjente gjatë derdhjes ose gjatë lëndimit të personave.

(2) Nese janë të arritshme, detyrimisht dorëzohen të dhenat për helmueshmërinë akute

#### Neni 28

(1) Agjencia për Barna leshon vendim për leshimin në qarkullim të substancave të reja dhe perzierjeve në baze të vlerësimit të realizuar të fletëparaqitjes dhe dokumentacionit të dorëzuar për leshimin në qarkullim të substancës së re, vet ose në perberje të perzierjes.

(2) Plotfuqishmeria e aktvendimit për leshimin e substancës së re në qarkullim është deri në dhjetë vjet.

(3) Notifikuesi është i obliguar që të parashtrtojë kërkesë për ripërtëritje të aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni, 120 dite para skadimit të vlefshmërisë.

#### Neni 29

(1) Në rast të substancës e cila tanime ka qene e notifikuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji, Agjencia për Barna mund të pajtohet që notifikuesi i ardhshëm të thirret në rezultatet për analizat fiziko – kimike, toksikologjike dhe ekotoksikologjike të parashtruar nga notifikuesi i pare, nese mund të sigurojë prova se substanca për të cilën kryen notifikacion të serishëm është e njejtë si ajo paraprakisht e notifikuar, duke përfshirë edhe shkallen e pastërtisë dhe natyrën e papastërtisë.

(2) Për shfrytëzimin e rezultateve nga analizat e cekura për substancat e notifikuar, notifikuesi i ardhshëm duhet të sigurojë pelqim me shkrim nga notifikuesi i pare.

(3) Në rast të notifikacionit të substancës së re që nuk është përfshirë në Listen evropiane të substancave të reja të publikuara (në tekstin e metutjeshëm: ELINCS), e është paraqitur, lejuar dhe përfshirë në Listen nacionale të substancave të reja dhe të klasifikuara të Agjencisë për Barna, notifikuesi i ardhshëm i substancës së re mund të kerkojë që të merren parasysh të dhenat për substancën dhe provat për analizat e realizuara të dorëzuara nga paraqitësi paraprak, nese ai me shkrim pajtohet me kete.

(4) Notifikuesi i ardhshëm është i obliguar që të deshmtojë se behet fjale për substancën e njejtë që është identike me atë të paraqitësit, duke përfshirë edhe shkallen e pastërtisë dhe papastërtisë së saj.

(5) Notifikuesi i substancës së re është i obliguar që të kerkojë nga Agjencia e Barnave të dhene nese substanca ka qene e paraqitur dhe kush është notifikuesi i saj i pare, me emrin dhe adresën e paraqitësit të pare.

(6) Në shtojcë të kërkesës notifikuesi është i obliguar që të dorëzojë prove se ka për qellim që substancën ta leshojë në qarkullim dhe të cekë në çfare sasishe.

(7) Notifikuesit e substancës së njejtë janë të obliguar që të bëjnë gjithçka që është në mundësinë e tyre, që të arrihet marreveshje për shfrytëzimin e përbashkët të të dhënave nga analizat.

#### Neni 30

(1) Agjencia për Barna do ta njoftojë notifikuesin nese dokumentacioni për paraqitje është i kompletuar dhe cila procedure për notifikacion do të zbatohet, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të fletëparaqitjes.

(2) Gjatë vlerësimit të substancave të reja, që nuk kanë qene lende e paraqitjes, zbatohet procedure e kompletuar për notifikacion, në afat prej 60 ditësh përlogaritur nga dita e pranimit të dokumentacionit të kompletuar.

(3) Për ato substanca që kanë qene lende e paraqitjes nga denoncues tjetër, zbatohet procedure e shkurtuar për notifikacion, në afat prej 30 ditësh. Agjencia për Barna do ta informojë, në forme të shkruara, denoncuesin e ardhshëm për pelqimin e leshuar paraprakisht të fletëparaqitjes për kimikalin e ri me citimin e numrit me të cilin është regjistruar kimikali në listen e EINECS-it.

(4) Nese ekziston ndonjë dyshim i bazuar mbi njohuritë më të reja shkencore se substanca është më e rrezikshme sesa që është evidentuar me dokumentacionin e paraqitjes, Agjencia për Barna mund të kerkojë dorëzim të dokumentacionit për analiza plotësuese mbi substancën që është e notifikuar.

(5) Në rastin nga paragrafi (4) i ketij neni Agjencia për Barna mund të miratoje aktvendim për ndalim të perkohshem për leshimin në qarkullim të substances derisa nuk do-rezohet dokumentacioni i kerkuar.

(6) Kunder aktvendimit të Agjencise për Barna për ndalimin e perkohshem për leshimin në qarkullim të kimikalit, mund të parashtrohet ankese në Komisionin kompetent të shkallës së dyte të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(7) Ankesa nuk e prolongon zbatimin e vendimit.

#### Neni 31

Kimikalet, në forme të substancave ose në perberje të perzierjeve, që paraqesin substanca eksplozive, hedhurine dhe papasterti në kimikale, nese kane disa nga cilesite e kimikaleve të rrezikshme pas klasifikimit të realizuar nga Agjencia për Barna, leshohen në qarkullim në procedure të zbatuar nga organi adekuat kompetent i administratës shtetërore në pajtim me kete ligj.

#### Neni 32

Substanca, në vete ose si perberje e perzierjes, nuk guxon të leshohet në qarkullim pa të dhena të mjaftueshme dhe nese nuk eshte e para-regjistruar ose e regjistruar nga ana e Agjencise Evropiane për Kimikale (ESNA).

#### Neni 33

(1) Notifikuesi rregullisht, së paku një here në vit, me shkrim duhet ta njoftoje Agjencine për Barna për:

- ndryshimet e sasise vjetore ose të pergjithshme të kimikaleve të leshuara në qarkullim,
- njohurite e reja për efektet e kimikaleve në shendetin e njerezve dhe mjedisit jetesor,
- çdo perdorim të ri për të cilin leshohet në qarkullim,
- çdo ndryshim në perberje dhe
- çdo ndryshim në statusin e notifikuesit.

(2) Notifikuesi eshte i obliguar që të dhena për emrin dhe sasite e kimikaleve të leshuara në qarkullim gjate vitit paraprak t'i dorezoje te Agjencia për Barna deri në fund të tremujorit të pare (31 mars) të vitit rrjedhes.

#### Neni 34

(1) Nese sasia e substances së paraqitur që notifikuesi e ka leshuar në qarkullim, gjate një viti ose në pergjithesi nga fillimi i leshimit në qarkullim, i tejkalon sasite kufizuese, notifikuesi eshte i obliguar që t'ia dorezoje Agjencise për Barna rezultatet e analizave plotesuese.

(2) Agjencia për Barna mund t'i pranoje edhe rezultatet e analizave te kurrizoret për substancën e njeje që i ka bere notifikuesi tjetër, nese ai për kete pajtohet me shkrim.

(3) Nese notifikuesi nuk i dorezon rezultatet nga analizat plotesuese nga paragrafi (1) i ketij neni, Agjencia për Barna perkohesisht mund ta ndaloje leshimin në qarkullim të substances.

(4) Sasite kufizuese të substancave të reja për të cilat kerkohen analiza plotesuese, llojin dhe perfshirjen e analizës, si dhe metodat për analize në baze të të cilave të dhena e marra për qellimin e njeje nga notifikuesi tjetër mund të shfrytezohen, i percakton drejtori i Agjencise për Barna.

#### Neni 35

Agjencia për Barna shkemben të dhena në nivel nderkombetar për:

- substance të re të publikuar në listen e ELINCS-së,
- të dhena për substancat ekzistuese me qellim të perpunitimit të vleresimit të rrezikshmerise dhe për klasifikimin e vecante të substancave ekzistuese nga lista e EINECS-it,
- të dhena për produktet biocidë me qellim të perpilimit të listave zgjedhore dhe
- të dhena tjera që rezultojne nga ky ligj, mes të tjerash, në pajtim me marrevshjet e ratifikuara nderkombetare.

#### Neni 36

(1) Nese notifikuesi dhe propozuesi deshmojne se zbulimi i të dhenave personale që paraqesin sekret afarist mund të shkaktojne humbje komerciale, mund t'i shenojne të dhena e tilla me shkallen e sekretit, nderkaq Agjencia për Barna duhet t'i trajtoje të njejtat si të tilla, pervec në rastet që paraqesin kerccenim për mbrojtjen e shendetit të njerezve dhe mjedisit jetesor.

(2) Të dhena që jane të rendesishme për mbrojtjen e shendetit dhe mjedisit jetesor dhe që nuk konsiderohen për sekret jane:

- emri tregtar i kimikalit dhe produktit biocid,
- emri dhe adresa e prodhuesit të kimikalit, produktit biocid, perkatesisht substances aktive për produkt biocid,
- emri dhe adresa e notifikuesit, perkatesisht propozuesit,
- emri dhe permbajtja e substances aktive në produktin biocid dhe emri i produktit biocid,
- cilesite fizike dhe kimike të kimikalit, produktit biocid, perkatesisht substances aktive për produktin biocid,
- pershkrimi i metodave dhe masat për mbrojtjen nga efektet e demshme të substances ose për shnderrim të substances në të parrezikshme,
- rezultatet e permbledhura nga analizat dhe testimet e produktit biocid të zbatuara në pajtim me nenin 100 të ketij ligji,
- rezultatet e permbledhura të analizave toksikologjike dhe ekotoksikologjike,
- shkalla e pastertise së substances dhe identifikimi i substancave shtese të rrezikshme dhe perzierjeve, nese keto jane të rrezikshme dhe nese kjo eshte e domosdoshme për klasifikimin dhe shenimin e substances,
- rekomandime për masat parandaluese për kohen e manipulimit, magazinimit, transportit, perdorimit dhe masat urgjente në rast të zjarrit dhe rreziqeve tjera,
- të dhena nga udhezimi për masat e sigurise,
- metodat për menjanimin e hedhurines dhe ambalazhit të saj,
- procedurat që duhet të ndjekin masa urgjente të cilat duhet të ndermerren në rast të rrjedhjes ose derdhjes,
- metoda analitike për vleresimin e ekspozimit të shendetit të njerezve dhe ambientit jetesor dhe
- masat e ndihmes së pare dhe keshillat mjekesore në rast të lendimit të personave.

(3) Nese prodhuesi, parashtruesi i kerkeses ose importuesi i prodhimit biocid ose i substances aktive të dedikuar për prodhim biocid, vendos që të dhena të caktuara paraprakisht të konsideruara si të fshehta të behen të arritshme, për kete eshte i obliguar që ta njoftoje Agjencine për Barna.

## IV. LISTA E SIGURISE

#### Neni 37

(1) Furnizuesi gjate vendosjes në qarkullim të kimikaleve të rrezikshme, kimikaleve të cilat permbajne substanca të identifikuar si perzistente - bioakumulative - toksike (në tekstin e metejme: PBT) ose shume perzistente - shume bioakumulative (në tekstin e metejme: vPvB) dhe kimikale tjera të cilat kane cilesi nga Lista e substancave të cilat shkaktojne brengosje, eshte i obliguar që falas, t'u dorezoje lista të sigurise, në forme të shkruar ose elektronike, në gjuhen maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik të gjithë distributorëve ose shfrytezuesve të metejme në zinxhirin e furnizimit.

(2) Eksportuesi eshte i obliguar që t'i dorezoje lista të sigurise importuesit, ndersa nese eshte e mundur, listat e sigurise duhet të jene të shenuara në gjuhen e vendit importues.

## Neni 38

Me perjashtim të nenit 37 të këtij ligji, Lista e sigurise nuk sigurohet për substanca të rrezikshme ose perzierje të dedikuara për perdorim publik, për të cilat ka informata të mjaftueshme që t'u mundesoje shfrytëzuesve t'i ndermarrin masat e domosdoshme për mbrojtjen e shendetit të njerezve dhe ambientit jetesor.

## Neni 39

(1) Lista e sigurise duhet ta permbaje daten e leshimit dhe keto të dhëna për kimikalin:

- identifikimin e substances/perzierjes dhe të personit juridik i cili e leshon substancenc/perzierjen në qarkullim,
- identifikimin e rreziqeve,
- perpilim/informatat për perberjet,
- masat për ndihmen e pare,
- masat kunder zjarrit,
- masat gjate lirimit të rastesishem të substances/perzierjes,
- perdorimin dhe magazinimin,
- kontrollin e ekspozimit të substances / mbrojtja personale,
- cilesite fizike dhe kimike,
- stabilitetin dhe reaktivitetin,
- informatat toksikologjike,
- informatat ekotoksikologjike të kimikaleve,
- menyren e shkaterrimit/ menjanimit,
- informatat për transportimin,
- informatat rregullatore dhe
- të dhenat tjera për kimikalin.

(2) Udhezimet për perpilimin e Listes siguruese i cakton drejtori i Agjencise për Barna.

## Neni 40

(1) Të gjithë pjesemarrësit në zinxhirin e furnizimeve që janë të obliguar të perpilojnë raport për siguri kimike në shtojcën e listes së sigurise i futin skenaret adekuate për ekspozim me ç'rast i perfshtjine të gjitha menytrat e njohura për perdorim.

(2) Të gjithë shfrytëzuesit e metejme gjate hartimit të Listes së sigurise personale për menytrat e njohura të perdorimit do t'i perfshtjine skenaret adekuate të ekspozimit, si dhe informatat tjera adekuate nga Lista siguruese.

(3) Të gjithë distributorët dorezojne skenare adekuate për ekspozim dhe shfrytëzojne informata tjera adekuate nga lista së sigurise, që u janë siguruar, gjate hartimit të listes së sigurise personale, për perdorime për të cilat kanë dorezuar informata.

## Neni 41

(1) Nese eshte bere vleresim për perdorimin e sigurte të kimikalit dhe skenarit të ekspozimit, informatat e theksuara në listen së sigurise duhet t'u pergjigjen informatave nga raporti për perdorimin e sigurte të kimikaleve, ndersa skenari për ekspozim duhet të jete i theksuar në aneksin e listes së sigurise.

(2) Personat juridike të cilet leshojne në qarkullim kimikale obligohen që t'i ndjekin ndryshimet dhe njohurite e reja për kimikalet dhe ta informojne shfrytëzuesin e metejme dhe Agjencine për Barna.

## Neni 42

Furnizuesi obligohet që kerkeses së secilit pranues ose shfrytëzuesit të metejme t'i dorezoje liste të sigurise për furnizimin e perzierjes që nuk eshte klasifikuar si e rrezikshme, ndersa permban:

- në perqendrim individual të 1% të mases për perzierje jo të gazta dhe 0,2% të volumit për perzierje të gazta me së paku një substance e cila eshte helmuese për shendetin e njerezve ose paraqet rrezik për mjedisin jetesor, ose
- në perqendrim individual nga 0,1% të mases për perzierjet jo të gazta më së paku një substance e cila eshte PBT ose vPvB ose eshte e perfshtire në Listen e substancave me rrezik të larte, ose

- substanca për të cilen ekzistojne rregulla për kufizim të ekspozimit në vendin e punes ose perqendrimet maksimale të lejuara në lokalet punuese, në pajtim me dispozitat për siguri dhe shendet gjate punes.

## Neni 43

(1) Furnizuesi do ta ndryshoje ose plotesoje permbajtjen e listave të sigurise në pajtim me informatat e reja për kimikalet, vecanerisht ato që kanë të bejne me zvogelimin e rreziqeve dhe kontrollit, ose informatave të reja për rrezikun e kimikalit, si dhe ndalimet dhe kufizimet në lidhje me prodhimin, leshimin në qarkullim ose shfrytëzimin e kimikaleve.

(2) Furnizuesi do t'ua dorezoje listen e ndryshuar dhe të plotësuar të gjithë distributorëve dhe shfrytëzuesve tjere të perfshtire në prodhim, të cileve ua kanë dorezuar kimikalin në 12 muajt e kaluar.

(3) Lista e ndryshuar dhe plotësuar duhet të permbaje verezjte "E reviduar", si dhe daten e ndryshimeve të kryera ose plotësimeve që janë bere.

## Neni 44

(1) Në listen e sigurise gjate shenimit të paketimit të substances së rrezikut të permbajtur në perzierje mund të perdolet emer alternativ kimik për atë substance, me ç'rast do të shfrytëzohet emer me të cilin identifikohen grupet më të rëndesishme funksionale ose do të shfrytëzohet emer tjetër alternativ.

(2) Prodhuesi, importuesi ose shfrytëzuesi i metejme i substances së rrezikshme në perzierje, parashtron kerkesë për perdorimin e emrit alternativ kimik, në Agjencine e Barnave.

(3) Emri alternativ kimik mund të perdolet nese shfrytëzimi i emrit kimik të substances mund të sjelle te cenimi i sekretit afarist ose të drejtave të pronesise intelektuale dhe nese emri alternativ kimik jep informata të mjaftueshme për marrjen e masave që kanë të bejne me sigurine dhe shendetin gjate punes dhe kontrollin e rrezikut gjate perdorimit të perzierjes.

(4) Emri alternativ kimik mund të perdolet për substancën që ka cilesi të caktuara.

(5) Për vleresimin e arsyeshmerise së kerkeses për perdorimin e emrit alternativ kimik paguhet kompensim.

(6) Cilesite e substances për të cilen mund të perdolet emri alternativ kimik, si dhe permbajtjen e kerkeses për perdorimin e emrit alternativ kimik, i percakton drejtori i Agjencise për Barna.

## Neni 45

(1) Agjencia për Barna në afat prej 45 ditesh nga dita e parashtrimit të kerkeses nga neni 44 paragrafi (2) të këtij ligji do të kerkoje nga parashtruesi i kerkeses që të dorezoje të dhëna plotësuese të domosdoshme për miratimin e vendimit për shfrytëzim të emrit alternativ kimik.

(2) Agjencia për Barna jep pelqim për shfrytëzimin e emrit alternativ kimik nese janë plotësuar kushtet nga neni 44 paragrafet (3) dhe (4) të këtij ligji.

(3) Agjencia për Barna miraton aktvendim për shfuqizimin e pelqimit për shfrytëzimin e emrit alternativ kimik nese në baze të informatave të reja konkludon, se emri alternativ kimik nuk jep informata të mjaftueshme për ndermarrjen e masave të cilat kanë të bejne me sigurine e shendetit gjate punes dhe kontrollimin e rrezikut gjate perdorimit të perzierjes.

(4) Me perjashtim nga paragrafi (3) të këtij neni, Agjencia për Barna aprovon emer tjetër alternativ kimik për substancën.

(5) Kunder aktvendimit nga paragrafet (2), (3) dhe (4) të këtij neni, mund të parashtrohet ankese te Komisioni kompetent i shkalles së dyte i Qeverise së Republikës së Maqedonise.

## Neni 46

(1) Raporti për siguri të kimikaleve është dokument për evaluimin e sigurisë së kimikaleve, duke i përfshirë edhe masat për zvogëlimin dhe kontrollin e rrezikut të substancës.

(2) Secili person juridik i cili prodhon ose importon më shumë se 10 000 kilogramë në vit nga substanca, vecas ose si komponente në perzierje ose prodhim, duhet të kryejë vlerësim për siguri kimike.

(3) Menyren në të cilën kryhet vlerësimi i sigurisë së kimikaleve dhe përmbajtjen e raportit të sigurisë së kimikaleve, i percakton drejtori i Agjencisë për Barna dhe publikohen në ueb faqen e Agjencisë për Barna.

## Neni 47

(1) Vlerësimi për siguri kimike të substancave i përfshin:

- vlerësimin për rrezik të shëndetit të njerëzve,
- vlerësimin për rrezik fiziko-kimik,
- vlerësimin për rrezik të mjedisit jetësor dhe
- vlerësimin PBT dhe vPvB.

(2) Nëse pas zbatimit të vlerësimit nga paragrafi (1) të këtij neni konstatohet se substanca i plotëson kriteret për klasifikim si e rrezikshme ose perseri është vlerësuar si PBT ose vPvB, në pajtim me këto ligj vlerësimi për siguri kimike vazhdon me:

- vlerësimin e ekspozimit, duke përfshirë edhe berjen e skenarit/skenareve për ekspozim (ose identifikim të përdorimit relevant dhe kategorive të ekspozimit, nëse është relevante) dhe vlerësimin e ekspozimit dhe

- karakterizimin e rrezikut.

(3) Skenaret e ekspozimit (atje ku konsiderohen si relevante përdorimi dhe kategoritë e ekspozimit), vlerësimi i ekspozimit dhe karakterizimi i rrezikut do t'i përfshijnë të gjitha përdorimet e identifikuara të propozuara nga furnizuesi/parashtruesi.

(4) Çdo person juridik i cili prodhon ose importon substanca kryen evaluim të ekspozimit dhe karakterizim të rrezikut për të gjitha menytrat e identifikuara të përdorimit të kimikaleve.

## Neni 48

Raporti i sigurisë kimike nuk duhet ta përfshijë shqyrtimin e rreziqeve për shëndetin e njerëzve në lidhje me këto përdorime të fundit:

- si materiale dhe prodhime të cilat vijnë në kontakt me ushqimin dhe
- në prodhime kozmetike.

## Neni 49

Furnizuesi i kimikaleve në baze të rreziqeve të identifikuara gjatë vlerësimit të sigurisë kimike, do të identifikojë dhe zbatojë masa adekuate për kontrollimin e tyre, e nëse janë adekuate do t'i rekomandojë në Listen e sigurisë.

## Neni 50

Informatat e reja për cilësitë e rrezikshme të substancës ose perzierjes, si dhe informatat tjera të ndërlidhura me listat e sigurisë, të cilat kanë të bëjnë me menyra të caktuara të shfrytëzimit të substancës ose perzierjes, në menyre reciproke duhet t'i shkëmbejnë të gjithë pjesëmarrësit në zinxhirin e furnizimit.

## Neni 51

(1) Furnizuesi i prodhimit që përmban substanca të cilat gjenden në Listen e substancave me rrezik të lartë në përqendrime të cilat i tejkalojnë 0,1%, shfrytëzuesit të prodhimit do t'i dorëzojë informata të mjaftueshme, të arritshme për furnizuesin, për të mundësuar përdorim të sigurt të prodhimit, duke e përfshirë së paku emrin e substancës.

(2) Furnizuesi i prodhimeve të cilat përmbajnë substanca që gjenden në Listen e substancave me rrezik të lartë në përqendrime të cilat i tejkalojnë 0,1%, kërkeses së shfrytëzuesit të prodhimit do t'i dorëzojë edhe informata tjera për t'u mundësuar përdorim i sigurt i prodhimit, nëse ato i janë të arritshme.

(3) Informatat nga paragrafet (1) dhe (2) të këtij neni, furnizuesi i prodhimit i jep falas në afat prej 45 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

## V. KUFIZIMI DHE NDALIMI I LESHIMIT NË QARKULLIM DHE PËRDORIMIT TË KIMIKALEVE

## Neni 52

(1) Lista e ndalimeve dhe kufizimeve për përdorimin e kimikaleve dhe prodhimeve prodhimi, leshimi në qarkullim dhe përdorimi i të cilave ndalohet perkatesisht kufizohet për shkak të rrezikut për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin jetësor, nuk zbatohet për substanca të dedikuara për qëllime shkencore-hulumtuese dhe zhvillim.

(2) Kufizimet nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk kanë të bëjnë me përdorimin e substancave në prodhime kozmetike.

(3) Lista nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i përmbajë edhe kufizimet për përdorimin e kimikaleve dhe perzierjeve, menytrat e lejuara të shfrytëzimit si dhe kushtet e tjera për prodhimin, leshimin në qarkullim dhe përdorimin e tyre.

(4) Në situata ku ndalimet dhe kufizimet për substanca dhe perzierje të caktuara nuk mund të zbatohen për shkak të pasojave teknike dhe ekonomike, Agjencia për Barna do të percaktojë afate se kur ato ndalime dhe kufizime do të behen të detyrueshme.

(5) Prodhuesit, importuesit, distribuesit ose shfrytëzuesit e metejme të substancës ose perzierjes, do të veprojnë në pajtim me ndalimet dhe kufizimet dhe kushtet tjera të percaktuara me këto ligj.

## VI. REGJISTRI I KIMIKALEVE

## Neni 53

(1) Për qëllimet e kembimit të të dhënave dhe menaxhimit integral të kimikaleve, Agjencia për Barna udhëheq Regjisterin integral të kimikaleve të cilat janë vënë në qarkullim dhe përbehet nga Regjistri për kimikale dhe Regjistri i prodhimeve biocide, si dhe të dhënat për preparate për mbrojtjen e bimeve.

(2) Të dhënat për preparatet për mbrojtjen e bimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, janë të dhëna për:

- emrin mbrojtës,
- emrin dhe cilësinë e substancës aktive,
- menyren e lejuar të përdorimit,
- personin juridik i cili preparatet i leshon në qarkullim dhe

- sasitë e preparateve të cilat janë leshuar në qarkullim.

(3) Organi kompetent për leshimin në qarkullim të preparateve për mbrojtjen e bimeve obligohet që një herë në vit më së voni deri më 31 mars në vitin rrjedhës, t'i dorëzojë Agjencisë për Barna të dhëna për preparatet për mbrojtjen e bimeve të vëna në qarkullim në vitin paraprak.

(4) Agjencia për Barna, Regjistrin integral nga paragrafi (1) i këtij neni e udhëheq si baze elektronike të të dhënave.

(5) Formën, përmbajtjen dhe menyren e udhëheqjes së Regjistrin integral nga paragrafi (1) i këtij neni i percakton drejtori i Agjencisë për Barna.

## Neni 54

(1) Në Regjistrin për kimikale futen kimikalet të cilat prodhohen ose importohen në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni në Regjistrin për kimikale nuk futen kimikalet të cilat kanë cilësi të caktuara ose përdoren për qëllime të caktuara në pajtim me këto ligj.

## Neni 55

(1) Prodhuesi, importuesi ose shfrytezuesi i metejme është i detyruar që të Agjencia për Barna të dorezoje fletëparaqitje për regjistrim të kimikalit në Regjistrin për kimikale, më së voni deri më 31 mars të vitit rjedhes për kimikalet të cilat janë prodhuar ose importuar në vitin paraprak.

(2) Prodhuesi ose shfrytezuesi i metejme nga jashtë është i detyruar që të dorezoje deklarate të Agjencia për Barna për regjistrimin e kimikaleve në Regjistrin për kimikale, nepërmjet perfaqësuesit të autorizuar në Republikën e Maqedonisë.

(3) Fletëparaqitja nga paragrafi (1) i ketij neni i përmban: emrin dhe adresën, numrin tatimor të identifikimit, llojin e veprimtarisë, emrin e personit përgjegjës në personin juridik.

(4) Me fletëparaqitjen nga paragrafi (1) i ketij neni dorezohet dosja për çdo kimikal, si dhe liste të sigurisë, nëse është e percaktuar për kimikalin.

(5) Nëse kimikalin e regjistron perfaqësues ose perfaqësia e prodhuesit ose shfrytezuesit të metejme nga jashtë, me deklaratën nga paragrafi (2) i ketij neni parashtron dëshmi për këtë.

(6) Dosja për kimikalin i përmban:

1) emrin tregtar/të mbrojtur të kimikalit dhe identifikimin tjetër të kimikalit;

2) të dhenat për sasine e kimikalit e cila leshohet në qarkullim;

3) të dhenat për çdo mënyrë të shfrytëzimit të kimikalit për të cilin di personi i cili e regjistron kimikalin dhe

4) të dhenat për përberjen kimike.

## Neni 56

(1) Agjencia për Barna në afat prej gjashtë muajsh nga dita e pranimit të fletëparaqitjes i kontrollon të dhenat nga dosja e kimikalit.

(2) Agjencia për Barna miraton aktvendim për regjistrim të kimikalit në Regjistrin e kimikaleve, nëse dosja për kimikale është e mbushur dhe nëse është dorezuar liste e sigurisë, në pajtim me këtë ligj.

(3) Agjencia për Barna në aktvendimin për regjistrimin e kimikalit në Regjistrin për kimikale e regjistron numrin regjistruar të çdo kimikali nga paragrafi (2) i ketij neni.

## Neni 57

(1) Personi i cili e ka kryer regjistrimin e kimikalit në Regjistrin për kimikale është i detyruar që çdo vit të ardhshëm në afatin e theksuar në nenin 55 paragrafi (1) të ketij ligji të dorezoje të dhena për sasite të cilat janë leshuar në qarkullim dhe ndryshimet tjera në të dhenat në dosjen e dorezuar për kimikalin.

(2) Të dhenat të cilat mbahen për çdo kimikal në Regjistrin për kimikale i percakton Drejtori i Agjencisë për Barna.

## VII. PRODHIMI I KIMIKALEVE

## Neni 58

Personat juridike që prodhojnë kimikale janë të detyruar që të sigurojnë kushte me të cilat do të zvogelohet ose pengohet rreziku për shëndetin e njerezve dhe mjedisin jetësor dhe të sigurojnë zëvendësim të kimikaleve të rrezikshme me kimikale më pak të rrezikshme.

## Neni 59

(1) Personat juridik që prodhojnë kimikale duhet t'i plotësojnë kushtet e percaktuara me këtë ligj dhe kushtet më të përafërta të percaktuara me rregullat e miratuara në baze të tij.

(2) Lejen nga paragrafi (1) i ketij neni e leshon ministri i Shëndetësisë pas pelqimit paraprak të ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, ministrit të Punës dhe Politikës sociale, ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe ministrit të Ekonomisë.

(3) Agjencia për Barna mban evidence të personave juridike të cilëve u është leshuar leje për prodhimin e kimikaleve.

## Neni 60

(1) Personat juridike që prodhojnë kimikale duhet të kenë lokal perkates, pajisje dhe kuader.

(2) Kushtet më të përafërta lidhur me lokalin, pajisjen dhe kuadrin nga paragrafi (1) i ketij neni i percakton drejtori i Agjencisë për Barna.

## Neni 61

(1) Personi juridik që prodhon kimikale është i detyruar që t'i njoftojë të gjithë të punësuarit me rrezikun për shëndetin e njerezve dhe mjedisin jetësor nga kimikalet dhe me mënyrën e mbrojtjes.

(2) Punetoret që menaxhojnë dhe punojnë me kimikale doemos duhet të jenë të aftë profesionalisht për siguri gjatë punës me kimikale.

(3) Personat juridike nga paragrafi (1) i ketij neni janë të detyruar që të kujdesen për aftësimin e vazhdueshëm të punetoreve të cilët menaxhojnë dhe punojnë me kimikale.

(4) Aftësimin e punetoreve të cilët menaxhojnë dhe punojnë me kimikale e kryejnë personat juridike të cilët i plotësojnë kushtet lidhur me lokalin, pajisjen dhe kuadrin, në baze të autorizimit nga drejtori i Agjencisë për Barna.

(5) Përmbajtjen e programit për aftësim, mënyrën e aftësimit, njohuritë e punetorit varesisht nga lloji i punës që e kryen, si dhe lokalin, pajisjen dhe kuadrin që duhet t'i plotësojnë personat juridike që e kryejnë aftësimin, i percakton ministri i Shëndetësisë në pajtim me ministrin për Punë dhe Politikë Sociale, ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

## Neni 62

Personat juridike që prodhojnë kimikale janë të detyruar të mbajnë evidence në të cilën janë të përmbajtura të dhenat për emrin e kimikalit, sasite e prodhuara, afati i vlefshmerisë, data e prodhimit dhe dedikimi.

## Neni 63

Personat juridike që prodhojnë kimikale janë të detyruar të kujdesen për grumbullimin, ruajtjen e drejte dhe menjanimin e sigurt të hedhurinave në pajtim me rregullat për mbeturina.

## Neni 64

(1) Prodhuesi i kimikaleve është i detyruar që ta njoftojë Agjencinë për Barna për çdo ndryshim i cili mund të ndikojë në plotësimin e kushteve të percaktuara me këtë ligj.

(2) Nëse kushtet për prodhim nuk janë plotësuar, Agjencia për Barna ia heq lejen për punë dhe e shlyen personin juridik nga evidence e personave juridike që prodhojnë kimikale.

## VIII. QARKULLIMI ME KIMIKALE

## Neni 65

(1) Personat juridike që kryejnë qarkullim me kimikale duhet t'i plotësojnë kushtet e percaktuara me këtë ligj dhe kushtet më të përafërta të percaktuara me rregullat e miratuara në baze të tij.

(2) Leja për kryerjen e veprimtarisë qarkullim me kimikale, leshohet për periudhën kohore prej pesë vitesh.

(3) Agjencia për Barna mban evidence për personat juridike të cilëve u është leshuar leja për kryerjen e qarkullimit me kimikale.

## Neni 66

(1) Krahas kushteve të përgjithshme, personat juridike janë të obliguar që t'i permbushin së paku kushtet e posaçme në vijim për kryerjen e qarkullimit me kimikale:

1) të kene kuader me arsimim të larte nga sfera e kimise, teknologjise, farmacise, mjekesise, biologjise, perkatesisht bujqesise ose veterinarise, varesisht nga dedikimi i kimikaleve dhe të jene të aftesuar profesionalisht për menaxhim me kimikalet;

2) të kene lokale perkatese për vendosje, ruajtje dhe leshim të kimikaleve të rrezikshme, të cilat në aspekt të lokacionit, menyres së ndertimit, ventilimit, temperatures dhe lageshtise i permbushin kushtet teknike dhe sanitare-higjienike dhe kushtet tjera të percaktuara me ligj;

3) në vend të dukshem në lokal ku kryhet qarkullimi me kimikale të vendosin udhezim për masat dhe mjetet për pengimin e helmimit, menyren e dhenies së ndihmes së pare në rast të helmimit, menyren e menjanimit të kimikalit (neutralizimit, mjetet për shpellarje) i cili leshohet në qarkullim dhe

4) të kene në disponim mjete perkatese për dhenien e ndihmes së pare (kunderhelme-antidote, mjete për shpellarje e të tjera).

(2) Kushtet më të peraferta lidhur me lokalin dhe pajisjen i percakton ministri i Shendetesise në pajtim me ministrin e Mjedisit Jetesor dhe Planifikimit Hapesinor.

(3) Dispozita nga paragrafi (1) i ketij neni nuk zbatohet për institucione shkencore-hulumtuese, arsimore dhe shendetesore që kimikalet i shfrytezojne ekskluzivisht për kryerjen e veprimtarise themelore.

## Neni 67

(1) Personi juridik që kryen qarkullim me kimikale eshte i obliguar që të siguroje aftesim profesional të personave që punojne me kimikale dhe të kujdeset për aftesim të tyre të vazhdueshem.

(2) Permbajtjen e programit për aftesim, menyren e aftesimit, njohurite e punetorit varesisht prej llojit të punes e kryen, si dhe kushtet që duhet t'i permbushin personat juridike të cilet e realizojne aftesimin i percakton ministri i Shendetesise në pajtim me ministrin e Punes dhe Politikes Sociale, ministrin e Mjedisit Jetesor dhe Planifikimit Hapesinor dhe ministrin e Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave.

## Neni 68

(1) Personat juridike që kryejne qarkullim me kimikale janë të obliguar që të mbajne evidence në të cilen permbahen:

të dhena për kimikalin (emri i kimikalit, sasite e leshuara, afati i perdorimit, dedikimi) dhe

të dhena për shfrytezuesin (emri, mbiemri, numri unik i amzes, adresa, nenshkrimi i atij që e ka leshuar dhe pranuar kimikalin dhe data e leshimit).

(2) Të dhenat nga paragrafi (1) i ketij neni ruhen së paku pese vjet.

(3) Ndalohet shitja e kimikaleve personave më të rinj se 18 vjet.

## Neni 69

(1) Personi juridik që kryen qarkullim me kimikale mund t'i importoje/eksportoje kimikalet, në baze të lejes për import/eksport, të leshuar nga Agjencia për Barna.

(2) Agjencia për Barna mban evidence të lejeve të leshuara për import/eksport të kimikaleve nga paragrafi (1) i ketij neni.

## Neni 70

Personat juridike që kryejne qarkullim me kimikale janë të obliguar që të kujdesen për grumbullimin, ruajtjen e drejte dhe menjanimin e sigurt të hedhurinave në pajtim me rregullat për hedhurina të rrezikshme.

## IX. IMPORTI DHE EKSPORTI I KIMIKALEVE TË SAKTUARA TË RREZIKSHME

## Neni 71

(1) Me qëllim të avancimit të ndarjes së përgjegjesive dhe bashkepunimit në tregtine nderkombetare me kimikale të rrezikshme, në pajtim me Konventen e Roterdamit për proceduren për dhenien e pelqimit në baze të njoftimit paraprak për kimikale të caktuara të rrezikshme dhe pesticide në tregun nderkombetar (në tekstin e metejme: Konventa e Roterdamit) për import dhe eksport të substancave të caktuara për të cilat eshte percaktuar kufizimi edhe ndalimi i prodhimit, leshimit në qarkullim, dhe perdorimit, si dhe perzierjeve të caktuara dhe prodhimeve të cilat e permbajne atë substance, zbatohet procedura e njoftimit paraprak, perkatesisht procedura e dhenies së pelqimit në baze të njoftimit paraprak (në tekstin e metejme: procedura PIC).

(2) Kufizimet dhe ndalimet nga paragrafi (1) i ketij neni kane të bejne me kufizimet dhe ndalimet nga neni 52 i ketij ligji ose kufizimet dhe ndalimet percaktohen në baze të rregulles me të cilen kryhet leshimi në qarkullim i kimikalit në pajtim me ligjin me të cilen rregullohen mjetet për mbrojtjen e bimeve.

(3) Procedura për njoftim paraprak zbatohet për kimikale të cilat janë në Listen e kimikaleve me procedure të njoftimit paraprak, ndersa procedura PIC zbatohet për kimikale të Listes së kimikaleve për proceduren PIC.

(4) Lista e kimikaleve me procedure të njoftimit paraprak së paku duhet të permbaje emrin e kimikalit, numrat me të cilet identifkohet, numrin tarifor dhe nenkategorine e kimikalit.

(5) Lista e kimikaleve me procedure PIC së paku duhet të permbaje emrin e kimikalit, numrat me të cilet identifkohet, numrin tarifor dhe kategorine e kimikalit.

(6) Lista e kimikaleve me procedure të njoftimit paraprak permban dhe kimikale të caktuara nga Lista e kimikaleve me procedure PIC.

(7) Lista e kimikaleve me procedure PIC permban edhe kimikale nga Lista e kimikaleve nga Konventa e Roterdamit.

## Neni 72

(1) Kategorite e kimikaleve për të cilat zbatohet procedura PIC janë kimikalet industriale dhe pesticidet.

(2) Nenkategorite e kimikaleve industriale për të cilat zbatohet procedura e njoftimit paraprak janë:

1) nenkategoria e kimikaleve për perdorim të përgjithshem dhe

2) nenkategoria e kimikaleve për perdorim profesional.

(3) nenkategorite e pesticideve për të cilat zbatohet procedura e njoftimit paraprak janë:

1) nenkategoria e mjeteve për mbrojtjen e bimeve dhe

2) nenkategoria e pesticideve tjera në të cilat janë perfsihire prodhimet biocide dhe kimikale tjera të cilat kane veprim pesticid.

## Neni 73

(1) Procedura e njoftimit paraprak për eksport zbatohet ashtu që Agjencia për Barna dorezon te organi kompetent për menaxhim me kimikale në vendin ku kryhet eksporti, njoftim për eksport të kimikaleve nga Lista e kimikaleve me procedure të njoftimit paraprak, perkatesisht të kimikalit që permban substance nga kjo Liste në koncentrim të tille që sipas ketij ligji klasifikohet si e rrezikshme, si dhe njoftim për eksport të prodhimit i cili permban kimikal nga Lista e kimikaleve për procedure PIC.

(2) Eksportuesi i kimikaleve dhe prodhimeve nga paragrafi (1) i ketij neni eshte i obliguar që para eksportit të parashtroje kerkese në Agjencine për Barna për zbatimin e pro-

cedures së njoftimit paraprak dhe me kerkesen të dorezoje informate e cila permban së paku të dhena për identitetin e kimikalit, të dhena personale, të dhena për importuesin e kimikalit ose prodhimin dhe të dhena për cilesite e kimikalit dhe masat e kujdesit dhe zvogelimit të rrezikut dhe riskut.

(3) Në baze të informatave nga paragrafi (2) i ketij neni Agjencia për Barna perpilon njoftim për vendin në të cilin eksportohet dhe zbatohet procedura e njoftimit paraprak.

(4) Agjencia për Barna eksportuesit nga paragrafi (2) i ketij neni i jep vertetim për procedurën e zbatuar të njoftimit paraprak.

(5) Rastet në të cilat zbatohet procedura e njoftimit paraprak, rastet në të cilat nuk është i nevojshëm zbatimi i metejme i procedurës së njoftimit paraprak, permbajtjen e njoftimeve për eksport dhe dokumentet që dorezohen për zbatimin e asaj procedure i pershkruan drejtori i Agjencisë për Barna.

(6) Pjese perberese e aktit nga paragrafi (5) i ketij neni është edhe Lista e kimikaleve me procedure të njoftimit paraprak.

#### Neni 74

Procedura e njoftimit paraprak për import zbatohet për kimikalet prodhimi, leshimi në qarkullim dhe perdorimi i të cilave janë të ndaluara, perkatesisht të kufizuara sipas rregullave të vendit në të cilin importohet, keshtu që Agjencia për Barna pas marrjes së njoftimit për eksport nga organi kompetent i vendit nga i cili importohet e njofton atë organ se e ka pranuar njoftimin.

#### Neni 75

(1) Procedura PIC zbatohet për import, perkatesisht eksport të kimikalit i cili gjendet në Listen e kimikaleve me procedure PIC, perkatesisht për kimikale e cila permban substance nga kjo liste në koncentrim të tille që në pajtim me dispozitat e ketij ligji klasifikohet si e rrezikshme.

(2) Agjencia për Barna është e obliguar që Sekretariatit të Konventes së Roterdamit t'i dorezoje pergjigje në lidhje me importin për secilin kimikal nga Lista e Konventes së Roterdamit.

(3) Agjencia për Barna organit kompetent të vendit nga i cili importohet kimikali është e obliguar që t'i dorezoje pergjigje për import të kimikalit i cili nuk është në Listen e Konventes së Roterdamit, nese ai vend kerkon pelqim paraprak sipas procedures PIC.

(4) Pergjigjja nga paragrafet (2) dhe (3) të ketij neni mund të jete pelqim, pelqim në kushte të caktuara, perkatesisht mospajtim, ndersa perpilohet në baze të kufizimeve të percaktuara dhe ndalimeve nga neni 52 i ketij ligji ose në baze të rregulles me të cilin kryhet leshimi në qarkullim i kimikaleve në pajtim me ligjin me të cilin rregullohen mjetet për mbrojtjen e bimeve.

(5) Pergjigjen nga paragrafet (2) dhe (3) të ketij neni për mjetet për mbrojtjen e bimeve, Agjencia për Barna e perpilon në bashkepunim me organin kompetent për mbrojtjen e bimeve.

#### Neni 76

(1) Eksportuesi është e obliguar që për kimikalin i cili gjenden në Listen e kimikaleve me procedure PIC, perkatesisht për kimikalin i cili permban substance nga kjo liste në koncentrim të tille që sipas ketij ligji klasifikohet si e rrezikshme, të parashtrroje kerkese për zbatimin e procedures PIC.

(2) Me perjashtim nga paragrafi (1) i ketij neni, nese vendi anetar i Konventes së Roterdamit ka dorezuar pergjigje për atë kimikal te Sekretariati i Konventes, eksportuesi nuk është e obliguar që të parashtrroje kerkese për zbatimin e procedures PIC për kimikalin nga Lista e Konventes së Roterdamit.

(3) Në baze të kerkeses nga paragrafi (1) i ketij neni, Agjencia për Barna është e obliguar që nga organi kompetent i vendit në të cilin eksportohet të kerkoje pelqim paraprak sipas procedures PIC.

(4) Agjencia për Barna eksportuesit i cili ka parashtruar kerkese për zbatimin e procedures PIC i jep vertetim për procedurën PIC të zbatuar me pergjigje sipas nenit 75 paragrafi (4) të ketij ligji.

(5) Eksportuesi nga paragrafi (4) i ketij neni është e obliguar që të veproje në pajtim me pergjigjen e organit kompetent të vendit në të cilin eksportohet.

#### Neni 77

(1) Rastet në të cilat zbatohet procedura PIC, si dhe permbajtjen e kerkeses për zbatimin e procedures PIC i percakton drejtori i Agjencisë për Barna.

(2) Pjese perberese e aktit nga paragrafi (1) të ketij neni është edhe Lista e kimikaleve për procedure PIC.

#### Neni 78

(1) Eksportuesi i kimikalit nga Lista e kimikaleve me procedure për njoftim paraprak, perkatesisht kimikali i cili permban substance nga ajo liste, si dhe kimikalit nga Lista e kimikaleve me procedure PIC, perkatesisht kimikalit dhe prodhimin i cili permban substance nga ajo liste është e obliguar që t'i dorezoje Agjencisë për Barna informata për sasite e eksportuara, vendin në të cilin ka eksportuar kimikal, perkatesisht prodhim dhe të dhena të pergjithshme për importuesin, deri më 31 mars të vitit rrjedhes për vitin paraprak.

(2) Importuesi i kimikalit nga Lista e kimikaleve me procedure për njoftim paraprak, perkatesisht kimikalit i cila permban substance nga ajo liste, si dhe kimikalit nga Lista e kimikaleve me procedure PIC, perkatesisht kimikalit dhe prodhimin i cili permban substance nga ajo liste është e obliguar që t'i dorezoje Agjencisë për Barna krahas të dhenave nga neni 57 paragrafi (1) edhe informata për vendin i cili ka importuar dhe të dhena të pergjithshme për eksportuesin, deri më 31 mars të vitit rrjedhes për vitin paraprak.

(3) Importuesi i prodhimin i cili permban kimikal nga Lista e kimikaleve me procedure PIC është e obliguar që të dorezoje në Agjencinë për Barna informata për vitin paraprak për sasite e importuara, për vendin nga i cili ka importuar dhe të dhena të pergjithshme për importuesin, deri më 31 mars të vitit rrjedhes.

(4) Në baze të të dhenave nga paragrafet (1), (2) dhe (3) të ketij neni, Agjencia për Barna mban evidence për kimikalet e importuara ose të eksportuara, perkatesisht për prodhimet me procedure të njoftimit paraprak dhe procedure PIC nepermjet bazes elektronike të të dhenave.

#### Neni 79

(1) Eksportuesi i është e obliguar që të dorezoje në Agjencinë për Barna informata për transit të kimikalit nga Lista e Konventes së Roterdamit nepermjet territorit të atij vendi, të cilat i kerkon organi kompetent i vendit anetar të Konventes së Roterdamit, më së voni 30 dite para dites së transitit të pare ose tete dite para çdo transitit pasues.

(2) Agjencia për Barna organit kompetent të vendit anetar të Konventes së Roterdamit nga paragrafi (1) i ketij neni i dorezon informata për transitin e kimikalit më së voni 15 dite para dites së transitit të pare ose para çdo transitit pasues.

(3) Agjencia për Barna perpilon liste të vendeve anetare të Konventes së Roterdamit të cilat kerkojne informata për transit të kimikalit dhe permbajtjen e atyre informatave.

#### Neni 80

(1) Kimikale dhe prodhime të rrezikshme të caktuara perdorimi i të cilave është i ndaluar në listen nga paragrafi (4) i ketij neni, nuk guxojne të eksportohen.

(2) Krahas kimikaleve nga paragrafi (1) i ketij neni nuk guxojne të eksportohen edhe kimikale, e vecanerisht pesticide pastertia e të cilave nuk eshte në pajtim me pastertine e percaktuar, si dhe kimikale afati i perdorimit i të cilave skadon gjashte muaj pas eksportit.

(3) Lista e kimikaleve dhe prodhimeve të rrezikshme eksporti i të cilave eshte i ndaluar permban së paku emrin e kimikalit të rrezikshem, perkatesisht prodhimin, numrat me të cilat identifikohet kimikali, perkatesisht prodhimi dhe numrin tarifor të kimikalit të rrezikshem, perkatesisht prodhimin.

(4) Listen e kimikaleve të rrezikshme dhe prodhimeve eksporti i të cilave eshte i ndaluar e percakton drejtori i Agjencise për Barna.

#### Neni 81

Për vleresim profesional të të dhenave të cilat i dorezon eksportuesi për zbatimin e procedures së njoftimit paraprak dhe procedures PIC paguhet kompensim.

#### Neni 82

Drejtoria Doganore e kontrollon zbatimin e procedures për njoftim paraprak, perkatesisht procedures PIC.

### X. LEJET PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISE PËR QARKULLIM DHE LEJET PËR PERDORIMIN E KIMIALEVE VECANERISHT TË RREZIKSHME

#### Neni 83

(1) Leshim në qarkullim të kimikaleve të caktuara të rrezikshme (në tekstin e metejme: Kimikale vecanerisht të rrezikshme) mund të kryejne vetem personat juridike që kane leje për kryerjen e veprimtarise qarkullim me kimikale vecanerisht të rrezikshme.

(2) Leja për kryerjen e veprimtarise qarkullim me kimikale vecanerisht të rrezikshme i jepet personit juridik i cili ka siguruar magazinim perkates dhe ruajtje të kimikalit vecanerisht të rrezikshem, që të mos jene të arritshem për personat që mund t'i perdorin për qellime të palejuara, në pajtim me masat preventive për ruajtje të sigurt dhe magazinim të kimikaleve vecanerisht të rrezikshme.

(3) Agjencia për Barna percakton se për cilat kimikale vecanerisht të rrezikshme ka nevoje për leshimin e lejes, kurse për cilat kimikale vecanerisht të rrezikshme nuk ka nevoje për leshimin e lejes për kryerjen e veprimtarise qarkullim dhe perdorim të kimikaleve vecanerisht të rrezikshme.

(4) Masat preventive për ruajtjen e sigurt dhe magazinimin e kimikaleve vecanerisht të rrezikshme i percakton drejtori i Agjencise për Barna dhe publikohen në ueb faqen e Agjencise për Barna.

#### Neni 84

(1) Personat fizike që shfrytezojne kimikale vecanerisht të rrezikshme jane të obliguar që të kene leje për perdorimin e atyre kimikaleve.

(2) Leja për perdorimin e kimikaleve vecanerisht të rrezikshme i leshohet personit fizik i cili i shfrytezon për qellime artistike, shkencore dhe qellime tjera specifike, nese në vend të atyre kimikaleve nuk mund të shfrytezojen kimikale tjera alternative, nese i perdor dhe i ruan në menyre të sigurt.

#### Neni 85

(1) Kerkesa për leshimin e lejes nga neni 83 paragrafi (1) dhe 84 paragrafi (1) i ketij ligj, së paku permban emrin dhe adresen e parashtruesit të kerkeses, të dhena për kimikalin vecanerisht të rrezikshem dhe arsyet për kerkimin e lejes.

(2) Me kerkesen për leshimin e lejes për kryerjen e veprimtarise qarkullim me kimikale vecanerisht të rrezikshme dorezohet deshmi për sigurimin e lokalit perkates për magazinim dhe masat e percaktuara preventive për ruajtjen e sigurt dhe magazinimin e kimikaleve vecanerisht të rrezikshme.

(3) Me kerkesen për leshimin e lejes për perdorimin e kimikaleve vecanerisht të rrezikshme dorezohet arsyetim për menyren e perdorimit të kimikalit vecanerisht të rrezikshem dhe menyren e ruajtjes së atij kimikali.

(4) Masat preventive nga paragrafi (2) i ketij neni kane të bejne sidomos me ruajtjen e sigurt, perkatesisht magazinimin e kimikaleve vecanerisht të rrezikshme, procedurat e sigurise dhe me menyren e kryerjes së kontrollit të brendshem të procedurave të sigurise dhe të menaxhimit me kimikale vecanerisht të rrezikshme.

(5) Formularin e kerkeses për kryerjen e veprimtarise qarkullim me kimikale vecanerisht të rrezikshme, Formularin e kerkeses për leshimin e lejes për perdorimin e kimikaleve vecanerisht të rrezikshme, Formularin e lejes për kryerjen e veprimtarise qarkullim me kimikale vecanerisht të rrezikshme dhe Formularin e lejes për perdorimin e kimikaleve vecanerisht të rrezikshme, i percakton drejtori i Agjencise për Barna dhe publikohen në ueb faqen e Agjencise për Barna.

#### Neni 86

(1) Në proceduren për leshimin e lejes për kryerjen e veprimtarise qarkullim me kimikale vecanerisht të rrezikshme behet vleresimi nese eshte e nevojshme që në leje të shenohen edhe kushtet për ruajtje të sigurt dhe magazinim të atyre kimikaleve.

(2) Në proceduren për leshimin e lejes për perdorimin e kimikaleve vecanerisht të rrezikshme behet vleresimi nese eshte e nevojshme që në leje të shenohen edhe kushtet për ruajtje të sigurt dhe perdorim të atyre kimikaleve.

(3) Në proceduren për leshimin e lejeve nga paragrafet (1) dhe (2) të ketij neni percaktohet edhe afati i vlefshmerise së lejes i cili nuk mund të jete më i gjate se pese vjet.

#### Neni 87

(1) Drejtori i Agjencise për Barna leshon leje për kryerjen e veprimtarise qarkullim me kimikale vecanerisht të rrezikshme prodhuesit, importuesit ose shfrytezuesit të metejme.

(2) Në lejen nga nenet 83 paragrafi (1) dhe 84 paragrafi (1) të ketij ligji vecanerisht shenohet emri i pronarit të lejes, dedikimi për leshimin e lejes, afati i vlefshmerise së lejes dhe menyra për ruajtjen e sigurt dhe magazinim, perkatesisht ruajtjen e sigurt dhe perdorimin, të percaktuara në proceduren për leshimin e lejes.

(3) Kunder aktvendimit nga paragrafi (1) i ketij neni mund të parashtrohet ankese te Komisioni kompetent i shkalles së dyte të Qeverise së Republikes së Maqedonise.

(4) Shpenzimet reale të procedures për leshimin e lejes për kryerjen e veprimtarise qarkullim me kimikale vecanerisht të rrezikshme dhe lejes për perdorimin e kimikaleve vecanerisht të rrezikshme jane në llogari të parashtruesit të kerkeses.

#### Neni 88

(1) Afati i vlefshmerise së lejes nga neni 86 paragrafi (3) i ketij ligji vazhdohet me kerkese të pronarit të lejes, gjashte muaj para skadimit të lejes, dhe ai vazhdohet në afat jo më të gjate se pese vjet.

(2) Agjencia për Barna bën vleresim të kerkeses për vazhdimin e lejes dhe e vazhdon lejen, nese edhe më tej nuk plotesohen kushtet për leshimin e lejes.

(3) Kunder aktvendimit nga paragrafi (1) i ketij neni mund të parashtrohet ankese te Komisioni kompetent i Shkalles së dyte të Qeverise së Republikes së Maqedonise.

(4) Shpenzimet reale në proceduren për vazhdimin e lejes për kryerjen e veprimtarise qarkullim me kimikale vecanerisht të rrezikshme dhe lejes për perdorimin e kimikaleve vecanerisht të rrezikshme jane në llogari të parashtruesit të kerkeses.

## Neni 89

Pronari i lejes eshte i obliguar qe t'u permbahet masave preventive nga neni 83 paragrafi (4) i ketij ligji dhe magazinimit te sigurt dhe ruajtjes, perkatesisht ruajtjes se sigurt dhe perdorimit te kimikaleve vecanerisht te rrezikshme nga neni 87 paragrafi (2) i ketij ligji dhe t'i dorezoje te gjitha ndryshimet e te dhenave te cilat i ka parashtruar ne proceduren e leshimit te lejes.

## Neni 90

(1) Agjencia per Barna do ta heq lejen nga nenet 83 paragrafi (1) dhe 84 paragrafi (1) i ketij ligji, nese ne proceduren per leshimin e lejes jane dorezuar te dhena te pasakta dhe nese me tej nuk jane plotesuar te gjitha kushtet nga leja.

(2) Kunder aktvendimit nga paragrafi (1) i ketij neni mund te parashtrohet ankese te Komisioni kompetent i shkalles se dyte te Qeverise se Republikes se Maqedonise.

## Neni 91

Në institucionet shkencore-hulumtuese, personat që kryejne veprimtari kulturore, organet shteterore, organet e njesise se vetadministrimit lokal te cileve per pune u jane te domosdoshme kimikale vecanerisht te rrezikshme, si dhe per personat juridike te cilet kane leje per prodhim, perkatesisht qarkullim te barnave ne pajtim me Ligjin per barna dhe mjete ndihmese mjekesore, nuk eshte e nevojshme leje per kryerjen e veprimtarise qarkullim me kimikale vecanerisht te rrezikshme.

## Neni 92

(1) Pronari i lejes per kryerjen e veprimtarise qarkullim me kimikale vecanerisht te rrezikshme mund te kryeje qarkullim me kimikale vecanerisht te rrezikshme me personat juridike te cilat i shfrytezojne per qellime industriale ose profesionale, si dhe me pronare tjere te lejes per kryerjen e veprimtarise qarkullim ose leje per perdorimin e kimikaleve vecanerisht te rrezikshme.

(2) Pronari i lejes per kryerjen e veprimtarise me kimikale vecanerisht te rrezikshme eshte i obliguar qe krahas evidences nga neni 20 i ketij ligji te mbaje evidence edhe per konsumatoret te cileve u eshte shitur ose leshuar pa kompensim kimikali vecanerisht i rrezikshem.

(3) Menyren e mbajtjes se evidences per qarkullim me kimikale vecanerisht te rrezikshme e percakton drejtori i Agjencise per Barna.

## XI. PRODHIMET BIOCID

## Neni 93

(1) Substancat te cilat shfrytezojen per perpunimin e prodhimeve biocide ( ne tekstin e metejme: substanca aktive), mund te leshohen ne qarkullim dhe te shfrytezojen vetem nese jane ne pajtim me kerkesat e ketij ligji.

(2) Listen e substancave aktive per perfshirje ne prodhimet biocide, Listen e perfshirjes ne prodhime biocide me rrezik te ulet, Listen e substancave bazike, llojin e prodhimeve biocide, si dhe pershkrimin e tyre i percakton drejtori i Agjencise per Barna.

(3) Per substancat aktive te cilat ne baze te deklarates se propozuesit do te perdoren ekskluzivisht per perpunimin e prodhimeve biocide, nuk zbatohen dispozitat e ketij ligji te cilat kane te bejne me paraqitjen e substancave te reja.

## Neni 94

(1) Prodhimet biocide mund te leshohen ne qarkullim dhe te shfrytezojen, nese Agjencia per Barna leshon leje per leshim ne qarkullim nepermjet procedures se miratimit ose regjistrimit dhe t'i regjistroje ne Regjistrin e prodhimeve biocide.

(2) Menyren e leshimit ne qarkullim nepermjet procedures se miratimit ose regjistrimit e percakton drejtori i Agjencise per Barna.

(3) Leja per leshim ne qarkullim te prodhimeve biocide leshohet me se gjati per periudhe deri ne dhjete vjet.

(4) Leja per leshim ne qarkullim mund te kushtezohet me kufizime te vecanta te cilat dalim nga natyra e prodhimit biocid dhe zbatimi i tij i parapare te permbajtura ne kerkeses per leshim ne qarkullim nga neni 95 paragrafi (1) i ketij ligji.

(5) Gjate leshimit te lejes per leshim ne qarkullim, organi kompetent do t'i marre parasysht edhe dispozitat tjera qe kane te bejne me mbrojtjen e shendetit te njerezve dhe te mjedisit jetesor.

(6) Shpenzimet reale ne proceduren per leshimin ne qarkullim te prodhimeve biocide jane ne llogari te parashtruesit te kerkeses.

## Neni 95

(1) Kerkesa per leshim ne qarkullim te prodhimit biocid parashtrohet te Agjencia per Barna nga personi juridik ose perfaqesuesi i tij i autorizuar, pergjegjes per hyrjen e pare te prodhimit biocid ne vend.

(2) Cdo propozues duhet te kete seli ne Republikën e Maqedonise.

## Neni 96

(1) Leja per leshim ne qarkullim mund te ndryshohet ne cilendo qofte periudhe te vlefshmerise, nese jane ndryshuar kushtet ne te cilat eshte leshuar.

(2) Bartesi i lejes per leshim ne qarkullim te prodhimit biocid eshte i obliguar qe me kerkesa te Agjencise per Barna t'i siguroje te dhenat e nevojshme per ndryshime.

## Neni 97

(1) Kerkesa per leshimin e lejes per leshim ne qarkullim te prodhimeve biocide permban te dhena per:

- 1) emrin dhe seline e propozuesit;
- 2) emrin dhe seline e prodhuesit te biocidit;
- 3) te dhenat per cilesite fizike-kimike te biocidit;
- 4) te dhenat per analizat laboratorike dhe analizat tjera ne baze te te cilave mund te konkludohet se sa eshte demi i prodhimit biocid per shendetin e njerezve dhe te mjedisit jetesor;

5) propozimin e deklarates dhe te udhezimit per perdorim; aktvendimin per leshim ne qarkullim te prodhimit biocid ne vendin e prodhuesit;

6) listen e vendeve ne te cilat prodhimi biocid eshte i lejuar per perdorim dhe i leshuar ne qarkullim;

7) statusin e prodhimit biocid ne vendin e prodhimit;

8) udhezimin per menyren e menaxhimit me mbeturinat dhe ambalazhin pas kalimit te afatit te prodhimit biocid, perkatesisht pas perdorimit te tij;

9) dosjen ose letren per lejim te prodhimit biocid me te dhenat e permbajtura ne permbledhjen e te dhenave kryesore per prodhimin biocid dhe

10) per substancen aktive, si dhe ne permbledhjen e te dhenave plotesuese per prodhimin biocid dhe per substancen aktive te percaktuar nga drejtori i Agjencise per Barna dhe

11) te dhena tjera qe do t'i percaktoje drejtori i Agjencise per Barna.

(2) Formen dhe permbajtjen e kerkeses dhe menyren e leshimit te lejes nga paragrafi 1 i ketij neni i percakton drejtori i Agjencise per Barna.

(3) Nese per shkak te natyres se prodhimit biocid ose perdorimit te tij te propozuar ekzistojne informata te cilat nuk jane te domosdoshme qe te dorezohen, informatat nuk dorezohen.

(4) Dispozita nga paragrafi (3) i ketij neni zbatohet edhe kur nuk eshte e domosdoshme shkencerisht ose teknikisht e mundur te parashtrohen informatat e kerkuara. Ne atë raste parashtrohen pohime te pranueshme per Agjencine per Barna, siç eshte ekzistimi i formulimit kornize ne te cilin propozuesi ka te drejte qasjeje.

(5) Nese pas evaluimit të dokumenteve, për evaluim të rrezikut nga prodhimi biocid, vertetohet se është e domosdoshme që të dorezohen të dhena plotesuese, propozuesi është i obliguar që t'i siguroje, duke i përfshirë edhe të dhënat nga analizat e nevojshme plotesuese.

(6) Periudha kohore për evaluimin e dosjes konsiderohet nga dita e dorezimit të dosjes së kompletuar.

(7) Menyren e evaluimit të dosjes për prodhimet biocide i percakton drejtori i Agjencise për Barna.

#### Neni 98

(1) Emri i substancës aktive duhet të jetë ashtu siç është shënuar në Listen e substancave aktive nga neni 93 paragrafi (2) i këtij ligji, ose siç është shënuar në listen e EINECS dhe Listen nacionale të substancave të reja dhe substancave tanime të klasifikuara të cilat janë në qarkullim në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Nese substanca aktive nuk është e përfshirë në listat nga paragrafi (1) i këtij neni, shënohet emri i saj i zakonshëm, ose nese ky nuk është i kapshëm, shënohet në pajtim me nomenklaturën IUPAC (Unioni nderkombetar i kimisë së paster dhe aplikative - International Union of Pure and Applied Chemistry).

#### Neni 99

Menyren e përfshirjes së substancave aktive në listat nga neni 93 paragrafi (2) i këtij ligji e percakton drejtori i Agjencise për Barna.

#### Neni 100

(1) Analizat e prodhimeve biocide kryhen në pajtim me nenin 17 të këtij ligji.

(2) Nese analiza është kryer me metoda të ndryshme nga metodat e percaktuara, nevoja për kryerjen e analizave të reja percaktohet për çdo kerkese në vecanti dhe nese është e mundur nuk duhet të kryhen mbi kurrizoret.

#### Neni 101

(1) Që të shmangët perseritja e analizave mbi kurrizoret, parashtruesi i kerkeses për leshim në qarkullim të prodhimit biocid, para fillimit të procedurave që përfshinë kryerjen e eksperimenteve mbi kurrizoret, është i obliguar që ta njoftojë Agjencinë për Barna për qëllimet e tij dhe të kërkojë të dhëna për analizat e kryera të prodhimeve të ngjashme biocide, si dhe emrin dhe adresën e bartesit të lejes për leshim në qarkullim të prodhimit biocid.

(2) Kerkesa nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të shoqërohet me dëshmi se propozuesi ka për qëllim të parashtrë kerkese për leshim në qarkullim të prodhimit biocid dhe se i posedon të gjitha të dhënat tjera të nevojshme.

(3) Agjencia për Barna është e obliguar që ta njoftojë bartesin e lejes për leshim në qarkullim të prodhimeve biocide për emrin dhe adresën e bartesit të lejes dhe ta informojë bartesin e lejes për emrin dhe adresën e propozuesit të ri që të kontraktohet shkëmbimi i informatave, në interes të shmangies së perseritjes së analizave tanime të kryerja mbi kurrizoret.

#### Neni 102

Informatat e përbajtura në dosjen e parashtruesit të kerkeses për leshim në qarkullim të prodhimit biocid për të cilin është leshuar leje për leshim në qarkullim, nuk mund të shfrytëzohen nga ana e parashtruesve tjerë të kerkeses për leshim në qarkullim të prodhimeve biocide, përveç në rastet e percaktuara nga drejtori i Agjencise për Barna.

#### Neni 103

Bartesi i lejes është i obliguar që Agjencise për Barna t'ia dorëzojë të gjitha informatat relevante për:

- njohuritë e reja ose informatat për efektet e substancës aktive ose prodhimit biocid mbi shëndetin e njerëzve dhe mjedisin jetësor,

- ndryshimet e burimit ose perberjes së substancës aktive,  
- ndryshimet në perberjen e prodhimit biocid,  
- paraqitjen e rezistencës dhe  
- ndryshimet me karakter administrativ, siç janë ndryshimet në paketim.

#### Neni 104

(1) Agjencia për Barna mban Regjister të prodhimeve biocide në baze të aktvendimeve të leshuara për leshim në qarkullim.

(2) Regjistri i prodhimeve biocide publikohet një herë në vit në ueb faqen e Agjencise për Barna dhe i përmban të dhënat për emrin tregtar të prodhimit biocid, emrin e substancës aktive, emrin e prodhuesit dhe të përfaqësuesit, numrin dhe datën e leshimit të aktvendimit dhe afatin e vlefshmerisë së lejes.

(3) Formën, përmbajtjen dhe menyren e mbajtjen së Regjistrit të prodhimeve biocide, e percakton drejtori i Agjencise për Barna.

#### Neni 105

Prodhimet biocide të cilat janë të klasifikuara si helmuese, shumë helmuese, kancerogjene ose mutagjene, si dhe toksike për sistemin riprodiktiv nuk guxojnë të miratohen për leshim në qarkullim për përdorim publik.

#### Neni 106

Me përjashtim, nga neni 94 paragrafi (1) i këtij ligji Agjencia për Barna mund të leshojë leje për shfrytëzim të prodhimit biocid më së gjati në periudhë prej 120 ditësh, në kushte të caktuara dhe në sasi të caktuara.

#### Neni 107

Në rast të gjendjes së jashtëzakonshme, e me qëllim që të pengohet paraqitja e demtuesve të caktuar, kur nuk ka mjete të arritshme perkatese ose kur nuk është e mundur të ndërmerren masa tjera, Agjencia për Barna leshon leje për shfrytëzim të prodhimeve të caktuara biocide në kushte të vecanta dhe në sasi të caktuara.

#### Neni 108

(1) Leja për leshim në qarkullim të prodhimit biocid leshohet në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të dokumentacionit të kompletuar.

(2) Nese dokumentacioni nuk është i kompletuar, Agjencia për Barna, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kerkeses do ta njoftojë parashtruesin e kerkeses që ta plotesojë dokumentacionin.

(3) Kunder aktvendimit të Agjencise për Barna mund të parashtrohet ankese te Komisioni kompetent i shkallës së dytë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 109

(1) Leja për leshim në qarkullim të prodhimit biocid perteritet para skadimit të afatit për të cilin është leshuar në baze të vlerësimit të serishëm të dokumentacionit nga neni 97 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Për perteritjen e lejes për leshim në qarkullim, bartesi i lejes për leshim në qarkullim duhet të parashtrë kerkese te Agjencia për Barna së paku 90 dite para ditës së skadimit të vlefshmerisë së lejes për leshim në qarkullim.

#### Neni 110

(1) Agjencia për Barna e heq ose ndryshon lejen për perteritje për leshim në qarkullim të prodhimit biocid, nese  
- ka ardhur te ndryshimi i fakteve në baze të të cilave është leshuar leja,  
- substanca aktive është përjashtuar nga përdorimi,  
- kushtet për leshimin e lejes për leshim në qarkullim janë ndryshuar ose nuk janë të plotësuar më tej,  
- ka ardhur deri në ndryshimin e propozuesit të të drejtave të prodhimit biocid,

- leja eshte leshuar në baze të të dhenave të gabuara ose të pasakta,  
 - të dhenave plotesuese nga Qendra Nacionale dhe  
 - bartesi i lejes dorezon kerkese me arsyetim për heqjen ose ndryshimin.

(2) Nese ndryshimi ka të beje me ndryshimin e perm-bajtjes së listes së substancave aktive, ai lejohet pas evalui-mit të kryer të substances aktive me të cilin ka të beje ker-kesa, në pajtim me proceduren e percaktuar në nenin 94 pa-ragrafi (1) të ketij ligji.

(3) Për heqjen ose ndryshimin e lejes për leshim në qar-kullim Agjencia për Barna e njofton bartesin e lejes.

#### Neni 111

(1) Dispozitat nga neni 7 paragrafi (1) i ketij ligji nuk zbatohen në marreveshjet me rendesi të vogël.

(2) Marreveshje me rendesi të vogël konsiderohet marreveshja në të cilën pjesëmarrja e perbashket në treg e pjesëmarrësve në marreveshje dhe ndermarrjet nën kontrollin e tyre në treg, nuk e tejkalojnë pragu prej 10%, nese marreveshja është horizontale ose pragu prej 15%, nese marreveshja është vertikale. Në rast kur nuk mund të percaktohet nese marreveshja është horizontale ose vertikale, do të zbatohet pragu prej 10%.

(3) Dispozitat nga paragrafi (1) i ketij neni do të zbatohen edhe, nese pjesëmarrja në treg e ndermarrjeve në dy vitet afërste të fundit nuk është rritur për më shumë se 2%.

(4) Kushtet më të peraferta për marreveshjet me rendesi të vogël nga ky nen, me propozim të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, i percakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(5) Me aktin nga paragrafi (4) i ketij neni percaktohen vecanerisht:

1) pjesëmarrjet në treg të paleve kontraktuese me rendesi për kualifikim të marreveshjeve si marreveshje me rendesi të vogël dhe

2) kufizimet dhe/ose dispozitat që nuk guxojnë të jene të permbajtura në marreveshjet me rendesi të vogël.

**Perjashtime grupore**

Neni 9

(1) Dispozitat nga nenit 7 paragrafi (3) i ketij ligji zbatohen vecanerisht në llojet e marreveshjeve në vijim:

1) marreveshjet vertikale për të drejten ekskluzive të distribuimit, të drejten selektive të distribuimit, të drejten ekskluzive të blerjes dhe franshizingut;

2) marreveshjet horizontale për hulumtim dhe zhvillim ose për specializim;

3) marreveshjet për transferim të teknologjise, për licence ose për know – how;

4) marreveshjet për distribuim dhe servisim të automjeteve;

5) marreveshjet për sigurim dhe

6) marreveshjet në sektorin e transportit.

(2) Kushtet më të peraferta për perjashtime grupore të marreveshjeve nga paragrafi (1) i ketij neni, me propozim të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, i percakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(3) Me aktin nga paragrafi (2) i ketij neni percaktohen vecanerisht:

1) vëllimi i zbatimit të perjashtimit grupor;

2) kushtet më të peraferta lidhur me pjesëmarrjet në treg dhe elementet e marreveshjeve që duhet të plotësohen për zbatim të perjashtimit grupor;

3) kufizimet dhe obligimet që nuk guxojnë të permbahen në marreveshjet dhe

4) kushtet më të peraferta për terheqje të perjashtimit grupor.

**Kapitulli i dyte**

**POZITA DOMINUESE NË TREG DHE PRISHJA  
E KONKURENCES**

**Pozita dominuese**

Neni 10

(1) Një ndermarrje ka pozite dominuese në tregun relevant, nese si shites ose bleres potencial i llojit të caktuar të mallrave dhe/ose shërbimeve:

1) nuk ka konkurrente në tregun relevant ose

2) në krahasim me konkurrentet e tij ka pozite udhëheqese në tregun relevant, e vecanerisht duke pasur parasysh:

- pjesëmarrjen në treg dhe poziten dhe/ose

- fuqinë financiare dhe/ose

- qasjen në burimet e furnizimit ose të tregut dhe/ose

- lidhshmerine me ndermarrjet tjera dhe/ose

- pengesat juridike ose faktike për hyrje të ndermarrjeve tjera në treg, dhe/ose

- aftesine për diktim të kushteve në treg duke pasur parasysh oferten ose kerkesen e tij dhe/ose

- aftesine për perjashtim të konkurrenteve tjere nga tregu për orientim drejt ndermarrjeve tjera.

(2) Supozohet se një ndermarrje ka pozite dominuese, nese pjesëmarrja e saj në tregun relevant është më shumë se 40%, pervec nese ndermarrja nuk e deshmon të kundernten.

(3) Supozohet se dy se më shumë ndermarrje të pavarura juridikisht në tregun e caktuar relevant kane pozite të perbashket dominuese, nese marrin pjese ose veprojnë bashkerisht në tregun relevant.

## Keqperdorimi i pozites dominuese

### Neni 11

(1) Ndalohet çdo keqperdorim i pozites dominuese i një ose më shume ndermarrjeve në tregun relevant ose pjeses së tij thelbesore.

(2) Keqperdorimi nga paragrafi (1) i ketij neni ekziston vecanerisht në rast të:

1) imponimit të drejtperdrejte ose të terthorte të cmimeve të padrejta të blerjes ose të shitjes ose kushteve tjera të padrejta të tregtimit;

2) kufizimit të prodhimitarise, tregjeve ose zhvillimit teknik në dëm të konsumatoreve;

3) aplikimit të kushteve të ndryshme për pune juridike të njejta ose të ngjashme me partneret tjere tregtare, me cfare i vihen në pozite të pavolishme konkurruese;

4) kushtezimit të lidhjes së marreveshjeve me pranim nga palet tjera kontraktuese obligime shtese, që sipas natyres së vet ose në pajtim me traditat tregtare, nuk lidhen me lenden e marreveshjes;

5) refuzimit të pabazuar që të tregtohet ose nxitjes dhe kerkeses nga ndermarrjet tjera ose shoqatat e ndermarrjeve të mos blejne ose shesin mallra dhe/ose sherbime në ndonje ndermarrje të caktuar, me qellim që në menyre të pandershme t'i shkaktohet dëm asaj ndermarrjeje dhe

6) refuzimit të paarsyeshem që t'i mundesohet qasje në rrjetin personal ose objekte tjera infrastrukturore ndermarrjes tjeter për kompensim perkates, nese pa shfrytezimin e ketille të njekohshem, ndermarrja tjeter, për shkaqe juridike ose faktike pamundesohet të veproje si konkurrent në tregun e caktuar relevant.

(3) Dispozita nga paragrafi (2) pika 6) e ketij neni nuk do të zbatohet, nese ndermarrja me pozite dominuese deshmon se, për shkaqe operative ose shkaqe tjera, shfrytezimi i njekohshem i rrjetit të vet ose i objekteve të veta infrastrukturore nuk eshte i mundur ose kjo nuk mund të lejohet për shkaqe të arsyeshme.

## Kapitulli i trete

### KONCENTRIME

#### Krijimi i koncentrimit

### Neni 12

(1) Koncentrimi krijohet me ndryshimin e kontrollit në baze afatgjate, e si rezultat i:

1) lidhjes së dy ose me shume ndermarrjeve të pavarura paraprakisht ose pjesëve nga ndermarrjet ose

2) fitimi i të drejtes së kontrollit të drejtperdrejte ose të terthorte mbi të gjithë ndermarrjen ose pjeset e një ose më shume ndermarrjeve tjera nga

- një ose më shume persona të cilet tanime kontrollojne së paku një ndermarrje ose

- një ose më shume ndermarrje, nepermjet blerjes së letrave me vlere ose prones, me marreveshje ose në menyre tjeter të percaktuar me ligj.

(2) Kontrolli nga paragrafi (1) i ketij neni perbehet nga të drejtat, marreveshjet ose mjetet tjera që veç e veç ose në kombinim, e duke pasur parasysh gjendjen faktike ose juridike, japin mundesi për kryerjen e ndikimit vendimmarres mbi ndermarrjen, vecanerisht nepermjet:

1) pronesise ose të drejtes së shfrytezimit të të gjithë prones së ndermarrjes ose një pjese të saj ose

2) të drejtave ose marreveshjeve që japin mundesi për ndikim vendimmarres mbi perberjen, votimin ose marrjen e vendimeve nga organet e ndermarrjes.

(3) E drejta e kontrollit fitohet nga persona ose ndermarrje që:

1) jane posedues të të drejtave ose i kane fituar të drejtat nepermjet marreveshjeve nga paragrafi (2) i ketij neni ose

2) jane të autorizuar t'i realizojne të drejtat e tilla, edhe pse nuk jane bartes të të drejtave të tilla, e as nuk kane fituar të drejta nepermjet marreveshjeve nga paragrafi (2) i ketij neni.

(4) Krijimi i investimit të perbashket (joint venture), i cili në baze afatgjate do të kryeje aktivitete në teresine ekonomike autonome, konsiderohet për koncentrim në pajtim me paragrafin (1) pika 2) të ketij neni.

(5) Për koncentrim të ndermarrjeve nuk konsiderohet kur:

1) bankat, kursimoret dhe institucionet tjera financiare ose shoqerite për sigurim, aktivitetet e të cilave perfshijne pune juridike ose tregtim me letra me vlere, perkohesisht fitojne letra me vlere me qellim që ato perseri të shiten në afat prej një viti nga momenti i fitimit të tyre dhe nese të drejtat e votimit nga ato letra me vlere nuk kryhen me qellim që të ndikohet në sjelljen konkurruese të ndermarrjes në treg. Komisioni me kerkese të posacme me konkluzion mund ta vazhdoje afatin prej një viti, nese fituesi deshmon se për shkaqe të arsyeshme nuk ka mundur t'i shese letrat me vlere. Kunder ketij konkluzion nuk lejohet ankese, e as padi për ngritjen e kontestit administrativ;

2) kontrolli kryhet nga ana e perfaqesuesit të shoqerise në procedure falimentimi ose në procedure likuidimi, perkatesisht te ndermarrjet e themeluara jashte Republikes së Maqedonise, persona që e kryejne funksionin perkates në pajtim me legjislacionin sipas të cilit eshte themeluar ndermarrja dhe

3) fondet investuese fitojne interes kapital në ndermarrjet, me kusht ato t'i realizojne të drejtat e fituara me të vetmin qellim që të ruhet vlere e plote e investimit të tyre, dhe nese nuk kryhet ndikim mbi sjelljen konkurruese të ndermarrjeve në treg.

## Pjesemarresit në koncentrim

### Neni 13

Pjesemarres në koncentrim jane:

1) ndermarrjet që bashkohen në pajtim me nenin 12 paragrafi (1) pika 1) të ketij ligji dhe

2) personat ose ndermarrjet që fitojne të drejten e kontrollit mbi të gjithë ndermarrjen ose pjeset e një ose më shume ndermarrjeve tjera në pajtim me nenin 12 paragrafin (1) pika 2) të ketij ligji, si dhe ndermarrjet ose pjeset e ndermarrjeve në baze të të cilave fitohet e drejta e kontrollit.

## Kushtet për njoftimin për koncentrim

### Neni 14

(1) Njoftimi për koncentrim te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences parashtrahet, nese:

1) të ardhurat vjetore të pergjithshme të perbashketa të të gjitha ndermarrjeve pjesemarrese, të realizuara me shitjen e mallrave dhe/ose sherbimeve në tregun boteror, e tejkalon shumen prej 10 milione euro në kundervlere me denare, sipas kursit të dites së hartimit të llogarise vjetore, të realizuar në vitin afarist që i paraprin koncentrimit, me ç'rast së paku një pjesemarres doemos duhet të jete i regjistruar në Republikën e Maqedonise dhe/ose

2) të ardhurat vjetore të pergjithshme të perbashketa të të gjitha ndermarrjeve, të realizuara me shitjen e mallrave dhe/ose sherbimeve në Republikën e Maqedonise, e tejkalon shumen prej 2,5 milione euro në kundervlere me denare, sipas kursit të dites së hartimit të llogarise vjetore, të realizuar në vitin afarist që i paraprin koncentrimit dhe/ose

3) pjesemarrja në treg e njerit prej pjesemarresve eshte më shume se 40% ose pjesemarrja e pergjithshme në treg e pjesemarresve në koncentrimin në tregut eshte me shume se 60% në vitin që i paraprin koncentrimit.

(2) Nese deri në parashtrimin e njoftimit për koncentrim, pjesemarrësit në koncentrim nuk kane hartuar llogari vjetore, si vit relevant në proceduren për vleresimin e koncentrimit konsiderohet viti i fundit për të cilin pjesemarrësit kane hartuar llogari vjetore.

(3) Në vitin e pare të punes të ardhurat nga paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 dhe pjesemarrja në treg nga paragrafi (1) pika 3 e ketij neni do të llogaritet në baze të të ardhurave të realizuara në vitin llogarites rrjedhes në nivel prej 12 muajsh.

### Obligimi për njoftimin për koncentrim

#### Neni 15

(1) Pjesemarrësit në koncentrim janë të obliguar që të Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences të dorezojnë njoftim për koncentrimin para realizimit të tij, e pas lidhjes së marrëveshjes për bashkim, perkatesisht pas publikimit të ofertes publike për blerjen ose fitimin e pjesemarrjes së shumices në kryegjene baze të ndermarrjes.

(2) Pjesemarrësit mund ta njoftojne Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrences për qellimin e tyre serioz që të lidhin marrëveshje ose në rast të ofertes publike kur publikisht e kane shprehur qellimin e tyre që të marrin pjese në të, nese marrëveshja e tille perkatesisht oferta publike do të kene si pasoje krijimin e koncentrimit në pajtim me me dispozitat e ketij ligji.

(3) Për koncentrimin i cili krijohet si rezultat i bashkimit sipas nenit 12 paragrafi (1) pika 1 të ketij ligji ose me fitimin e të drejtes së kontrollit të perbashket sipas nenit 12 paragrafi (1) pika 2 të ketij ligji, njoftim të perbashket parashtrrojne pjesemarrësit e bashkimit, perkatesisht fituesit e të drejtes së kontrollit të perbashket. Në të gjitha rastet tjera, njoftimin e parashtron personi, perkatesisht ndermarrja që e ka fituar të drejten e kontrollit mbi të gjithë ndermarrjen ose një pjese të një ose më shume ndermarrjeve.

(4) Me njoftimin për koncentrim detyrimisht dorezohet:

1) origjinal nga puna juridike që eshte baze e koncentrimit ose kopje e verifikuar;

2) raport financiar për pjesemarrësit në koncentrim për vitin afarist që i paraprin koncentrimin në origjinal ose kopje të verifikuar;

3) ekstrakt nga regjistri tregtar ose regjister tjetër të personave juridike në të cilin janë të dukshem të dhenat për firmen, seline dhe lenden e punes së pjesemarrësve në koncentrim në origjinal ose kopje të verifikuar dhe

4) të dhena për pjesemarrjen në treg të pjesemarrësve në koncentrim, si edhe të konkurrenteve të tyre.

(5) Si dite e pranimit të njoftimit konsiderohet dita kur Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences i ka pranuar të gjitha të dhenat dhe dokumentet nga paragrafi (4) i ketij neni, për cfare Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences i jep vertetim të posacem parashtruesit.

(6) Qeveria e Republikës së Maqedonise, me propozim të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences, i percakton formen dhe permbajtjen e njoftimit nga paragrafi (1) i ketij neni, si edhe dokumentacionin e nevojshem i cili parashtrohet bashke me njoftimin.

### Llogaritja e të ardhurave të pergjithshme

#### Neni 16

(1) Të ardhurat e pergjithshme nga neni 14 paragrafi (1) i ketij ligji perbehen prej shumave të realizuara me shitjen e mallrave të prodhuara në punen e rregullt të ndermarrjeve, si dhe prej shumave nga sherbimet të cilat ndermarrja i ofron në punen e saj të rregullt, e të realizuara në vitin afarist që i paraprin koncentrimin, pas heqjes së rabatit (lirimeve) të shitjes dhe të tatimit mbi vleren e shtuar dhe taksave tjera publike të lidhura drejtperdrejt me të ardhurat.

(2) Nese njeri prej pjesemarrësve eshte ndermarrje e lidhur sipas dispozitave të ketij ligji, gjate llogaritjes së të ardhurave të tij të pergjithshme, të gjitha ndermarrjet që janë të lidhura në kete menyre do të trajtohen si një ndermarrje.

(3) Kur llogariten të ardhurat e pergjithshme të ndermarrjeve të lidhura nuk do të merren parasysh shumat e realizuara nga shitja e mallrave dhe/ose dhenia e sherbimeve ndermjet tyre.

(4) Në rast kur koncentrimi nga neni 12 paragrafi (1) i ketij ligji ka të beje me fitimin e pjeses ose pjeseve nga prona e një ose më shume ndermarrjeve, pa dallim nese ato pjese janë të formuara si subjekte juridike të vecanta, gjate llogaritjes së të ardhurave të realizuara nga ndermarrja që e shet atë prone, merren parasysh vetem të ardhurat nga prona e cila eshte lende e fitimit.

(5) Dy ose më shume transakcione në pajtim me paragrafin (4) të ketij neni të cilat realizohen në periudhe prej 2 vjetesh ndermjet personave ose ndermarrjeve të njejta, llogariten për një koncentrim, të kryer në ditën e transakcionit të fundit.

(6) Për bankat, kursimoret dhe institucionet tjera financiare të ardhurat e pergjithshme nga neni 14 paragrafi (1) i ketij ligji percaktohen sipas të ardhurave të pergjithshme të realizuara nga puna e rregullt në vitin afarist që i paraprin koncentrimin.

(7) Për shoqerite e sigurimit, të ardhurat e pergjithshme nga neni 14 paragrafi (1) i ketij ligji percaktohen sipas vleres së premive të llogaritura bruto të pjesemarrësve në vitin afarist që i paraprin koncentrimin.

(8) Shumat e realizuara në valute të huaj shprehen në denare sipas kursit të mesem të Bankes Popullore të Republikës së Maqedonise në ditën e hartimit të llogarise vjetore.

### Vleresimi i koncentrimit

#### Neni 17

(1) Koncentrimet të cilat bien nën dispozitat e ketij ligji, vleresohen me qellim që të percaktohet nese të njejtat janë ose nuk janë në pajtim me kete ligj.

(2) Koncentrimi me të cilin në menyre të konsiderueshme nuk prishet konkurrenca efektive e tregut ose pjesa e tij thelbesore, vecanerisht si rezultat i krijimit ose perforcimit të pozites dominuese të pjesemarrësve, eshte në pajtim me dispozitat e ketij ligji.

(3) Koncentrimi me të cilin në menyre të konsiderueshme prishet konkurrenca efektive e tregut ose pjesa e tij thelbesore, vecanerisht si rezultat i krijimit ose perforcimit të pozites dominuese të pjesemarrësve, nuk eshte në pajtim me dispozitat e ketij ligji.

(4) Gjate vleresimit të koncentrimit, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences i merr parasysh vecanerisht:

1) nevojen që të ruhet dhe zhvillohet konkurrenca efektive e tregut ose pjeses së tij thelbesore, vecanerisht në aspekt të struktures së të gjitha tregjeve të prekura dhe konkurrentet ekzistues ose konkurrentet e ardhshem të mundshem me seli në Republikën e Maqedonise dhe jashte Republikës së Maqedonise dhe

2) poziten në treg të ndermarrjeve të prekura dhe fuqine e tyre ekonomike dhe financiare, furnizimin dhe alternativat e kapshme për furnizuesit dhe konsumatorët për furnizim në treg, si dhe qasjen e tyre në oferte, perkatesisht tregje, pengesat juridike dhe pengesat tjera për hyrje dhe dalje nga tregu, trendet e ofertes dhe kerkeses për mallrat dhe/ose sherbimet relevante, interesat e konsumatorëve dhe zhvillimin teknik dhe ekonomik, me kusht që nga ajo të kene dobi edhe konsumatorët dhe koncentrimi të mos perfaqesoje pengese për zhvillimin e konkurrences.

(5) Nese krijimi i investimit të perbashket (joint venture), i cili njekohesisht perfaqeson edhe koncentrim në pajtim me nenin 12 paragrafi (1) të ketij ligji, ka për qellim ose efekt harmonizimin e sjelljes konkurruese të ndermarrjeve të perfshira në investimin e perbashket, por të cilat mbeten juridikisht të pavarura, harmonizimi i tille i sjelljes do të vlere-sohet sipas nenit 7 paragrafet (1) dhe (3) të ketij ligji.

(6) Gjate kryerjes së vleresimit nga paragrafi (5) i ketij neni, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences vecanerisht do të merr parasysh, nese:

1) pjesemarresit në investimin e perbashket edhe më tej deri në vellimi të konsiderueshem i mbajne aktivitetet në tregun e njeje në të cilin ndikon investimi i perbashket ose në tregun i cili gjendet në nivel më të larte ose më të ulet nga tregu në të cilin ndikon investimi i perbashket ose në tregun fqinj i cili eshte i lidhur ngushte me tregun në të cilin ndikon investimi i perbashket; dhe

2) harmonizimi, i cili eshte pasoje e drejtperdrejte e krijimit të investimit të perbashket, u jep mundesi pjesemarresve në investimin e perbashket që ta eliminojne konkurren-cen për pjesen thelbesore të mallrave dhe /ose sherbimeve lendore.

### **Pezullimi i koncentrimave**

#### **Neni 18**

(1) Koncentrimi nuk guxon të realizohet as para se të parashtrohet njoftimi për të njejtin te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences, në pajtim me nenin 15 të ketij ligji, e as pas parashtrimit të njoftimit, deri sa nuk do të miratohet aktvendim se koncentrimi eshte në pajtim me dispozitat e ketij ligji, sipas nenit 19 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2, nenit 20 paragrafi (1) pikat 1, 2 dhe 3 ose para se të plotesohet parakushti nga neni 24 paragrafi (6) të ketij ligji.

(2) Dispozita nga paragrafi (1) i ketij neni nuk e ndalon oferten publike për blerjen e letrave me vlere ose të serive të transakcioneve të letrave me vlere, duke perfshire edhe ato të cilat jane konvertibile në letra tjera me vlere të dedikuara për tregtim në treg, në pajtim me ligjin, nese:

1) pa prolongim te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences eshte parashtruar njoftim, në pajtim me nenin 15 të ketij ligji dhe

2) fituesi i letrave me vlere nuk i realizon të drejtat e votimit në baze të atyre letrave me vlere ose i kryen vetem në vellimin e nevojshem për mbajtjen e vleres së plote të investimit të tij, e në baze të konkluzionit për perjashtim nga obligimet nga paragrafet (1) dhe (2) të ketij neni, të miratuar në pajtim me paragrafin (3) të ketij neni.

(3) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences, me kerkese të parashtruesit të njoftimit, me aktvendim mund të le-joje perjashtim nga obligimet nga paragrafet (1) dhe (2) të ketij ligji. Kerkesa doemos duhet të jete e arsyetuar. Gjate vendosjes për kerkesen për perjashtim, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences, në mes tjerash, i merr parasysh edhe efektet nga pezullimi i koncentrimit mbi një ose më shume ndermarrje – pjesemarrese ose mbi personin e trete, si dhe rrezikun për konkurrence të shkaktuar me koncentrimin. Perjashtimi mund të kushtezohet me imponimin e kushteve dhe obligimeve që të sigurohet konkurrence efektive. Perjashtimi mund të kerkohet dhe të lejohet në çdo kohe, perkatesisht para njoftimit ose pas transakcionit nga paragrafi (2) i ketij neni.

(4) Vlefshmeria e cilitdo transakcion të kryer në kundersh-tim me paragrafin (1) të ketij neni varret nga aktven-dimet e miratuar në pajtim me nenin 19 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2, 20 ose nga plotesimi i parakushtit nga neni 24 pa-ragrafi (6) të ketij ligji.

(5) Dispozitat e ketij ligji nuk prodhojne veprim juridik mbi transakcionet me letra me vlere, duke perfshire edhe ato të cilat jane konvertibile në letra tjera me vlere, të dedi-kuara për tregtim në treg, pervec në rast se bleresi dhe shi-tesi e kane ditur ose kane mundur të dine se transakcioni eshte kryer në kundersh-tim me paragrafin (1) të ketij neni.

### **Shqyrtimi i njoftimit**

#### **Neni 19**

(1) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences fillon shqyrtimin e njoftimit të koncentrimit me ditën e pranimit të tij, në pajtim me nenin 15 të ketij ligji dhe, nese:

1) konstaton se koncentrimi për të cilin eshte parashtru-ar njoftimi nuk bie nën dispozitat e ketij ligji, miraton akt-vendim se koncentrimi për të cilin eshte parashtruar njo-ftimi nuk bie nën dispozitat e ketij ligji;

2) konstaton se koncentrimi për të cilin eshte parashtru-ar njoftimi, edhe pse bie nën dispozitat e ketij ligji, nuk do të kete për pasoje prishjen e konsiderueshme të konkurren-ces efektive të tregut ose pjeses së tij thelbesore, vecane-riht si rezultat i krijimit ose perforcimit të pozites dominu-ese të pjesemarresve, miraton aktvendim me të cilin perca-hton se koncentrimi eshte në pajtim me dispozitat e ketij ligji dhe

3) konstaton se koncentrimi për të cilin eshte parashtru-ar njoftimi bie nën dispozitat e ketij ligji dhe për pasoje do të kete prishje të konsiderueshme të konkurrences efektive ose pjeses së tij thelbesore, vecanrisht si rezultat i krijimit ose perforcimit të pozites dominuese të pjesemarresve, Ko-misioni për Mbrojtjen e Konkurrences me konkluzion ngrite procedure. Kunder ketij konkluzioni nuk eshte e lejuar ankese, e as padi për ngritjen e kontestit administrativ. Në proceduren nga ky paragraf, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences mund të miratoje aktvendim në pajtim me nenin 20 të ketij ligji, pervec nese pjesemarresit deshmojne se kane hequr dore nga koncentrimi.

(2) Nese pjesemarresit në koncentrim, pas parashtrimit të njoftimit e ndryshojne të njejtin dhe Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences konstaton se pas ndryshimeve të kryera koncentrimi nuk do të kete për pasoje prishje të konsiderueshme të konkurrences efektive të tregut ose pje-ses së tij thelbesore, vecanrisht si rezultat i krijimit ose per-forcimit të pozites dominuese të pjesemarresve, miraton aktvendim në pajtim me paragrafin (1) pika 2 të ketij neni.

(3) Pas parashtrimit të njoftimit, pjesemarresit në kon-centrim mund të marrin obligime para Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences me qellim që të arrihet se kon-centrimi eshte në pajtim me dispozitat e ketij ligji. Komisi-oni për Mbrojtjen e Konkurrences në aktvendimin nga pa-ragrafi (1) pika 2 e ketij neni, i percakton kushtet dhe urd-heron detyrime me të cilat sigurohet se pjesemarresit do të veprojne në pajtim me obligimet e marra para Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences, e me qellim që të arrihet se koncentrimi eshte në pajtim me dispozitat e ketij ligji.

### **Vendimmarrja kur eshte ngritur procedura**

#### **Neni 20**

Në proceduren e ngritur në pajtim me nenin 19 paragra-fi (1) pika 3) e ketij ligji, nese:

1) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences konstaton se koncentrimi për të cilin eshte parashtruar njoftimi, nuk do të kete për pasoje prishjen e konsiderueshme të konkurren-ces efektive të tregut ose pjeses së tij thelbesore, vecan-riht si rezultat i krijimit ose perforcimit të pozites domi-nuese të pjesemarresve, miraton aktvendim me të cilin perca-hton se koncentrimi eshte në pajtim me dispozitat e ketij ligji;

2) pjesemarresit në koncentrik e ndryshojne të njejtin dhe Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences konstaton se pas ndryshimeve të kryera koncentrimi nuk do të kete për pasoje prishje të konsiderueshme të konkurrences efektive të tregut ose pjeses së tij thelbesore, vecanrisht si rezultat i krijimit ose perforcimit të pozites dominuese të pjesemar-resve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences miraton aktvendim me të cilin percakton se koncentrimi eshte në pajtim me dispozitat e ketij ligji;

3) pjesemarresit në koncentrim mund të marrin obligime para Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences me qëllim që të arrihet se koncentrimi është në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences në aktvendimin nga paragrafi (1) pika 1) e këtij neni percakton kushte dhe urdheron obligime me të cilat sigurohet se pjesemarresit do të veprojnë në pajtim me obligimet e marra para Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences, e me qëllim të arrihet se koncentrimi është në pajtim me dispozitat e këtij ligjim dhe

4) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences konstaton se koncentrimi për të cilin është parashtruar njoftimi ka për pasojë prishjen e konsiderueshme të konkurrences efektive të tregut ose pjeses së tij thelbësore, vecanerisht si rezultat i krijimit ose perforcimit të pozites dominuese të pjesemarresve, miraton aktvendim me të cilin percakton se koncentrimi nuk është në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

### Anulimi i aktvendimit

#### Neni 21

(1) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences me aktvendim mund ta anulojë aktvendimin me të cilin ka konstatuar se koncentrimi është në pajtim me dispozitat e këtij ligji në rastet kur:

1) aktvendimi është miratuar në baze të të dhënave të pasakta dhe/ose jo të plota për të cilat është përgjegjës njeri nga pjesemarresit në koncentrim ose të njëjtet janë fituar nepermjet mashtrimit, e kanë pasur ndikim vendimmarres mbi miratimin e aktvendimit ose

2) pjesemarresit nuk plotesojnë ndonjë nga obligimet e urdheruara në aktvendim.

(2) Me aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences:

1) e anulon aktvendimin me të cilin ka konstatuar se koncentrimi është në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

2) konstaton se koncentrimi nuk është në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe

3) nese është e nevojshme, urdheron masa dhe obligime për vendosje të serishme të konkurrences efektive të tregut relevant.

(3) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences mund të miratojë aktvendim në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, pa u kufizuar me këte rast me afatet e percaktuara me nenin 24 paragrafet (1), (2) dhe (3) të këtij ligji.

(4) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences për aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni pa prolongim i njofton pjesemarresit.

### Masat pas realizimit të koncentrimit i cili nuk është në pajtim me dispozitat e këtij ligji

#### Neni 22

(1) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences me aktvendim mund të urdherojë masa të sjelljes dhe masa strukturore të nevojshme për vendosje të serishme të konkurrences efektive të tregut relevant, si dhe të caktojë afate për zbatimin e tyre në rastet kur:

1) koncentrimi është realizuar pa parashtrimin e njoftimit nga neni 15 i këtij ligji ose

2) koncentrimi është realizuar në kundërshtim me aktvendimin e Komisionit me të cilin percaktohet se i njëjti nuk është në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Me aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences vecanerisht mund të:

1) urdherojë shitjen ose bartjen e aksioneve të fituara ose pjesemarrjeve dhe

2) ndalojë ose të kufizojë realizimin e të drejtës së votës lidhur me aksionet ose pjesemarrjet e pjesemarresve në koncentrim, të urdherojë pushim të ekzistimit të investimit të përbashkët (joint venture) ose të formave të tjera të arritjes së të drejtës së kontrollit sipas nenit 12 të këtij ligji.

### Masa të perkohshme

#### Neni 23

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences me aktvendim mund të urdherojë masa të perkohshme për vendosjen të serishme ose mbajtjen e konkurrences efektive, kur koncentrimi:

1) është kryer në kundërshtim me nenin 18 të këtij ligji, e akoma nuk është miratuar aktvendim me të cilin konstatohet nese koncentrimi është në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

2) është kryer në kundërshtim me kushtet e percaktuara dhe obligimet e urdheruara me aktvendimin nga neni 19 paragrafi (3) ose neni 20 paragrafi (1) pika 3 e këtij ligji dhe

3) tanime është i kryer dhe është konstatuar se i njëjti nuk është në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

### Afatet për ngritjen e procedurës dhe marrjen e vendimeve

#### Neni 24

(1) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences është i obliguar që në afat prej 25 diteve të punës nga dita e pranimit të njoftimit të rregullt të miratojë aktvendim në pajtim me nenin 19 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij ligji ose me konkluzion të ngrite procedure në pajtim me nenin 19 paragrafi (1) pika 3 të këtij ligji.

(2) Afati nga paragrafi (1) i këtij neni vazhdohet deri në 35 dite të punës, nese pjesemarresit në koncentrim marrin obligime para Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences me qëllim që të arrihet se koncentrimi është në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(3) Aktvendimet nga neni 20 paragrafi (1) i këtij ligji miratohen në afat prej 90 diteve të punës nga dita e ngritjes së procedurës.

(4) Në çdo kohe pas ngritjes së procedurës, afatet nga paragrafet (1), (2) dhe (3) të këtij neni mund të vazhdojnë nga ana e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences në marreveshje me pjesemarresit në koncentrim.

(5) Kohezgjatja e pergjithshme e çdo vazhdimi ose vazhdimëve nuk mund të tejkalojë 20 dite të punës.

(6) Nese Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences nuk ka miratuar aktvendim në afatet e percaktuara në këte nen, konsiderohet se koncentrimi është në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(7) Me perjashtim, afatet nga paragrafet (1), (2) dhe (3) të këtij neni nuk e obligojnë Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrences kur, si rezultat i sjelljes së njerit prej pjesemarresve në koncentrim, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences doemos është dashur me detyrë zyrtare të kërkojë të dhena nga neni 49 i këtij ligji ose t'i kryejë veprimet nga neni 50 i këtij ligji.

### Kufizimet e domosdoshme

#### Neni 25

Aktvendimi me të cilin Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences konstaton se koncentrimi është në pajtim me dispozitat e këtij ligji, konsiderohet se i perfshinë edhe kufizimet e lidhura drejtpërdrejt dhe të domosdoshme për realizimin e koncentrimin.

#### PJESA E TRETË

#### ORGANI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCES

### Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences

#### Neni 26

(1) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences është organ i pavarur shtetëror me çilesi të personit juridik.

(2) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences është i përbërë nga Kryetari, katër anëtarë dhe shërbimi profesional.

(3) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences është i pavarur në punën e tij edhe në marrjen e vendimeve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj.

(4) Mjetet për punë të Komisionit sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(5) Selia e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences është në Shkup.

(6) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrences për punën e tij përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe më së voni deri më 31 mars të Kuvendi i Republikës së Maqedonisë parashtron raport vjetor për punën e tij.

### **Emerimi dhe shkarkimi i kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences**

#### **Neni 27**

(1) Me propozim të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emerimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, kryetarin dhe anëtarët e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences i emeron dhe i shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, për periudhë prej pesë vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.

(2) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë gjatë emerimit të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences duhet ta ketë parasysh përfaqësimin e drejtë dhe perkates të përfaqësuesve të të gjitha bashkësive.

(3) Pas skadimit të mandatit nga paragrafi (1) i këtij neni, e deri në emerimin e Kryetarit të ri dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences, Kryetari dhe anëtarët e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences nga paragrafi (1) i këtij neni vazhdojnë punën dhe vendimmarrjen.

(4) Kryetari dhe dy anëtarë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences janë të angazhuar profesionalisht në punën e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences.

(5) Kryetari i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences e përfaqëson, e paraqet dhe udhëheqë me punën e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences.

(6) Si kryetar dhe anëtar i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences mund të emërohet personi i cili është shtetas i Republikës së Maqedonisë, me arsimim të lartë të kryer – fakultet juridik ose ekonomik, me përvojë pune mbi pesë vjet në profesion dhe njohuri të vecanta nga sfera e konkurrencës, e drejta tregtare, menaxhmenti dhe financat. Kryetari ose njeri nga anëtarët e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences të cilët janë të angazhuar profesionalisht në punën e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences doemos duhet të jetë jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës dhe përvojë pune në profesion së paku pesë vjet pas dhenies së provimit të jurisprudencës.

(7) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences, gjatë kohezgjatjes së mandatit të tyre, nuk mund të jenë deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, anëtarë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, persona të cilët kryejnë detyra në organet e partive politike, anëtarë të organeve të udhëheqjes në ndërmarrje ose të jenë anëtarë të çdo forme tjetër të bashkimit të personave juridike ose fizike, që do të mund të çonin në konflikt të interesave.

(8) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences nuk guxojnë të vendosin për ndërmarrjet me të cilat, ata, bashkëshortët e tyre ose anëtarët e tyre të familjes në shkallë të parë të fafëfisnise janë aksionarë ose anëtarë të organeve të udhëheqjes në ndërmarrjet që janë pjesëmarrëse në procedurën e cila udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(9) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e shkarkon nga detyra Kryetarin ose anëtarin e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences para skadimit të mandatit me propozim të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emerimeve, nëse:

1) ketë e kërkon ai vetë dhe

2) tri herë radhazi nuk merr pjesë në mbledhjet e Komisionit për Mbrojtjen e konkurrencës, e nuk e arsyeton mungesën.

(10) Përbushjen e kushteve për shkarkim nga paragrafi (8) i këtij neni, i përcakton Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve dhe parashtron kerkese për shkarkim të Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

### **Kompetencat e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences**

#### **Neni 28**

(1) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës e kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji, Ligjin për ndihme shtetërore dhe rregullat e miratuara në bazë të këtyre ligjeve, i ndjeko dhe i analizon gjendjet në treg deri në shkallën e nevojshme për zhvillimin e konkurrencës së lire dhe efikasë, udhëheqë procedurën administrative dhe merr vendime në procedurën administrative në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe Ligjit për ndihme shtetërore.

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj, organ kompetent për kundërvajtje është Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës.

(3) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës përcakton rregulla dhe masa për mbrojtjen e konkurrencës dhe masa për vendosjen e konkurrencës efektive.

(4) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës jep mendime për propozim-ligjet dhe aktet tjera me të cilat rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetin ekonomik, e që mund të kenë ndikim mbi konkurrencën e tregut dhe në formë të shkruar e dorezon te organi kompetent. Organi e njofton Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës për shkaqet për të cilat nuk e ka pranuar mendimin e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

(5) Me kerkese të Kuvendit, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, organeve tjera shtetërore, ndërmarrjeve ose me detyrë zyrtare, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës jep mendime profesionale për çështjet nga sfera e politikës konkurruese, mbrojtja e konkurrencës në treg dhe ndarja e ndihmes shtetërore.

(6) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës gjatë kryerjes së kompetencave të tij bashkepunon me organe shtetërore dhe trupa për çështje të cilat lidhen me mbrojtjen e konkurrencës. Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe organet shtetërore dhe trupat janë të obliguar të shkëmbejnë të dhëna dhe informata që u janë të nevojshme për kryerjen e kompetencave të tyre, vëllimi i shkëmbimit të informatave i të cilave është i kufizuar në të dhëna dhe informata që janë të pershtatshme dhe proporcionale me qëllimet për të cilat shkëmbehen.

(7) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës i kryen punët e bashkepunimit nderkombetar lidhur me realizimin e obligimeve nderkombetare të Republikës së Maqedonisë, të bartura në kompetencë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, merr pjesë në realizimin e projekteve të organeve nderkombetare dhe organeve të Unionit Evropian dhe bashkepunon me organet e vendeve të tjera dhe institucionet nga sfera e konkurrencës.

(8) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës me statut dhe me akte tjera të përgjithshme i rregullon çështjet e menyres së punës dhe të organizimit.

(9) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës kryen edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj ose me ligj tjetër.

(10) Vendimet e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës në procedurën administrative dhe vendimet që kanë të bëjnë me punën rrjedhese të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, i miratojnë Kryetari dhe katër anëtarë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës në mbledhje, me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve. Anëtarin e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk mund të abstenojë nga votimi.

## Sherbimi profesional

Neni 29

(1) Punet profesionale, normative-juridike, administrative, administrative-mbiqueqyrese, materiale-financiare, kontabiliste, informatike dhe punet tjera të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences dhe Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje, i kryen sherbimi profesional, me të cilin udheheq sekretari i pergjithshem, të cilin e emerone Kryetari i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences.

(2) Të punesuarit në sherbimin profesional e kane statusin e nepunesve shtetore.

(3) Në kryerjen e puneve profesionale, normative-juridike, administrative, administrative-mbiqueqyrese, materiale-financiare, kontabiliste, informatike dhe puneve tjera, sherbimi profesional:

1) siguron të dhena, kryen kontroll dhe analize të të dhënave të siguruar për lende të vecanta dhe për kete e njofton Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrences dhe/ose Komisionin për Vendimmarrje për Kundervajtje;

2) pergatit propozime të akteve nenligjore të percaktuara me dispozitat e ketij ligji dhe Ligjit për ndihme shtetore;

3) pergatit propozim të mendimeve për propozim-ligjet dhe aktet tjera me të cilat rregullohen ceshtjet që kane të bejne me aktivitetin ekonomik, e që mund të kene ndikim në konkurrencen e tregut;

4) pergatit propozim të mendimeve profesionale për ceshtjet nga sfera e politikës konkurruese, mbrojtjes së konkurrences së tregut dhe ndarjes së ndihmes shtetore;

5) siguron të dhena dhe informata nga ndermarrjet që jane të rendesishme për hulumtimin dhe percaktimin e gjendjeve të tregut, pavaresisht nga procedurat konkurruese të cilat udhehiqen para Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences dhe/ose Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje;

6) pergatit propozim të raportit vjetor për punen e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences dhe

7) kryen edhe pune tjera me kerkese të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences dhe Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje në zbatimin e dispozitave të ketij ligji dhe Ligjit për ndihme shtetore.

(4) Në rastet nga paragrafi (3) pika 5 e ketij ligji, konkuzionet për kryerjen e veprimeve nga nenet 48, 49 dhe 50 të ketij ligji i miraton Sekretari i pergjithshem i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences.

## PJESA E KATERT

### PROCEDURAT PARA KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCES

#### Kapitulli pare

#### PROCEDURA PËR KUNDERVAJTJE

#### Kompetenca për kundervajtje

Neni 30

(1) Për kundervajtjet e percaktuara në kete ligj, procedure për kundervajtje para Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences udheheq dhe sanksion për kundervajtje shqipton Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje.

(2) Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje eshte i perbere nga Kryetari dhe dy anetare të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences të cilet jane të angazhuar profesionalisht në punen e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences.

(3) Kryetar i Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje eshte Kryetari ose njeri nga dy anetaret e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences të cilet jane të angazhuar profesionalisht në punen e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences dhe i njeiti detyrimisht të jete jurist i diplomuar me provim të dhene të jurisprudences dhe pervoje në profesion prej së paku pese vjete pas dhenies së provimit të jurisprudences.

(4) Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje punon dhe vendos në mbledhje, me shumice të votave nga numri i pergjithshem i anetareve. Anetari i Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje nuk mund të abstenoje nga votimi.

#### Zbatimi i ligjit

Neni 31

Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje gjate udheheqjes së procedures për kundervajtje në menyre perkatese i zbaton dispozitat nga Ligji për procedure të pergjithshme administrative, pervec nese me Ligjin për kundervajtje dhe me kete ligj nuk eshte percaktuar ndryshe.

#### Ngritja e procedures për kundervajtje

Neni 32

(1) Procedura për kundervajtje para Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje ngritet me detyre zyrtare, me kerkese të sekretarit të pergjithshem të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences ose me kerkese të personit fizik ose juridik i cili ka interes legjitim për percaktimin e ekzistimit të kundervajtjes.

(2) Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje e ngrite proceduren për kundervajtje me konkluzion, kunder të cilit nuk lejohet ankese, e as padi për ngritjen e kontestetit administrativ.

(3) Konkluzioni për ngritjen e procedures detyrimisht permban:

1) numrin e lendes me të cilen ka të beje konkluzioni;

2) dispozitat nga ligji në baze të të cilave ngritet procedura;

3) pershkrimin e fakteve dhe rrethanave për shkak të të cilave Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje ngrite procedure dhe

4) kerkesen për dorezimim e të dhënave të nevojshme, në pajtim me nenin 40 të ketij ligji.

(4) Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje detyrimisht ngrite procedure, nese konstaton se eshte e mundur paraqitja e prishjes së konsiderueshme të konkurrences.

(5) Konkluzioni për ngritjen e procedures dorezohet te personi kunder të cilit eshte ngritur procedura dhe te parashtruesi i kerkeses, nese procedura eshte ngritur me kerkese të personit fizik ose juridik i cili ka interes legjitim për percaktimin e ekzistimit të kundervajtjes.

(6) Personi kunder të cilit eshte ngritur procedure ka të drejte të jape pergjigje në afat prej tete ditesh nga dita e pranimit të konkluzionit për ngritjen e procedures. Me perjashtim, me kerkese të personit kunder të cilit eshte ngritur procedura, afati mund të vazhdohet edhe për më së shumti 15 dite, nese për kete ekzistojne shkaqe të arsyeshme.

(7) Procedura për kundervajtje e ngritur para Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje nuk eshte urgjente.

#### Ngritja e procedures për kundervajtje me kerkese të sekretarit të pergjithshem të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences

Neni 33

(1) Kerkesa për ngritjen e procedures për kundervajtje e parashtruar nga sekretari i pergjithshem i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences permban:

1) bazen juridike për parashtrimin e kerkeses;

2) të dhenat për personin kunder të cilit parashtrohet kërkesa;

3) pershkrimin faktik të kundervajtjes nga i cili dalin karakteristikat juridike të kundervajtjes, koha, vendi dhe menyra e kryerjes dhe rrethanat tjera të nevojshme që më afersisht të percaktohet kundervajtja;

4) deshmite që duhet të nxirren dhe

5) nenshkrimin e sekretarit të pergjithshem të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

(2) Kërkeses i bashkengjiten deshmite.

### **Permbajtja e kërkeses për ngritjen e procedurës për kundervajtje me kërkesë të personit fizik ose juridik**

#### **Neni 34**

(1) Kërkesa për ngritjen e procedurës për kundervajtje me kërkesë të personit fizik ose juridik i cili ka interes legjitim për percaktimin e ekzistimit të kundervajtjes detyrimisht përmban:

1) firmen dhe seline e personit juridik, perkatesisht emrin, mbiemrin dhe adresen e personit fizik - parashtrues i kërkeses dhe pershkrimin e rrethanave nga të cilat del interesi legjitim për parashtrimin e kërkeses;

2) të dhenat për personin kunder të cilit parashtrohet kërkesa;

3) pershkrimin faktik të kundervajtjes nga i cili dalin karakteristikat juridike të kundervajtjes, koha, vendi dhe menyra e kryerjes dhe rrethanat tjera të nevojshme që më afersisht të percaktohet kundervajtja;

4) deshmite që duhet të nxirren dhe

5) nenshkrimin e parashtruesit të kërkeses.

(2) Kërkeses i bashkengjiten deshmite.

(3) Nese kërkesa nga paragrafi (1) i ketij neni përmban të dhena të cilat sipas parashtruesit paraqesin fshehtësi afariste, i njejtë është i detyruar që të dhenat e tilla qartesisht t'i shenojë dhe ta percaktojë bazen juridike për shenimin e tyre si fshehtësi afariste.

(4) Gjate parashtrimin të kërkeses për ngritjen e procedurës për kundervajtje e cila përmban të dhena që paraqesin fshehtësi afariste, në menyre perkatese zbatohen dispozitat nga neni 40 paragrafet (4), (5) dhe (6) të ketij ligji.

(5) Nese parashtruesi i kërkeses nga paragrafi (1) i ketij neni deshiron të mbetet anonim ose është parashtruar kërkesë e cila nuk i përmban të dhenat për parashtruesin, Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje udheheq procedure me detyrë zyrtare, nese është permbushur kushti nga neni 32 paragrafi (4) të ketij ligji.

### **Plotesimi i kërkeses për ngritjen e procedurës për kundervajtje të parashtruar nga personi fizik ose juridik**

#### **Neni 35**

(1) Nese kërkesa për ngritjen e procedurës për kundervajtje nuk i përmban të dhenat nga neni 34 i ketij ligji, Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje nga parashtruesi do të kerkojë plotesimin e kërkeses.

(2) Nese parashtruesi i kërkeses nuk vepron në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkeses për plotesim, konsiderohet se ka hequr dore nga kërkesa.

### **Heqja dore nga kërkesa për ngritjen e procedurës për kundervajtje të parashtruar nga personi fizik ose juridik**

#### **Neni 36**

(1) Nese procedura është ngritur me kërkesë të personit fizik ose juridik, i njejtë mund të heq dore nga kërkesa gjate te procedure.

(2) Kur procedura është e ngritur me kërkesë të personit fizik ose juridik, dhe i njejtë heq dore nga kërkesa, Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje miraton konkluzion me të cilin nderpritet procedura.

(3) Nese udheheqja e metejme e procedurës është e nevojshme për interesin publik, perkatesisht nese Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje vlereson se janë permbushur kushtet nga neni 32 paragrafi (4) i ketij ligji. Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje e vazhdon udheheqjen e procedurës.

(4) Kur procedura është e ngritur me detyrë zyrtare, Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje me konkluzion mund ta nderprese proceduren.

(5) Kunder konkluzionit për nderperjen e procedurës nga paragrafet (2) dhe (4) i ketij neni mund të parashtrohet ankese. Kunder konkluzionit mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykates kompetente për vendimmarrje për kontest administrativ në afat prej tete ditësh nga dita e pranimit të konkluzionit.

### **Refuzimi i kërkeses për ngritje të procedurës për kundervajtje të parashtruar nga personi fizik ose juridik**

#### **Neni 37**

(1) Nese Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje konstaton se nuk ekzistojne kushte ligjore për ngritjen e procedurës, kërkesen nga neni 34 nga ky ligj do ta refuzojë me konkluzion.

(2) Nuk ekzistojne kushte ligjore për ngritje të procedurës, nese:

1) veprimi i pershkruar në kërkesë nuk është kundervajtje

2) kërkesen e ka parashtruar personi i cili nuk ka interes legjitim për percaktimin e kundervajtjes;

3) kërkesa nuk është e mbeshetur me prova;

4) nese ka ndodhur parashkrimi i ndjekjes për kundervajtje;

5) sjellja që është lende e kërkeses nuk çon në prishje të konsiderueshme të konkurrencës dhe

6) nese nuk ekziston interes publik për udheheqjen e procedurës për kundervajtje.

(3) Kunder konkluzionit për refuzimin e kërkeses nga paragrafi (1) i ketij neni nuk mund të parashtrohet ankese. Kunder konkluzionit të tille mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykates kompetente për vendimmarrje për kontest administrativ në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të konkluzionit.

(4) Konkluzioni nga paragrafi (1) i ketij neni, nuk duhet doemos të përmbajë vleresim të çdo prove të përmbajtur në kërkesen për ngritjen e procedurës, por doemos duhet të përmbajë arsye të theksuara qartesisht për refuzimin e kërkeses.

### **Pjesemarrësit në proceduren për kundervajtje**

#### **Neni 38**

Pjesemarrës në proceduren për kundervajtje janë:

- personi kunder të cilit është ngritur procedure për kundervajtje dhe

- parashtruesi i kërkeses për ngritjen e procedurës për kundervajtje nga neni 34 i ketij ligji.

### **Bashkimi dhe ndarja e procedurës**

#### **Neni 39**

(1) Nese personi juridik ose fizik me një veprim ose më shume veprime kryen më shume kundervajtje të percaktuara me kete ligj, e për të cilat nuk është miratuar aktvendim, Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje sipas rregulles zbaton procedure unike dhe miraton aktvendim unik për kundervajtje.

(2) Deri në miratimin e aktvendimit për kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni, për shkaqe të arsyeshme ose për shkak të perputhshmerise, Komisioni për Vendimmarr-

je për Kundervajtje mund të vendose që procedura për kundervajtje të vecanta ose kunder personave të vecante juridike ose fizike të ndahet nga procedura unike dhe të perfundojë në menyre të vecante.

(3) Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje miraton konkluzion për bashkim, perkatesisht ndarje të procedurës, kunder të cilit nuk lejohet ankese, as padi për ngritje të kontestit administrativ.

## Procedura e deshmive

### Kerkimi i të dhenave

#### Neni 40

(1) Për kryerjen e autorizimeve të percaktuara me kete ligj, Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje mund të kerkojë me konkluzion nga ndermarrjet të dorezohen të dhena lidhur me gjendjen e tyre financiare-ekonomike, marredheniet e tyre afariste dhe lidhjet, të dhena për statutet dhe vendimet e tyre, për numrin dhe identitetin e personave të prekur me vendimet e tilla, si dhe të dhena tjera të nevojshme për udheheqjen e procedurës.

(2) Konkluzioni për kerkimin e të dhenave i permban bazen juridike, qellimin e kerkeses, shenimin e sakte të të dhenave që kerkohen, afatin për dorezimin e të dhenave të kerkuara, si dhe atë se mosdorezimi i të dhenave në afatin e kerkuar, dorezimi i të dhenave të pasakta, të paplota ose i të dhenave që mund ta cojnë në huti Komisionin për Vendimmarrje për Kundervajtje, paraqet kundervajtje në pajtim me nenin 61 të ketij ligji.

(3) Kunder konkluzionit nga paragrafi (1) i ketij neni nuk lejohet ankese, e as padi për ngritjen e kontestit administrativ.

(4) Nese disa nga të dhenat nga paragrafi (1) i ketij neni paraqesin fshehtesi afariste, ndermarrjet jane të obliguara që ato t'i shenojnë qartesisht dhe ta percaktojnë bazen juridike për shenimin e tyre si fshehtesi afariste.

(5) Gjate dorezimit të të dhenave të cilat paraqesin fshehtesi afariste, ndermarrjet nga paragrafi (1) i ketij neni jane të obliguara që te Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje të dorezohen një ekzemplar me të dhena të perfshira që paraqesin fshehtesi afariste (version sekret) dhe një ekzemplar në të cilin do të shlyhen të dhenat që paraqesin fshehtesi afariste (version josekret).

(6) Nese ndermarrjet nga paragrafi (1) i ketij neni nuk veprojnë në pajtim me paragrafin (5) të ketij neni dhe dorezohen vetem version sekret të të dhenave të kerkuara, me shenimin e të dhenave që paraqesin fshehtesi afariste, Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje do të kerkojë dorezimin edhe të versionit josekret të të dhenave të kerkuara në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kerkeses. Nese ndermarrjet edhe në atë afat nuk dorezohen version sekret të të dhenave të kerkuara, Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje do të konsiderojë se të dhenat e dorezuara nuk permbajne të dhena që paraqesin fshehtesi afariste.

### Sigurimi i deshmive aty për aty

#### Neni 41

(1) Nese ekziston dyshim i arsyeshem se ndermarrja e caktuar posedon dokumente ose lende tjera ose ka njohuri të cilat mund të jene me rendesi që të vertetohet ekzistimi i kundervajtjes, Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje me konkluzion mund t'i urdherojë asaj ndermarrjeje, personave të autorizuar nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe personave që sipas nevojës i shoqerojnë:

1) t'u mundesoje papenguar të hyjnë në cilatdo lokale afariste, toke ose mjete transportuese të ndermarrjes nga paragrafi (1) i ketij neni që jane me rendesi për percaktimin e ekzistimit të kundervajtjes;

2) t'u mundesoje papenguar t'i shqyrtojnë librat ose dokumentacionin tjetër që jane me rendesi për percaktimin e ekzistimit të kundervajtjes, pa marre parasysh mediumin në të cilin ruhet i njejt;

3) t'u mundesoje papenguar të marrin ose të mbajne në cfaredo forme kopje ose ekstrakte nga ato libra apo dokumentacion;

4) t'u mundesoje papenguar perkohesisht t'i marrin dhe mbajne librat ose dokumentacionin tjetër që jane me rendesi për percaktimin e ekzistimit të kundervajtjes për periudhen e nevojshme për kopjimin e të njejteve, nese kopjimi i tyre nuk mund të kryhet aty për aty. Për konfiskimin dhe mbajtjen e ketille, personat e autorizuar të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës japin vertetim me shkrim në të cilin pershkruhen librat dhe dokumentacioni tjetër i konfiskuar dhe percaktohet ku jane gjetur;

5) t'u mundesoje perkohesisht të marrin dhe mbajne lende, libra ose dokumentacion tjetër që jane me rendesi për percaktimin e ekzistimit të kundervajtjes për periudhen e nevojshme për percaktimin e fakteve dhe deshmive relevante që dalin nga ato lende, libra dhe dokumentacion, por jo më gjate se perfundimi i plotfuqishem i procedurës lendore. Për konfiskimin dhe mbajtjen e ketille, personat e autorizuar të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës japin vertetim me shkrim në të cilin pershkruhen lendet, librat dhe dokumentacioni tjetër i konfiskuar dhe percaktohet ku jane gjetur;

6) t'u mundesoje papenguar t'i vulosin lokalet afariste dhe librat ose dokumentacionin tjetër për periudhe dhe në vellim të nevojshem për shqyrtimin, por jo më gjate se shtate dite;

7) personi i autorizuar ose i punesuari tjetër në ndermarrje të jape në procesverbal sqarim për faktet ose dokumentet që jane me rendesi për percaktimin e ekzistimit të kundervajtjes;

8) personi i autorizuar ose i punesuari tjetër në ndermarrje të dorezoje sqarim me shkrim për faktet ose dokumentet që jane me rendesi për percaktimin e ekzistimit të kundervajtjes dhe

9) t'u mundesoje kryerje të papenguar të veprimeve tjera që jane me rendesi për percaktimin e ekzistimit të kundervajtjes.

(2) Konkluzioni nga paragrafi (1) i ketij neni i permban bazen juridike, lenden dhe qellimin e veprimit, emrin dhe mbiemrin e personave të autorizuar nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës që do t'i kryejne veprimet nga paragrafi (1) i ketij neni, kohen dhe vendin e kryerjes së veprimeve nga paragrafi (1) i ketij neni, si dhe atë se pamundesia e personave të autorizuar të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës t'i kryejne veprimet nga paragrafi (1) i ketij neni, paraqet kundervajtje në pajtim me nenin 61 të ketij ligji.

(3) Kunder aktvendimit nga paragrafi (1) i ketij neni nuk lejohet ankese, e as padi për ngritjen e kontestit administrativ.

(4) Nese disa nga të dhenat dhe dokumentacioni nga paragrafi (1) i ketij neni të marra ose të mbajtura nga personat e autorizuar të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës paraqesin fshehtesi afariste ose zyrtare, ndermarrja nga paragrafi (1) i ketij neni mud në afat prej tete ditësh nga dita e kryerjes së veprimeve nga paragrafi (1) i ketij neni, të kryejne inspektim në të dhenat dhe dokumentacionin e marre ose të mbajtur, t'i shenoje qartesisht të dhenat dhe dokumentacionin që paraqesin fshehtesi afariste dhe ta percaktoje bazen juridike për shenimin e tyre si të tilla.

(5) Nese ndermarrja nga paragrafi (1) i ketij neni nuk veprom në pajtim me paragrafin (4) të ketij neni, konsiderohet se të dhenat dhe dokumentacioni i siguruar nuk permbajne të dhena që paraqesin fshehtesi afariste.

(6) Gjate kryerjes së veprimeve nga paragrafi (1) i ketij neni, personat e autorizuar të Komisionit mbajne procesverbal për veprimet e ndermarrja.

(7) Nese gjate kryerjes së veprimeve nga paragrafi (1) i ketij neni ekziston rreziku nga fshehja, ndryshimi ose asgjесimi i dokumenteve ose lendeve që mund të jene me rendesi për percaktimin e ekzistimit të kundervajtjes, gjate kryerjes së veprimeve nga paragrafi (1) i ketij neni, Komisioni për Mbrojtjen e konkurrences do të kerkoje ndihme nga organi i administrates shtetore kompetent për kryerjen e puneve të rendit dhe qetesise publike.

(8) Nese ndermarrja nga paragrafi (1) i ketij neni nuk u lejon personave të autorizuar të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences që t'i kryejne veprimet nga paragrafi (1) i ketij neni, personat e autorizuar të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences do t'i kryejne veprimet e nevojshme edhe kunder vullnetit të ndermarrjes nga paragrafi (1) i ketij neni, e me ndihmen e perfaqesuesve të organit të administrates shtetore kompetent për kryerjen e puneve të rendit dhe qetesise publike.

### Njoftimi për gjendjen e percaktuar faktike

#### Neni 42

(1) Me qellim që pjesemarresve në procedure t'u jepet mundesi të deklarohen për faktet dhe rrethanat me rendesi për percaktimin e gjendjes faktike, Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje, para caktimit të debatit me goje, pjesemarresve u dorezon njoftim preliminar për gjendjen e percaktuar faktike të deriatehershme.

(2) Pjesemarresit në procedure kane të drejte që të deklarohen me shkrim për provat e permbajtura në njoftimin nga paragrafi (1) i ketij neni, të japin verejtje dhe të propozojne nxjerrje të deshmive me të cilat disponojne, q të cilat sipas tyre jane me rendesi për percaktimin e drejte të gjendjes faktike, në afat prej 15 ditesh nga dita e pranimit të njoftimit.

(3) Para miratimit të vendimit perfundimtar në procedure, Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje pjesemarresve në proceduren u dorezon njoftim perfundimtar për gjendjen e percaktuar faktike.

(4) Nese nga faktet dhe rrethanat e percaktuara gjate procedures del se eshte kryer kundervajtje e parapare me dispozitat e ketij ligji, njoftimi perfundimtar për gjendjen e percaktuar faktike nga paragrafi (3) i ketij neni permban edhe njoftim për llojin dhe shumen e sanksionit për kundervajtje i cili do të shqiptohet, si dhe sqarimin e rrethanave të marra parasysh gjate percaktimit të tij.

(5) Pjesemarresit në procedure kane të drejte që të deklarohen me shkrim për provat e permbajtura në njoftimin nga paragrafi (3) i ketij neni, në afat prej 8 ditesh nga dita e pranimit të njoftimit. Pjesemarresit në procedure kane të drejte të propozojne nxjerrje të deshimve të reja, vetem nese nuk kane disponuar me të njejtat në momentin e deklarimit nga paragrafi (2) i ketij neni.

### Marrja e obligimeve

#### Neni 43

(1) Pas ngritjes së procedures nga neni 32 i ketij ligji, e më së voni deri në dorezimin e njoftimit perfundimtar për gjendjen e percaktuar faktike, personi kunder të cilit eshte ngritur procedura Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje mund t'i ofroje në afat të caktuar marrje të obligimeve me të cilat do të tejkalohet prishja e konkurrences së shkaktuar me veprime ose leshim të veprimeve nga ana e personit kunder të cilit eshte ngritur proceduara.

(2) Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje me konkluzion nuk do t'i pranoje obligimet e ofruara nga paragrafi (1) i ketij neni në rast të prishjes së konsiderueshme të konkurrences. Kunder ketij konkluzioni nuk lejohet ankese, e as padi për ngritjen e kontestet administrativ.

(3) Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje me konkluzion i pranon obligimet e ofruara nga paragrafi (1) i ketij neni, nese të njejtat jane të mjaftueshme për tejkalimin e prishjes së konkurrences të shkaktuar me veprime

ose leshim të veprimeve nga ana e personit kunder të cilit eshte ngritur procedura. Konkluzioni me të cilin pranohen obligimet e ofruara permban pershkrimin e obligimeve, afatin në të cilin të njejtat duhet të permbushen dhe obligimin e personit kunder të cilit eshte ngritur procedura të bashkangjite deshmi se obligimet jane permbushur. Kunder ketij konkluzioni nuk lejohet ankese, e as padi për ngritjen e kontestet administrativ.

(4) Para se të vendose për pranimin, perkatesisht mospranimin e obligimeve të ofruara, Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje publikon pershkrim të shkurter të lendes dhe obligimeve të ofruara në ueb faqen e Komisionit. Të gjithе personat e interesuar kane të drejte që te Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje të paraqesin komente dhe verejtje me shkrim në afat prej 15 ditesh nga dita e p[ublikimit.

(5) Nese jane ofruar obligimet nga paragrafi (1) i ketij neni, procedura para Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje pushon deri në skadimin i afatit të percaktuar në konkluzionin nga paragrafi (3) i ketij neni. Nese pas skadimit të atij afati nuk dorezohen deshmi se obligimet jane permbushur, procedura para Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje vazhdon.

(6) Nese Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje percakton se nuk ekzistojne kushte ligjore për udheheqjen e procedures për permbushjen e obligimeve të marra nga paragrafi (1) i ketij neni, e nderpret proceduren me konkluzion kunder të cilit nuk lejohet ankese. Kunder ketij konkluzioni mund të parashtrohet ankese për ngritjen e kontest administrativ para gjykates kompetente në afat prej tete ditesh nga dita e pranimit të konkluzionit.

### Debatit me goje

#### Neni 44

(1) Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje do të caktojе mbajtje të debatit me goje, nese kjo eshte e nevojshme për percaktimin e gjendjes faktike.

(2) Në debatin me goje thirren personi kunder të cilit eshte ngritur procedura dhe parashtruesi i kerkeses për ngritjen e procedures, nese procedura eshte ngritur me kerkesë të personit juridik ose fizik.

(3) Krahas personave nga paragrafi (2) i ketij neni, në debatin me goje mund të thirren edhe persona tjere.

### Aktvendime të Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje

#### Neni 45

Pasi Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje në teresi do ta percaktojе gjendjen faktike me rendesi për vendimmarrje të drejte, miraton:

1) aktvendim me të cilin percakton se personi kunder të cilit eshte ngritur procedura ka kryer kundervajtje të parapare me dispozitat e ketij ligji dhe shqipton sanksion për kundervajtje perkates ose

2) aktvendim me të cilin percakton se personi kunder të cilit eshte ngritur procedura nuk ka kryer kundervajtje të parapare me dispozitat e ketij ligji.

### Mbrojtja gjyqesore në proceduren për kundervajtje

#### Neni 46

(1) Aktvendimet e Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje jane perfundimtare. Kunder aktvendimeve të tilla mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestet administrativ para gjykates kompetente.

(2) Padia për ngritjen e kontestet administrativ nga paragrafi (1) i ketij neni parashtrohet në afat prej 8 ditesh nga dita e pranimit të aktvendimit dhe e njejta e prolongon zbatimin e aktvendimit.

**Kapitulli i dyte****PROCEDURA ADMINISTRATIVE****Zbatimi i Ligjit për procedure të përgjithshme administrative****Neni 47**

Në procedurat para Komisionit për Mbrojtje të Konkurrencës zbatohet Ligji për procedure të përgjithshme administrative, përveç nëse me këto ligj nuk është percaktuar ndryshe.

**Hulumtimi në sektore të vecante të ekonomisë dhe lloje të vecanta të marreveshjeve****Neni 48**

(1) Nëse ekzistojnë rrethana që tregojnë në mundësinë që konkurrenca të priset, Komisioni për Mbrojtje të Konkurrencës mund të realizojë hulumtim në sektor të caktuar të ekonomisë ose për lloj të caktuar të marreveshjeve në sektore të ndryshëm të ekonomisë.

(2) Gjate hulumtimit, Komisioni për Mbrojtjen e konkurrencës me konkluzion mund të kërkojë nga ndermarrjet që të dorëzojnë të dhëna lidhur me gjendjen e tyre financiare-ekonomike, marrëdhëniet e tyre afariste dhe lidhjet, të dhëna për statutet dhe vendimet e tyre, për numrin dhe identitetin e personave të prekur me vendimet e tilla, si dhe të dhëna të tjera me rëndësi për hulumtimin.

(3) Konkluzioni nga paragrafi (2) i këtij neni i përmban bazen juridike, qëllimin e kërkesës, shenimin e sakte të të dhënave që kërkojnë dhe afatin për dorëzimin e të dhënave të kërkuara, si dhe atë se mosdorëzimi i të dhënave në afatin e kërkuar, dorëzimi i të dhënave të pasakta, të paplota ose i të dhënave që mund ta çojnë në huti Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës, paraqet kundërvajtje në pajtim me nenin 61 të këtij ligji.

(4) Kunder konkluzionit nga paragrafi (2) i këtij neni nuk lejohet ankese, e as padi për ngritjen e kontestit administrativ.

(5) Sekretari i përgjithshëm i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të të dhënave të siguruar me hulumtimet nga paragrafi (1) i këtij neni mund të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje të Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje.

(6) Nëse disa nga të dhënat nga paragrafi (2) i këtij neni paraqesin fshehtësi afariste, ndermarrjet nga paragrafi (2) i këtij neni janë të obliguara që të njejtat t'i shenojnë qartësisht dhe ta percaktojnë bazen juridike për shenimin e tyre si fshehtësi afariste.

(7) Gjate dorëzimit të të dhënave të cilat paraqesin fshehtësi afariste ndermarrjet nga paragrafi (2) i këtij neni janë të obliguara që të Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës të dorëzojnë një ekzemplar me të dhëna të përfshira që paraqesin fshehtësi afariste (version sekret) dhe një ekzemplar në të cilin do të shlyhen të dhënat që paraqesin fshehtësi afariste (version josekret).

(8) Nëse ndermarrjet nga paragrafi (2) i këtij neni nuk veprojnë në pajtim me paragrafin (7) të këtij neni dhe e dorëzojnë vetëm versionin sekret të të dhënave të kërkuara, me shenimin e të dhënave të cilat paraqesin fshehtësi afariste, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës do të kërkojë dorëzimin edhe të versionit josekret të të dhënave të kërkuara, në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të të dhënave. Nëse ndermarrjet në atë afat nuk e dorëzojnë versionin e josekret të të dhënave të kërkuara, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës do të konsideron se të dhënat e dorëzuara nuk përmbajnë të dhëna që paraqesin fshehtësi afariste.

**Kerkimi i të dhënave****Neni 49**

(1) Gjate kryerjes së autorizimeve të percaktuara me këto ligj, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës me konkluzion mund të kërkojë nga ndermarrjet të dorëzojnë të dhëna lidhur me gjendjen e tyre financiare-ekonomike, marrëdhëniet e tyre afariste dhe lidhjet, të dhëna për statutet dhe vendimet e tyre, për numrin dhe identitetin e personave të prekur me vendimet e tilla, si dhe të dhëna tjera të nevojshme.

(2) Gjate kryerjes së veprimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës vepron në pajtim me nenin 48 paragrafet (3), (4), (5), (6), (7) dhe (8) të këtij ligji.

**Sigurimi i deshmive aty për aty****Neni 50**

(1) Gjate kryerjes së autorizimeve të percaktuara me këto ligj, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës me konkluzion mund t'i urdherojë ndermarrjes së caktuar të personave të autorizuar të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe personave të cilet sipas nevojës i shoqërojnë, që:

1) t'u mundesojë papenguar të hyjnë në cilatdo lokale afariste, tokë ose mjete transportuese të ndermarrjes nga paragrafi (1) i këtij neni;

2) t'u mundesojë papenguar t'i shqyrtojnë librat ose dokumentacionin tjetër, pa marre parasysh mediumin në të cilin ruhet i njëjti;

3) t'u mundesojë papenguar të marrin ose të mbajnë në çfaredo formë kopje ose ekstrakte nga ato libra apo dokumentacion;

4) t'u mundesojë papenguar perkohësisht t'i marrin dhe mbajnë librat ose dokumentacionin tjetër që janë me rëndësi për percaktimin e ekzistimit të kundërvajtjes për periudhën e nevojshme për kopjimin e të njëjtes, nëse kopjimi i tyre nuk mund të kryhet aty për aty. Për konfiskimin dhe mbajtjen e ketille, personat e autorizuar të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës japin vertetim me shkrim në të cilin përkruhen librat dhe dokumentacioni tjetër i konfiskuar dhe percaktohet ku janë gjetur;

5) t'u mundesojë perkohësisht të marrin dhe mbajnë lende, libra ose dokumentacion tjetër për periudhën e nevojshme për percaktimin e fakteve dhe deshmive relevante që dalin nga ato lende, libra dhe dokumentacion, por jo më gjate se perfundimi i plotfuqishëm i procedurës lendore. Për konfiskimin dhe mbajtjen e ketille, personat e autorizuar të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës japin vertetim me shkrim në të cilin përkruhen lendet, librat dhe dokumentacioni tjetër i konfiskuar dhe percaktohet ku janë gjetur;

6) t'u mundesojë papenguar t'i vulosin lokalet afariste dhe librat ose dokumentacionin tjetër për periudhë dhe në vëllim të nevojshëm për shqyrtimin, por jo më gjate se shtatë ditë;

7) personi i autorizuar ose i punësuar tjetër në ndermarrje të japë në procesverbal sqarim për faktet ose dokumentet;

8) personi i autorizuar ose i punësuar tjetër në ndermarrje të dorëzojë sqarim me shkrim për faktet ose dokumentet në afat të caktuar dhe

9) t'u mundesonjë kryerje të papenguar të veprimeve tjera.

(2) Gjate kryerjes së veprimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës vepron në pajtim me nenin 41 paragrafet (2), (3), (4), (5), (6), (7) dhe (8) të këtij ligji.

### Masat e perkohshme

Neni 51

(1) Në raste urgjente, kur ekziston rrezik nga deme serioze dhe të përmirësueshme për konkurrencen, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës me detyrë zyrtare me aktvendim, e në baze të njohurive të veta fillestare për ekzistimin e kundervajtjes, mund t'i percaktojë masa të perkohshme ndërmarrjes e cila me sjelljen e vet mund të shkaktojë deme serioze dhe të përmirësueshme për konkurrencen.

(2) Në aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës do të urdherojë ndërprerjen e veprimeve të caktuara, përbushjen e kushteve të caktuara ose masa tjera të nevojshme për parandalimin e prishjes së konkurrencës dhe do ta percaktojë kohezgjatjen e masave, e cila duhet të jete proporcionale dhe adekuate me qëllimin i cili duhet të arrihet me masat e perkohshme të percaktuara.

(3) Nese është e nevojshme dhe adekuate për parandalimin e prishjes së konkurrencës me aktvendim mund t'i ndryshojë masat e percaktuara tanime nga paragrafi (2) i këtij neni dhe/ose ta ndryshojë kohezgjatjen e tyre.

### Masa për vendosjen e konkurrencës efektive

Neni 52

(1) Në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të plotfuqishëm nga neni 45 paragrafi (1) pika 1 e këtij ligji, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës kryesisht të kundervajtjes me aktvendim mund t'i urdherojë masa të nevojshme për sjellje dhe masa strukturore për menjanimin e pasojave të demshme nga prishja e konkurrencës të shkaktuara me kundervajtjen dhe të percaktojë afate për zbatimin e tyre.

(2) Para miratimit të aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës kryesisht të kundervajtjes i jep mundësi që të deklarohet me shkrim për masat dhe afatet nga paragrafi (1) i këtij neni, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për deklarim.

(3) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni miratohet në procedurë të shkurtuar.

### Mbrojtja gjyqësore në procedurën administrative

Neni 53

(1) Aktvendimet e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të miratuara në procedurë administrative janë përfundimtare. Kunder aktvendimeve të tilla të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës mund të parashtrahet padi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykates kompetente.

(2) Padia për ngritjen e kontestit administrativ parashtrahet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit dhe e njejta nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

### Kapitulli i trete

#### DISPOZITA TË PERGJITHSHME PËR POCEDURAT PARA KOMISIONIT

#### Legjitimacioni zyrtar

Neni 54

(1) Legjitimacioni zyrtar sipas funksionit kanë Kryetari dhe anëtarët e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

(2) Legjitimacioni zyrtar për kryerjen e veprimeve nga neni 41 dhe 50 të këtij ligji kanë të punësuarit në sherbimin profesional.

(3) Në legjitimacionin zyrtar nga paragrafet (1) dhe (2) të këtij neni percaktohet çështja zyrtare e poseduesve të legjitimacionit si persona të autorizuar të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe të njejten janë të obliguar ta tregojnë me kërkesë të pales.

(4) Legjitimacioni zyrtar pushon të vlejë:

- me shuarjen e funksionit Kryetar, perkatesisht anëtar i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës,

- me shuarjen e marrëdhënies së punës në sherbimin profesional të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe

- me shuarjen e autorizimeve për kryerjen e veprimtarive nga neni 41 dhe 50 të këtij ligji.

(5) Legjitimacioni zyrtar hiqet në rast të keqperdorimit të të njejtit.

(6) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës e percakton formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit zyrtar dhe menyren e leshimit dhe heqjes së tij.

(7) Aktin nga paragrafi (6) i këtij neni, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës e boton në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

### Shfrytëzimi i të dhenave

Neni 55

Të dhenat e siguruar gjatë procedurës para Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës ose Komisionit për Vendimarrje për Kundervajtje, mund të perdoren vetëm për procedurë të cilat udhëhiqen në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

### Inspektimi i shkresave

Neni 56

(1) Palet në procedurën para Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës ose pjesëmarrësit në procedurën para Komisionit për Vendimarrje për Kundervajtje kanë të drejtë të kryejnë inspektim të shkresave të lëndes dhe me shpenzim të vet të bëjnë përkthim ose të bëjnë kopje të tere lëndes ose të dokumenteve të caktuara.

(2) Inspektimi i shkresave në procedurë para Komisionit për Vendimarrje për Kundervajtje kryhet pas pranimit të njoftimit preliminar nga neni 42 paragrafi (1) i këtij ligji.

(3) Kërkesa për inspektim të shkresave parashtrahet në formë të shkruar, e me konkluzion e miraton kryetari i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, perkatesisht kryetari i Komisionit për Vendimarrje për Kundervajtje, varesisht nga ajo nese udhëhiqet procedurë administrative ose për kundervajtje.

(4) Kryetari i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, perkatesisht kryetari i Komisionit për Vendimarrje për Kundervajtje me konkluzionin nga paragrafi (3) i këtij neni, e percakton datën dhe orën e kryerjes së inspektimit që duhet të kryhet në afat prej 15 ditësh prej ditës së pranimit të kërkesës për inspektim të shkresave.

(5) Pjesëmarrësit në procedurë nuk kanë të drejtë të kryejnë inspektim, të bëjnë përkthim ose të bëjnë kopje të propozim-vendimeve të Komisionit për Mbrojtjen e konkurrencës dhe të Komisionit për Vendimarrje për Kundervajtje, të procesverbaleve nga mbledhjet e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe të Komisionit për Vendimarrje për Kundervajtje, të procesverbaleve audio dhe audio-vizuele nga mbledhjet e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe të Komisionit për Vendimarrje për Kundervajtje, të udhëzimeve interne dhe vërejtjeve për lëndën, si dhe të korrespondencës dhe leterkëmbimeve ndërmjet Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Komisionit Evropian ose institucioneve tjera të Unionit Evropian, si dhe dokumenteve tjera që paraqesin fshehtësi afariste ose zyrtare, në pajtim me nenin 57 të këtij ligji.

(6) Kur Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje do të miratoje konkluzion për refuzimin e kërkeses për shkak të mungesës së kushteve ligjore për udhëheqjen e procedurës sipas nenit 37 të këtij ligji, parashtruesi i kërkesës për ngritjen e procedurës ka të drejtë të kryejë inspektim në shkresat e lendes dhe në shpenzim të vet të beje pershkrim ose të beje kopje të tere lendes ose të dokumenteve të caktuara.

(7) Parashtruesi i kërkeses për ngritjen e procedurës nga paragrafi (6) i këtij neni nuk ka të drejtë të kryejë inspektim, të beje pershkrim ose të beje kopje të propozimvendimeve të Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje, të procesverbaleve nga mbledhjet e Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje, të procesverbaleve audio dhe audio-vizuele nga mbledhjet e Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje, të udhëzimeve interne dhe verejtjeve për lenden, si dhe të korrespondencës dhe leterkëmbimeve ndermjet Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Komisionit Evropian ose institucioneve tjera të Unionit Evropian, si dhe dokumenteve tjera që paraqesin fshehtësi afariste ose zyrtare, në pajtim me nenin 57 të këtij ligji.

(8) Kunder konkluzionit për refuzim të kërkeses për inspektim në shkresa nuk lejohet ankese, e as padi për ngritjen e kontestit administrativ.

### Fshehtësia afariste ose zyrtare

#### Neni 57

(1) Kryetari dhe anetaret e Komisionit për Mbrojtjen e konkurrencës, kryetari dhe anetaret e Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje dhe të punësuarit janë të obliguar që ta ruajnë fshehtësinë afariste ose zyrtare pa marre parasysh se në ç'menyrë e kanë kuptuar. Obligimi për ruajtjen e fshehtësisë afariste ose zyrtare zgjat pese vjet pas shuarjes së marrëdhënies së punës në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës ose pas shuarjes së mandatit të Kryetarit ose anetarit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

(2) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni nuk guxojnë të japin deklarata në publik me të cilat do të prishet prestigji i ndermarrjes, si dhe deklarata për masat që i kanë marre, perkatesisht procedurat që i kanë ngritur në kryerjen e punëve në kompetencë të tyre, deri në perfundimin e tyre, pervec nese nuk behet fjale për publikim të informatës së pergjithshme.

(3) Me fshehtësi afariste nga paragrafi (1) i këtij neni nukuptohet vecanerisht:

1) ajo që me ligj dhe rregulla tjera është percaktuar si fshehtësi afariste dhe

2) ajo që ndermarrja do të percaktoje se paraqet fshehtësi afariste, nese Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ose Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje e pranon percaktimin e tille.

(4) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, perkatesisht Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje do të pranoje percaktimin e të dhenave si fshehtësi afariste, nese behet fjale për të dhena të cilat kane vlere tregtare ose ekonomike dhe zbulimi ose perdorimi i të cilave mund të coje në perparësi ekonomike për ndermarrjet tjera.

(5) Gjate vleresimit të të dhenave sipas paragrafit (4) të këtij neni, vecanerisht zbatohen kriteret në vijim:

1) vellimi në të cilin e dhena është e njohur jashte ndermarrjes;

2) vellimi në të cilin janë marre masa për mbrojtjen e fshehtësisë së të dhenave në ndermarrje dhe

3) vlere e të dhenave për ndermarrjen dhe konkurrentet e saj.

(6) Si fshehtësi afariste sipas dispozitave të këtij ligji, sipas rregullës nuk konsiderohen:

1) të dhenat të cilat publikisht janë të kapshme, perkatesisht të cilat shpallen publikisht në baze të ndonje rregulle tjetere ose vendimi të organeve të menaxhimit të ndermarrjes;

2) të dhenat më të vjetra se 5 vjet, pavaresisht nga fakti nese janë konsideruar si fshehtësi afariste;

3) të ardhurat e permbajtura në raportet vjetore financiare dhe statistikore që nuk paraqesin fshehtësi afariste, pasi ato janë të shpallura publikisht dhe

4) të dhenat dhe dokumentacioni me rendesi vendimmarrese për vendimet e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, perkatesisht Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje.

(7) Ndermarrja është e obliguar që gjate dorezimit të të dhenave të cilat janë të percaktuara si fshehtësi afariste, percaktimin e të dhenave për fshehtësi afariste ta arsyetoje me shenimin e shkaqeve objektive.

### Kompensimi i demit

#### Neni 58

Nese shkaktohet dëm me cfaredo veprimi i cili paraqet kundervajtje në pajtim me dispozitat e këtij ligji, personi i cili do të pesoje dëm mund të kerkoje kompensim në pajtim me ligjin.

### PJESA E PESTE DISPOZITA PËR KUNDERVAJTJE

#### Kundervajtje më të renda

#### Neni 59

Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje, ndermarrjes, perkatesisht shoqatës së ndermarrjes, me aktvendim do t'i shqiptoje gjobe në shume deri në 10% nga vlere e të ardhurave të pergjithshme vjetore, të realizuara në vitin e fundit afarist, të shprehur në shumen absolute dhe nominale për të cilen ndermarrja apo shoqata e ndermarrjes ka hartuar llogari vjetore, nese:

1) lidh marreveshje të ndaluar apo në menyre tjetere merr pjese në marreveshje, vendim apo sjellje të harmonizuar me të cilat prishet konkurrenca sipas nenit 7 të këtij ligji;

2) kryen keqperdorim të pozites dominuese sipas nenit 11 të këtij ligji;

3) nuk vepron sipas aktvendimit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës nga neni 51 i këtij ligji dhe

4) nuk vepron sipas aktvendimit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës nga neni 52 i këtij ligji.

#### Kundervajtje më të renda në procedurën për vleresim të koncentrimeve

#### Neni 60

Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje pjesemarrësve në koncentrim që kane për obligim që të parashetrojne njoftim nga neni 15 i këtij ligji, me aktvendim do t'u shqiptoje gjobe në shume deri në 10% nga vlere e të ardhurave të tyre të pergjithshme vjetore, të llogaritura në pajtim me nenin 16 të këtij ligji, të shprehur në shumen absolute dhe nominale, nese:

1) nuk parashetrojne njoftim për koncentrimin në pajtim me nenin 15 të këtij ligji;

2) e realizojne koncentrimin në kundërshtim me nenin 18 paragrafi (1) të këtij ligji;

3) nuk vepron sipas aktvendimit të miratuar në pajtim me nenin 18 paragrafi (3), nenin 19 paragrafi (3), nenin 20 paragrafi (1) pika 3, nenin 21 paragrafi (2) pika 3, nenin 22 paragrafi (2) dhe nenin 23 paragrafi (1) të këtij ligji dhe

4) e realizon koncentrimin për të cilin me aktvendim, të miratuar në pajtim me nenin 20 paragrafi (1) pika 4 dhe nenin 21 paragrafi (2) pika 2 të këtij ligji, është percaktuar se nuk është në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

**Kundervajtje më të lehta**

## Neni 61

(1) Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje, ndermarrjes, perkatesisht shoqates së ndermarrjes, me aktvendim do t'i shqiptoje gjobe në shume deri në 1% nga vlera e të ardhurave të pergjithshme vjetore, të realizuara në vitin e fundit afarist, të shprehur në shumen absolute dhe nominale për të cilen ndermarrja apo shoqata e ndermarrjes ka hartuar llogari vjetore, nese:

1) nuk vepron sipas konkluzionit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences apo Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje për dorezimin e të dhenave në afatin e caktuar, sipas neneve 40, 48 dhe 49 të ketij ligji;

2) dorezon të dhena të pasakta, të paplota apo të dhena të cilat mund t'i shkaktojne huti Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences apo Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje, sipas neneve 40, 48 dhe 49 të ketij ligji;

3) nuk vepron sipas konkluzionit nga nenet 41 dhe 50 të ketij ligji;

4) nuk mundeson hyrje të papenguar në cilatdo lokale afariste, vende apo mjete transportuese të ndermarrjes së caktuar, sipas neneve 41 paragrafi (1) pika 1 dhe 50 paragrafi (1) pika 1 të ketij ligji;

5) nuk mundeson shqyrtim të papenguar të librave apo të dokumentacionit tjetër, sipas neneve 41 paragrafi (1) pika 2 dhe 50 paragrafi (1) pika 2 të ketij ligji;

6) nuk mundeson marrjen apo mbajtjen e papenguar të lendeve, librave, të dokumentacionit tjetër, në cilendo forme të kopjeve apo ekstrakteve nga librat apo dokumentacionit tjetër, sipas neneve 41 paragrafi (1) pikat 3, 4 dhe 5 dhe 50 paragrafi (1) pikat 3, 4 dhe 5 të ketij ligji;

7) nuk mundeson vulosje të papenguar, sipas nenit 41 paragrafi (1) pika 6 dhe 50 paragrafi (1) pika 6 të ketij ligji;

8) i zhvulos vulosjet e kryera në pajtim me nenet 41 paragrafi (1) pika 6 dhe 50 paragrafi (1) pika 6 të ketij ligji;

9) personi i autorizuar apo i punesuari tjetër refuzon të japë sqarime për fakte dhe rrethana të caktuara, sipas neneve 41 paragrafi (1) pikat 7 dhe 8 dhe 50 paragrafi (1) pikat 7 dhe 8 të ketij ligji;

10) personi i autorizuar apo i punesuari tjetër jep të dhena të pasakta, të paplota apo të dhena të cilat mund t'i shkaktojne huti Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences apo Komisionit për Vendimmarrje për Kundervajtje, sipas neneve 41 paragrafi (1) pikat 7 dhe 8 dhe 50 paragrafi (1) pikat 7 dhe 8 të ketij ligji dhe

11) nuk mundeson kryerje të papenguar të veprimeve tjera, sipas neneve 41 paragrafi (1) pika 9 dhe 50 paragrafi (1) pika 9 të ketij ligji.

(2) Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje pjesemarrësve në koncentrim që jane të obliguar që të parashetrojne njoftime nga neni 15 i ketij ligji, me aktvendim do t'u shqiptoje gjobe në shume deri në 1% nga vlera e të ardhurave të tyre të pergjithshme vjetore, të llogaritura në pajtim me nenin 16 të ketij ligji, nese në njoftimin dhe shtojcat e njoftimit, si dhe në plotesimin e njoftimit nga neni 15 i ketij ligji dorezon të dhena të pasakta apo të dhena të cilat mund t'i shkaktojne huti Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrences.

**Shqiptimi i gjobes shoqatave të ndermarrjeve**

## Neni 62

(1) Kur kundervajtja eshte kryer nga shoqata e ndermarrjes, e ka të beje me aktivitetet e anetareve të saj, gjoba nuk do ta tejkaloje shumen prej 1%, të shprehur në shumen absolute dhe nominale për kundervajtjet më të lehta, perkatesisht 10%, të shprehur në shumen absolute dhe nominale për kundervajtjet më të renda, nga permbledhja e të ardhurave të pergjithshme vjetore të secilit anetar të shoqates i cili vepron në tregun relevant.

(2) Kur shoqates së ndermarrjes i eshte shqiptuar gjobe për kundervajtje e cila ka të beje me aktivitetet e anetareve të saj, e shoqata nuk eshte likuide, e njejtja eshte e detyruar të siguroje mjete për pagesen e gjobes nga anetaret e vet.

(3) Nese shoqata nuk e paguan gjoben në afatin e percaktuar nga Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje, organi kompetent për kryerjen e gjobes do të kerkoje pagese të gjobes drejtperdrejt nga cilido prej anetareve të shoqates perfaqesuesit e të cileve marrin pjese në organet e vendimmarrjes së shoqates.

(4) Pasi organi kompetent për zbatimin e gjobes do të kerkoje pagese të gjobes nga paragrafi (3) i ketij neni dhe duke i pasur parasysh kufizimet për lartesine e gjobes nga nenet 59 paragrafi (1) dhe 61 paragrafi (1) të ketij ligji, e që të sigurohet pagese e plote e së njejtjes, do të kerkoje pagese të pjeses tjetër të gjobes nga cilido anetar i shoqates i cili vepron në tregun relevant.

(5) Organi kompetent për zbatimin e gjobes nuk do të kerkoje pagese të gjobes në pajtim me paragrafet (3) dhe (4) të ketij neni nga ndermarrjet të cilat do të deshmojne se nuk e kane zbatuar vendimin e shoqates me të cilin eshte e kryer kundervajtja, e as që kane qene të vetedijshem për ekzistimin e tij.

**Sanksione tjera për kundervajtje**

## Neni 63

(1) Për kundervajtjet nga nenet 59 paragrafi (1) dhe 60 paragrafi (1) të ketij ligji, Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje personit juridik, krahas gjobes mund t'i shqiptoje edhe ndalim të perkohshem për kryerjen e veprimtarise së vecante në kohezgjatje prej 3 deri në 30 dite.

(2) Për kundervajtjet nga nenet 59 paragrafi (1) dhe 60 paragrafi (1) të ketij ligji, Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje personit fizik, krahas gjobes mund t'i shqiptoje edhe ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarise apo detyres në kohezgjatje prej tri deri në 15 dite.

**Percaktimi i gjobes**

## Neni 64

(1) Gjate percaktimit të gjobes merren parasysh:

1) pesha e kundervajtjes;

2) kohezgjatja e kundervajtjes dhe

3) shkalla e prishjes së konkurrences dhe pasojat e shkaktuara me kundervajtjen.

(2) Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje, gjate percaktimit të gjobes, së pari percakton shume themelore të gjobes, e pastaj të njejtjen e pershtate, duke i marre parasysh rrethanat lehtesuese apo renduese.

(3) Shuma themelore e gjobes sipas rregulles eshte më së shumti deri në 30% nga të ardhurat e kryeresit të kundervajtjes, të realizuara nga veprimtaria e cila kryhet në tregun relevant në të cilin eshte kryer kundervajtja në vitin e fundit të plote afarist në të cilin kryeresi i kundervajtjes ka marre pjese në të njejtjen. Shuma e percaktuar në kete menyre shumezohet me numrin e vjeteve në të cilat ka zgjatur kundervajtja.

(4) Shuma e percaktuar në pajtim me paragrafin (3) të ketij ligji pershtatet me marrjen parasysh të rrethanave lehtesuese apo renduese, si rezultat i së ciles e njejtja mund të zvogelohet ose rritet.

(5) Rrethana lehtesuese të cilat merren parasysh gjate percaktimit të gjobes jane kryesisht, nese:

1) kryeresi i kundervajtjes ka dorezuar deshmi se i ka nderprere veprimet të cilat paraqesin kundervajtje në momentin kur Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje ka ngritur procedure për kundervajtje, me perjashtim kur behet fjale për kundervajtje nga neni 7 paragrafi (1) pika 1 të ketij ligji;

2) kryeresi i kundervajtjes ka dorezuar deshmi se perfs-hirja e tij në kundervajtje eshte minimale dhe deshmon se për periudhen kur ka qene pjesemarrës në marrevshjen e ndaluar, realisht e ka shmangur zbatimin e tij duke u sjellur në menyre konkurruese në tregun relevant dhe

3) kryeresi i kundervajtjes në menyre efektive ka bash-kepunuar me Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës apo Komisionin për Vendimmarrje për Kundervajtje, pava-resisht nga zbatimi i nenit 65 të ketij ligji (leniency).

(6) Rrethana renduese të cilat merren parasysh gjate percaktimit të gjobes jane kryesisht, nese:

1) Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje ka konstatuar se eshte kryer kundervajtje e parapare me dispozitat e ketij ligji, e kryeresi i kundervajtjes vazhdon ta krye-je kundervajtjen apo e perserit kundervajtjen e njejte apo të ngjashme. Në kete rast, shumta themelore nga paragrafi (2) i ketij neni mund të rritet deri në 100% për çdo kundervajt-je të tille të percaktuar;

2) kryeresi i kundervajtjes ka refuzuar të bashkepu-joje apo e ka penguar Komisionin për Mbrojtjen e Konkurren-cës apo Komisionin për Vendimmarrje për Kundervajtje në zbatimin e procedures dhe

3) kryeresi i kundervajtjes e ka pasur rolin e udheheq-sit apo nxitësit të kundervajtjes. Komisioni për Vendim-marrje për Kundervajtje vecanerisht merr parasysh nese kr-yeresi i kundervajtjes ka ndermarre veprime të orientuara drejt nxitjes së ndermarrjeve tjera që të marrin pjese në kundervajtje dhe/ose ka ndermarre cfaredo masa të hakmar-rrjes kunder ndermarrjeve tjera me qellim që t'i detyroje në ndermarrjen e veprimeve të cilat paraqesin kundervajtje.

(7) Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje mund t'ia rrite shumen themelore të gjobes kryeresit të kundervajtjes i cili ka të ardhura vecanerisht të medha të dalin edhe nga veprimtari të tjera, e jo vetem nga veprimtaria e cila kryhet në tregun relevant në të cilin eshte kryer kundervajtja, për arritjen e efektit prapakthyes të gjobes.

(8) Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje mund t'ia rrite shumen themelore të gjobes kryeresit të kun-dervajtjes me qellim që gjoba ta tejkaloje shumen lidhur me pasurimin e pabaze i cili ka ndodhur si pasoje e kunder-vajtjes, nese eshte e mundur ajo shume të llogaritet.

(9) Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje me kerkese të kryeresit të kundervajtjes, e gjate percaktimit të gjobes, ta marre parasysh paaftesine e tij të pageses, në kontekst të posacem social dhe ekonomik. Në zvogelimin e gjobes për kete arsye nuk mund të vije, nese behet fjale për humbje financiare të kryeresit të kundervajtjes, të krye-ra me qellim të shmangies së pageses së gjobes. Në zvoge-limin e gjobes mund të vije vetem nese kryeresi bashkeng-jite deshmi se gjoba e percaktuar në pajtim me dispozitat e ketij neni do ta rrezikonte aftesine ekonomike të kryeresit dhe do të shkaktonte që prona e tij ta humb vleren e vet.

### Lirimi ose zvogelimi i gjobes (leniency)

Neni 65

(1) Me qellim të zbulimit të kartelevë që paraqesin kun-dervajtje nga neni 59 paragrafi (1) pika 1 të ketij ligji, Ko-misioni për Vendimmarrje për Kundervajtje me kerkese të ndermarrjes që e ka pranuar pjesemarrjen e vet në kartel do të percaktoje lirimi të plote nga gjoba, e cila sipas rregulles eshte dashur t'i shqiptohet asaj ndermarrjeje, nese e njejte:

1) së pari bashkengjit deshmi të cilat i mundesojne Ko-misionit për Vendimmarrje për Kundervajtje të ngrite pro-cedure për kundervajtje ose

2) së pari bashkengjit deshmi të cilat i mundesojne Ko-misionit për Vendimmarrje për Kundervajtje, që procedu-ren tanime të ngritur për kundervajtje ta perfundoje me akt-vendim i cili e percakton ekzistimin e kundervajtjes, nese pa deshmitë e tilla nuk ka mundur të percaktohet ekzistimi i kundervajtjes.

(2) Nese ndermarrja që e ka pranuar pjesemarrjen e vet në kartel, që paraqet kundervajtje nga neni 59 paragrafi (1) pika 1 të ketij ligji nuk i permbushe kushtet për lirimin e plote nga gjoba nga paragrafi (1) i ketij neni, gjoba, e cila sipas rregulles eshte dashur t'i shqiptohet mund t'i zvogelo-het nese në Komisionin për Vendimmarrje për Kundervajt-je dorezon deshmi plotesuese relevante me rendesi vendim-marrese për miratimin e aktvendimit me të cilin percakto-het ekzistimi i kundervajtjes.

(3) Lirimi, perkatesisht zvogelimi i gjobes nga paragra-fet (1) dhe (2) të ketij neni do të zbatohet nese ndermarrja e cila e kerkon lirimin, perkatesisht zvogelimin e gjobes në menyre kumulative i permbushe kushtet në vijim:

1) e nderpret pjesemarrjen e vet në kartel menjehere pas parashtrimit të kerkeses për lirimin nga gjoba;

2) bashkepunon me Komisionin për Vendimmarrje për Kundervajtje në teresi, në kontinuitet dhe të dhenat e plota i dorezon në afatin më të shkurter të mundshem;

3) nuk i njofton pjesemarrësit tjere në kartel për parash-trimin e kerkeses për lirimi nga gjoba;

